

FJALA E GUVERNATORIT

*E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar deputetë,*

Është një privilegj i veçantë të paraqitem sot përpara jush për t'ju njohur me aktivitetin vjetor të institucionit që unë drejtoj, Bankës së Shqipërisë. Përfitoj nga ky rast për të falenderuar Kuvendin e Shqipërisë për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj institucionit tonë. Kjo ndihmë ka qenë dhe mbetet jetike për të siguruar në vazhdimësi qëndrueshmërinë dhe besimin e publikut ndaj institucionit.

Viti i kaluar dëshmoi një dinamikë të qëndrueshme në drejtim të rritjes ekonomike dhe të stabilitetit makroekonomik. Sistemi financiar dhe sektori bankar në veçanti, kanë luajtur një rol kryesor në ndërmjetësimin e burimeve financiare të ekonomisë.

Banka e Shqipërisë ka qenë e kujdesshme në hartimin e politikës monetare dhe në rolin e mbikëqyrës të sistemit financiar. Objektivi ynë mbetet siguri i stabilitetit të çmimeve në periudhën afatgjatë si dhe qëndrueshmëria e sistemit financiar dhe e ekuilibrave makroekonomikë në tërësi.

Më lejoni, që në vijim të prek disa prej çështjeve kryesore, që janë evidentuar në Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë:

1. AKTIVITETI EKONOMIK

Aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2007 vlerësohet të jetë rritur me rreth 6 për qind. Rritja e prodhimit të brendshëm bruto u siguroi nga ecuria e sektorëve të shërbimeve, industrisë, transportit dhe telekomunikacioneve. Viti 2007 regjistroi një shifër të lartë të investimeve të huaja direkte, të cilat llogariten në 6 për qind të PBB-së.

Një faktor tjetër që ka ndikuar në rritjen ekonomike ka qenë edhe ecuria pozitive e eksporteve, të cilat në vitin 2007 ishin 28 për qind më të larta se sa një vit më parë. Kërkesa e brendshme mbeti e lartë gjatë gjithë vitit 2007, duke u reflektuar më së shumti në zgjerimin e kredisë konsumatore dhe në rritjen e importeve.

Viti 2007 përkoi me reforma të rëndësishme strukturore, ku spikat përfundimi i regjistrimit të kredive, riorganizimi dhe forcimi i mbikëqyrjes së sektorit financiar, administrimi më i mirë i taksave dhe i shpenzimeve publike, privatizimi i Albtelekomit, krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit si dhe reduktimi i mëtejshëm i tarifave doganore.

Viti që lamë pas evidentoi një sërë sfidash, të natyrës jetike për ekonominë shqiptare.

Ai gjithashtu, shënoi një nga periudhat më të vështira përse i përket prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike.

Për një pjesë të konsiderueshme të vitit, vendi u përball me një situatë të vështirë, në origjinë të së cilës ishte rënia drastike e prodhimit vendas ndërkohë që burimet alternative të energjisë, si nafta dhe nënproduktet e saj shënuan çmime rekord në tregjet ndërkombëtare. Në këto rrethana, importi i energjisë elektrike u gjykua si alternativa e vetme për mbylljen e deficitit energjistik.

Në vitin 2007, vëllimi i burimeve të energjisë elektrike vlerësohet rreth 13 për qind më i ulët sesa në vitin 2006, ndërkohë, prodhimi u ul me rreth 50 për qind në krahasim me po këtë vit. Vlera e importeve në milionë euro për vitin 2007, pa përfshirë këmbimet, ishte rreth 4.8 herë më e lartë sesa në vitin 2006. Kufizimi i ndjeshëm në prodhimin vendas të energjisë elektrike, ndërmjet të tjerash pati si shkak edhe kushtet e pafavorshme atmosferike.

Viti i kaluar, evidentoi edhe një herë domosdoshmërinë për ndërtimin e burimeve të reja energjitike alternative dhe përmirësimin e kapaciteteve teknike për import. Rritja e pavarësisë ndaj burimeve hidroenergjitike, përbën një përparësi të madhe kombëtare të natyrës strategjike. Nga ana tjetër, me të njëjtën rëndësi duhet të vlerësohet minimizimi i humbjeve në rrjet, të cilat edhe pse janë ulur me 16 për qind gjatë vitit 2007, përsëri qëndrojnë në nivele kritike, me pasoja të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë financiare të Korporatës Elektroenergjitike. Përfundimi, sipas parashikimeve i privatizimit të rritjet shpërndarës do të ishte një zhvillim shumë pozitiv në këtë drejtim.

Viti 2007 nuk rezultoi i mbarë edhe për sektorin e ndërtimit. Sipas të dhënave në dispozicion, vlerësohet se këtij sektori pothuajse i ka munguar rritja gjatë vitit të kaluar dhe për rrjedhim, edhe kontributi që jep në rritjen ekonomike të vendit.

Megjithatë, çmimet e banesave kanë vazhduar të ngrihen edhe gjatë muajve të fundit të vitit 2007, ndonëse me një ritëm më të ngadalësuar.

Prodhimi bujqësor, megjithë zhvillimet pozitive të kohëve të fundit, ende vazhdon të përballë me një sërë problemesh. Banka e Shqipërisë, ashtu si dhe në raste të tjera, gjykon se reforma strukturore në bujqësi është e domosdoshme dhe duhet të synojë: nxitjen e të gjithë faktorëve që do të çonin në rritjen e produktivitetit të prodhimit bujqësor. Ditët e fundit, fenomeni i rritjes së çmimeve bujqësore, gjithnjë e më shpesh po emërtohet si kriza e ushqimeve. Sipas shumë ekspertëve kohëzgjatja do të jetë relativisht e konsiderueshme, duke rritur paqartësitë në mjaft prej ekonomive të varfra të globit. Në këto rrethana, merr një rëndësi të dorës së parë shfrytëzimi racional i tokës bujqësore, duke synuar shtimin e sipërfaqeve të mbjella si dhe produktivitetin për njësi.

Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë mbështet dhe është e gatshme të jetë pjesë aktive e çdo lloji iniciative, që do të çonte në rritjen e prodhimit vendas dhe shkurtimin e listës së importeve për produktet bujqësore.

I gjithë aktiviteti ekonomik i vendit është zhvilluar në kushtet e një ambienti me inflacion nën kontroll, megjithë vështirësitë e shkaktuara nga zhvillimet në ekonominë globale. Viti 2007 dhe muajt e parë të vitit 2008, përkojnë me një situatë relativisht komplekse, përsa i përket zhvillimeve globale. Aktualisht, përballemi me një rritje të fortë çmimesh të lëndëve të para dhe të produkteve ushqimore, e cila drejtohet kryesisht nga një kërkesë e lartë në rritje e ekonomive në zhvillim. Tregjet financiare vazhdojnë të reflektojnë efektet negative të krizës së kredive që gjeneroi ekonomia e SHBA.

Ndryshe nga vlerësimet fillestare, duket se përhapja e saj është më e madhe, duke prekur një numër të konsiderueshëm institucionesh financiare.

Bankat qendrore kanë injektuar likuiditet në mënyrë të vazhdueshme, ndërkohë që Rezerva Federale ka ulur në mënyrë agresive normën bazë të interesit, për të shmangur një rënie të ekonomisë.

Këto zhvillime kanë dhënë ndikimin e tyre në ekonominë tonë, kryesisht në ecurinë e çmimeve të konsumit. Gjatë vitit 2007, norma e inflacionit pësoi luhatje të ndjeshme, duke kulmuar në muajin shtator me 4.4 për qind. Dy muajt e fundit të vitit shënuan një ecuri në rënie e për rrjedhim, në muajin dhjetor 2007, inflacioni vjetor u ndal në nivelin 2.9 për qind, shumë afër objektivit sasior të Bankës së Shqipërisë, prej 3 për qind. Matjet alternative të inflacionit neto tregojnë se kontributin më të madh në zhvillimet inflacioniste e ka dhënë rritja e çmimit të ushqimeve të përpunuara.

Shtimi i presioneve inflacioniste në ekonomi, vërtetohet edhe nga prirja rritëse e inflacionit bazë. Norma mesatare e inflacionit bazë gjatë vitit 2007 ishte 2.6 për qind apo 0.8 pikë për qindjeje më e lartë se sa ajo e një viti më parë. Presionet inflacioniste u theksuan në pjesën e dytë të vitit 2007. Gjatë kësaj periudhe, mesatarja e normës vjetore të inflacionit bazë arriti në 3.4 për qind, duke kapur nivelet më të larta të këtij treguesi në pesë vitet e fundit.

Shtimi i presioneve inflacioniste me origjinë jashtë ekonomisë së vendit është reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në inflacionin e përgjithshëm të vitit 2007, nëpërmjet rritjes së çmimeve të mallrave të tregtueshëm.

Duke u mbështetur në të dhënat zyrtare të disponueshme për fundin e tremujorit të tretë të vitit 2007, konkludohet se numri i të punësuarve ka ardhur në rritje. Përgjithësisht, vihet re një përputhje e pranueshme midis ecurisë së sektorëve ekonomikë me zhvillimet e tregut të punës. Punësimi është rritur me ritme të larta në sektorin e industrisë dhe në atë të shërbimeve.

Pagat e të gjithë sektorëve kanë ardhur në rritje gjatë vitit 2007. Në tremujorin e tretë të vitit, paga mesatare në sektorin shtetëror, në nivel vjetor, ishte rreth 23 për qind më e lartë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjatë vitit 2007, autoritetet kryesore në fushën e vendimmarrjes ekonomike dhe financiare, Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Banka e Shqipërisë, mundësuan harmonizimin e dy politikave bazë në ekonomi, asaj fiskale me atë monetare.

Panorama e fundvitit paraqet një ecuri të qëndrueshme të treguesve kryesorë fiskalë. Politika fiskale në pjesën më të madhe të vitit 2007 mund të cilësohet si shtërnguese, pasi ka qenë më shumë e orientuar drejt vjeljes së të ardhurave, sesa drejt kryerjes së shpenzimeve. Megjithatë, si edhe në vitet paraardhëse, në muajin e fundit të këtij viti është vërejtur përqendrimi i realizimit të shpenzimeve.

Sipas të dhënave ende jo përfundimtare të Ministrisë së Financave, të ardhurat buxhetore në fund të vitit u realizuan në masën 96 për qind të nivelit të planifikuar, ndërsa shpenzimet buxhetore u realizuan në masën 94 për qind të planit. Në krahasim me një vit më parë vërehet një rritje e peshës së shpenzimeve për sigurime shoqërore e shëndetësore dhe rënie e barrës fiskale për shërbimet e borxhit publik. Karakteristikë e borxhit të brendshëm është kohëzgjatja e afatit të maturimit të borxhit nga 242 ditë në vitin 2006, në 346 ditë në vitin 2007.

Deficiti buxhetor rezultoi në masën 33.7 miliardë lekë, rreth 3.3 – 3.4 për qind e PBB-së. Rreth 85 për qind e deficitit buxhetor është financuar nga burime të brendshme. Të ardhurat nga privatizimi kanë kontribuar pozitivisht në financimin e deficitit buxhetor, duke ulur financimin me anë të letrave me vlerë.

Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjatë vitit 2007 regjistroi një thellim të mëtejshëm të deficitit të llogarisë korente, i cili vlerësohet të ketë arritur në 11 për qind të PBB-së, kundrejt 7.3 për qind në vitin 2006. Zgjerimi i deficitit korent pasqyron aktivitetin e shtuar të shkëmbimeve tregtare, të reflektuar në rritjen e importeve. Ashtu si dhe në periudhat e mëparshme, dërgesat nga emigrantët kanë financuar pjesën më të madhe të bilancit tregtar prej rreth 58 për qind. Megjithatë, duhet theksuar se rritja vjetore e remitançave, në vitin 2007, ishte vetëm 1.3 për qind kundrejt rritjeve 8.7 për qind dhe 4.6 për qind, respektivisht në vitin 2005 dhe në atë 2006.

Viti 2007, karakterizohet nga një lëvizje shumë e madhe në llogarinë kapitale, si në flukset hyrëse ashtu edhe ato dalëse. Zhvillimi më i spikatur përkon me investimet e huaja direkte në ekonomi, treguesi relativ i të cilave kundrejt PBB-së u vlerësua në 6 për qind.

Privatizimi i Albtelekomit, rritja e pjesëmarrjes së kapitalit të huaj në zotërimin e sektorit financiar, kanë luajtur rolin kryesor në këtë rritje. Investitorët nga vendet e Bashkimit Evropian vazhdojnë të mbizotërojnë investimet në fushën e industrisë përpunuese të tekstileve dhe të këpucëve.

2. ZHVILLIMET MONETARE

Ecuria e treguesve monetarë vazhdon të evidentojë ritme të larta të kredisë për ekonominë, kundrejt një zbutjeje të kërkesës së brendshme për para. Ritmi

vjetor i rritjes së parasë së gjerë, agregatit M3, ka njohur ngadalësim në rreth 13 për qind, kundrejt rreth 16 për qind në vitin 2006. Analiza e strukturës sektoriale të zhvillimeve monetare ka evidentuar ritme të larta të gjenerimit të flukseve të parasë në formën e kredisë së brendshme, kryesisht në formën e kredisë për ekonominë. Nga ana tjetër, kontributi i sektorit publik në zgjerimin e parasë mbetet i qëndrueshëm në rreth 2 pikë përqindjeje, sikurse në vitet e fundit.

Në total, analiza e balancës së kredisë së brendshme për ekonominë, e shoqëruar me prirje rënëse të kontributit të mjeteve valutore neto në gjenerimin e M3, përkon me përkeqësimin e llogarisë së jashtme të ekonomisë në rreth 11 për qind të PBB-së, dhe rrjedhimisht të balancës së kursim-investimeve në ekonomi.

Në tërësi, konstatohet rritje e peshës së parasë së gjerë ndaj PBB-së dhe rritje e tepricës së kredisë për ekonominë, në rreth 30 për qind të PBB-së.

Raporti i kredisë për ekonominë ndaj prodhimit të brendshëm bruto u rrit me 8.8 pikë përqindjeje. Kjo prirje është pasqyruar edhe në rritjen e raportit të kredisë ndaj stokut të parasë M3 dhe ndaj aktiveve të sistemit, duke shënuar përkatësisht nivelet 38 për qind dhe 40 për qind në vitin 2007. Gjatë vitit 2007, ritmi vjetor i zgjerimit të kredisë u ndal në nivelin 47.7 për qind, pak më ulët se ajo e regjistruar në vitin e kaluar. Gjithsesi, rritja e portofolit të kredisë vlerësohet të jetë e lartë dhe mbart në një periudhë afatmesme rreziqe potenciale si për stabilitetin e çmimeve ashtu edhe për atë financiar. Kontributin kryesor në rritjen e kredisë e japin bizneset, që dominojnë portofolin e kredisë me 63 për qind. Megjithatë, gjatë dy viteve të fundit ky kontribut është në rënie të qëndrueshme si rezultat i orientimit të bankave drejt bankingut me pakicë, kryesisht financimit të individëve.

Përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për përmirësimin e tregut financiar gjatë vitit 2007, kanë qenë të shumta. Përveç një presioni të vazhdueshëm mbi sistemin bankar, janë adoptuar edhe masa konkrete në këtë drejtim. Kështu, u vendos që tepricat e likuiditetit të qeverisë të mos injektoheshin në sistem por të vendoseshin në depozitë në Bankën e Shqipërisë. Po kështu, u gjykua se një mungesë strukturore likuiditeti do të krijonte më shumë hapësirë për Bankën e Shqipërisë, duke i dhënë rolin e duhur funksionit të saj si huadhënëse e mundësisë së fundit.

Një veprim tjetër, kishte të bënte me hartimin e projektligjit për marrëveshjet e riblerjes midis bankave, një akt juridik ky që synon shmangien e rrezikut në transaksionet midis bankave, duke e bërë të padobishëm aplikimin e kufizimeve në marrëdhëniet e huamarrjes midis bankave të ndryshme.

Me këtë rast, shpreh bindjen time se Kuvendi i Shqipërisë do ta shqyrtojë në kohë dhe me profesionalizëm këtë projektligj të rëndësishëm për ecurinë e mëtejshme të tregut ndërbankar.

Zhvillimi i tregut të parasë, atij ndërbankar dhe i letrave me vlerë mbetet një përparësi konstante për Bankën e Shqipërisë. Megjithatë, zhvillimi i tyre

nënkupton një zhvillim harmonik të të gjitha segmenteve përbërëse të tregut financiar. Mendoj se është momenti i përshtatshëm që disa përparësi t'i shfrytëzojmë me zgjuarsi, nëpërmjet aktivizimit të skemave që minimizojnë problemet dhe presionet në të ardhmen.

Një e tillë është ajo që ka të bëjë me mbizotërimin e moshës së re në Shqipëri dhe shfrytëzimin e këtij faktori, për përfundimin e reformës në fushën e pensioneve.

Përvoja e shumë vendeve të zhvilluara evropiane, ka treguar se plakja e popullsisë e ka vënë në vështirësi sistemin e pensioneve.

Kjo reformë do të bënte që tregu i obligacioneve qeveritare të ishte më likuid. Po kështu do të krijoheshin përqindjet orientuese për tregun e hipotekave dhe atë të obligacioneve të korporatave, duke krijuar një shtrat më të sigurtë për bankat në procesin e kreditimit. Të gjitha këto do të përktreshin në një treg financiar më të gjallë që do të zgjonte interesimin e aktorëve të huaj.

Duke iu kthyer zhvillimeve në vitin 2007, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun bankar, në funksion të implementimit të politikës operacionale. Përgjatë vitit, ndërhyrjet në treg të hapur kanë qenë instrumenti kryesor për zbatimin e politikës monetare.

Operacionet monetare kanë mundësuar administrimin e likuiditetit në sistem dhe qëndrueshmërinë e normave afatshkurtra të interesit, në linjë me objektivat e politikës monetare. Kërkesa më e lartë për likuiditet është plotësuar nëpërmjet operacioneve në treg të hapur. Niveli mesatar ditor i likuiditetit llogaritet 4.8 miliardë lekë nga 7.4 miliardë lekë, një vit më parë.

Në kuadër të administrimit cilësor të likuiditetit të sistemit, që prej muajit korrik, Banka e Shqipërisë ka krijuar lehtësinë e investimit të tepricave të likuiditetit të Qeverisë, në depozita me afat pranë bankës qendrore. Në këtë mënyrë, administrimi i likuiditetit tërësisht nëpërmjet bankës qendrore ka mundësuar rritje të efektivitetit të politikës operacionale.

Gjatë vitit 2007, normat afatshkurtra të interesit kanë reflektuar tërësisht politikën monetare të bankës qendrore, të sinjalizuar në muajt qershor, shtator dhe nëntor. Interesat e huadhënies në tregun ndërbankar janë luhatur brenda korridorit të ripërcaktuar nga ndryshimi i normës bazë të interesit, me + 1.75 pikë përqindjeje.

Këto zhvillime janë përcjellë në tregjet e instrumenteve afatgjata të maturimit. Në tregun primar, *yield*-et e bonove të thesarit janë ndikuar si nga orientimi për lëvizjen e normave të interesit ashtu dhe nga faktorë të tregut. Në muajin mars, *yield*-et ranë me rreth 0.70 pikë përqindjeje, krahasuar me nivelin e tyre në fundvitin e 2006. Ato reflektuan një korrektim ndaj rritjes së tyre në fund të vitit (për shkak të plotësimit të financimit të qeverisë) si dhe tepricat e larta të likuiditetit, gjatë tremujorit të parë të 2007. Paralelisht, normat e interesit të depozitave në lekë kanë ndjekur prirjen rritëse.

Interesat e depozitave në lekë kanë treguar një reagim të plotë dhe të shpejtë ndaj sinjaleve të politikës monetare, duke përcjellë rritjen e normës bazë. Në fund të vitit 2007, norma mesatare e depozitave 12-mujore në lekë arriti në 6.3 për qind ose rreth 0.85 pikë përqindjeje më lart, kundrejt vitit 2006.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor të parasë në funksion të përmbushjes së objektivit të rezervës ndërkombëtare neto. Gjatë vitit 2007, kursi i këmbimit ka rezultuar i qëndrueshëm, ndonëse një prirje e lehtë mbiçmuese e lekut ka qenë e pranishme, kryesisht në tremujorin e fundit të vitit. Në terma nominalë efektivë vjetorë, leku është mbiçmuar kundrejt monedhave të huaja mesatarisht me 1.4 pikë përqindjeje.

Për të përmbushur me sukses objektivin e saj për stabilitetin e çmimeve, Banka e Shqipërisë, duke vlerësuar rreziqet e rrjedhura prej zhvillimeve në anën e kërkesës dhe në atë të ofertës, reagoi tre herë në drejtim të shtrëngimit të politikës monetare. Për rrjedhim, që nga muaji nëntor 2007, përqindja e marrëveshjeve të riblerjes me afat maturimi njëjavor, arriti nivelin 6.25 për qind.

3. MBIKËQYRJA BANKARE

Paralelisht me punën e saj për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, Banka e Shqipërisë, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe stabilitetit financiar të sistemit bankar. Veçanërisht në rrethanat e rritjes së shpejtë të kredisë për ekonominë dhe të problemeve që gjeneron kriza ndërkombëtare e kredive. Për këtë qëllim, është punuar me kujdes në drejtim të njohjes dhe identifikimit të rreziqeve, ideimit të masave përkatëse, hartimit dhe zbatimit të këtyre masave në praktikën e përditshme.

Si shenjë e kujdesit në rritje mund të përmendet ngritja e Departamentit të Stabilitetit Financiar, detyrë kryesore e të cilit do të jetë hetimi dhe njohja e rreziqeve që kërcënojnë stabilitetin financiar në përgjithësi, dhe atë të sistemit bankar, më në veçanti.

Viti 2007 ka sjellë zhvillime përgjithësisht pozitive dhe të qëndrueshme në sistemin bankar. Aktivitetet e sistemit bankar u rritën me 118.6 miliardë lekë ose 19 për qind gjatë vitit 2007. Teprica e kredisë së sistemit bankar, gjatë vitit 2007, shënoi rritje me 94.5 miliardë lekë ose 47.7 për qind më e lartë se teprica e fundvitit 2006. Rezultati neto pozitiv i sistemit bankar për vitin 2007, raportohet rreth 42 për qind më shumë se ai i vitit 2006.

Bankat kanë rritur produktet elektronike në shërbim të klientëve të tyre. Tashmë, në sistemin bankar shqiptar 11 banka përdorin transaksionet në rrugë elektronike. Vlen të theksohet zgjerimi i shërbimit të *e-banking* edhe në tre banka të tjera të sistemit. Dëshmi tjetër e rritjes së konkurrencës bankare si dhe e rritjes së vëllimit të transaksioneve financiare nëpërmjet bankave, është zgjerimi i rrjetit bankar me degë dhe agjenci të reja.

Gjatë vitit 2007, numri i degëve dhe agjencive brenda territorit të Republikës së Shqipërisë u zgjerua me 103 njësi, nga të cilat 43 janë hapur të reja në rrethin e Tiranës.

Një arritje tjetër, e rëndësishme përkon me krijimin e Regjistrimit të Kredive, i cili konsiderohet si një element i rëndësishëm i garantimit të stabilitetit të sistemit bankar. Regjistri i Kredive përbën bazën elektronike të të dhënave për kredimarrësit e sistemit bankar shqiptar dhe ka për qëllim, trajtimin e përqendruar të informacionit dhe të të dhënave, në lidhje me ekspozimin kreditor të çdo kredimarrësi dhe personave të lidhur me ta. Funkcionimi i këtij Regjistri, synon rritjen e mundësive për kryerjen e transaksioneve të shëndosha kredituese, nëpërmjet vënies në dispozicion të informacionit mbi kredimarrësit duke nxitur eficiencën dhe sigurinë e procesit të kredidhënies.

Gjatë vitit 2007, kanë ndodhur ndryshime stukturore në industrinë bankare, kryesisht për shkak të procesit të konsolidimit, në formën e bashkimit me përthithje.

Drejtim i rëndësishëm ka qenë edhe përmirësimi i kuadrit rregullativ të mbikëqyrjes bankare, duke e përputhur atë gjithnjë e më shumë, me dispozitat e ligjit të ri dhe me direktivat ndërkombëtare për një mbikëqyrje efektive, që burojnë nga akordet e Komitetit të Bazelit.

Banka e Shqipërisë beson se sistemi financiar dhe posaçërisht sektori bankar, do të luajnë një rol aktiv në ndërmjetësimin financiar dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit, duke ruajtur qëndrueshmërinë dhe performancën e mirë financiare.

4. BILANCI DHE REZULTATI FINANCIAR

Totali i aktiveve të Bankës së Shqipërisë me 31 dhjetor 2007, arriti në shifrën 260,1 miliardë lekë, me një rritje prej 2 për qind në krahasim me fundvitin 2006. Aktivët e huaja u rritën me rreth 8 miliardë lekë, duke zënë një peshë specifike prej 70 për qind.

Të ardhurat e Bankës së Shqipërisë për vitin 2007 u rritën me 22 për qind, krahasuar me vitin 2006. Ndikimin kryesor e ka dhënë realizimi i të ardhurave në valutë në masën 22 për qind më shumë se viti i kaluar. Në këtë grup të ardhurash ndikimin kryesor e ka rritja e rezervës valutore dhe rritja e kthimit nga investimi i saj.

Shpenzimet e Bankës së Shqipërisë për vitin 2007 u zvogëluan me 17 për qind, krahasuar me vitin 2006.

Shpenzimet për interesa e komisione në lekë nga veprimet me rezidentët, të cilat zënë dhe 59 për qind të totalit të shpenzimeve, u rritën me 33 për qind. Efektin më të madh e ka rritja në vlerë absolute e rezervës së detyrueshme dhe si rrjedhim, rritja e shpenzimeve për remunerimin e saj.

Në përfundim, Banka e Shqipërisë paraqitet me një fitim neto për vitin 2007 në masën 8,2 miliardë lekë kundrejt 5,2 miliardë lekëve, për vitin 2006 ose me një rritje prej 58 për qind në vlerë relative.

Gjatë vitit 2007 u regjistruan disa përmirësime të rëndësishme në kontabilitetin e Bankës së Shqipërisë, të cilat ishin në përputhje me rekomandimet e auditorëve të jashtëm, me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe me praktikatat më të mira të Sistemit të Bankave Qendrore të Evropës.

Konkretisht:

- U realizua rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, trualli dhe ndërtesa, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, sipas metodës së kostos së zëvendësimit, duke përfshirë të gjithë grupin e aktiveve si në qendër ashtu edhe në degë.
- U zgjidh me vendim të Këshillit të Ministrave statusi ligjor i shtypshkronjës, i rekomanduar për zgjidhje në mënyrë konstante nga auditori i jashtëm.
- U miratua nga Ministri i Financave, rritja e fondit të themelimit të Bankës së Shqipërisë nga 750 milionë lekë në 2,5 miliardë lekë. Duke plotësuar në këtë mënyrë një nga rekomandimet e përsëritura të auditorit të jashtëm dhe të misionit të specializuar të FMN-së.
- U zgjidh përfundimisht statusi ligjor i pronësisë së arit, duke e kaluar atë në pronësi të Bankës së Shqipërisë.

Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë është audituar nga Departamenti i Kontrollit. Inspektorët e kontrollit, duke marrë për bazë gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet e dhëna në auditimet e kryera për vitin 2007, kanë vlerësuar se llogaritë dhe regjistrat pasqyrojnë drejt gjendjen financiare dhe janë në përputhje me Manualin Kontabël të Bankës së Shqipërisë dhe ligjin "Për Bankën e Shqipërisë". Pasqyrat financiare janë përgatitur në formën e duhur dhe nuk përmbajnë mangësi materiale. Ato japin një pamje të vërtetë dhe të rregullt të pozicionit financiar të Bankës së Shqipërisë.

Të nderuar deputetë,

Është fakt i pranuar gjerësisht përmirësimi i kapaciteteve analizuese dhe hartuese të institucioneve shqiptare.

Kjo ka bërë që të rritet ndjeshëm pronësia jonë në programet afatmesme të zhvillimit ekonomik dhe financiar të vendit. Nga fillimi i tranzicionit, në pjesën më të madhe, këto programe janë formuluar dhe zbatuar në përbërje të marrëveshjeve mbështetëse të FMN-së.

Ne besojmë se programi aktual do të jetë i fundit që gëzon mbështetjen e kushtëzuar të FMN-së. Ky fakt tregon se vendi është maturuar dhe se ekonomia jonë është në rrugën e duhur. Për herë të parë, autoritetet shqiptare do të kenë pronësi të plotë mbi politikatat dhe programet afatmesme të zhvillimit të vendit.

Banka e Shqipërisë ka kohë që po përgatitet në këtë drejtim, duke mos e konsideruar këtë proces thjesht si një veprim mekanik. Bëhet fjalë për përpjekje intensive trevjeçare vlerësimi, analize dhe konkluzionesh për të ardhmen e politikës monetare.

Gjatë këtyre tre viteve, kemi shkëmbyer ide dhe kemi studiuar në imtësi tipare të regjimit të inflacionit të shënjestruar. Mbështetur në nivelin aktual dhe të pritshëm të zhvillimit të tregjeve financiare, vlerësojmë se inflacioni i shënjestruar është një alternativë optimale për të ardhmen.

Suksesi në këtë iniciativë, kërkon ndërmjet të tjerash, që Shqipëria jo vetëm të vazhdojë adoptimin e politikave të shëndetshme makroekonomike, por t'i thellojë ato më tej. Kjo nënkupton një politikë monetare të përqendruar në stabilitetin e çmimeve dhe një politikë fiskale të kujdesshme, veçanërisht në terma të raporteve të treguesve fiskalë ndaj PBB-së.

Në këtë kontekst, dëshiroj të theksoj se objektiv kryesor i Bankës së Shqipërisë është stabiliteti i çmimeve të konsumit.

Stabiliteti makroekonomik është themelor dhe një pararendës i të gjitha zhvillimeve të tjera të rëndësishme ekonomiko financiare. Pa stabilitet makroekonomik nuk ka rritje, nuk ka investime të huaja, nuk ka rishpërndarje e për rrjedhim, nuk ka zhvillim në përgjithësi.

Megjithatë, gjykoj se politika monetare dhe stabiliteti financiar janë, dy gjëra të lidhura në mënyrë të pakthyeshme me njëra – tjetrën. Në ditët tona, stabiliteti financiar merr një rëndësi të veçantë në kushtet e përhapjes së shpejtë të efekteve negative të krizës së kredive, në tregjet ndërkombëtare.

Prandaj, mendoj se sfida e vërtetë është gjetja e një ekuilibri të duhur midis këtyre dy përparësive. Gjykoj, se çdo investim që bëjmë sot për të garantuar stabilitetin financiar do të na kthehet në eficiencë të shtuar të politikës monetare.

Në emër të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë do të doja t'ju siguroja ju dhe publikun shqiptar në përgjithësi, se institucioni që unë drejtoj, do të mbetet një institucion plotësisht i përgjegjshëm, thellësisht i angazhuar në plotësimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktet e tjera nënligjore.

Duke ju falenderuar për vëmendjen tuaj,

mbetem i hapur për pyetje dhe sqarime të mëtejshme.



KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE

1.1. EKONOMITË E MËDHA DHE BANKAT QENDRORE

Ekonomia botërore ka hyrë në një periudhë me ritëm më të ulët rritjeje, pas një zgjerimi të lartë 6-vjeçar me një normë mesatare vjetore prej 5 për qind. Në vitin 2007, aktiviteti ekonomik botëror vlerësohet të jetë rritur me një normë vjetore prej 4.7 për qind, 70 pikë përqindjeje më e ulët se norma vjetore e rritjes së vitit 2006¹. Rritja ekonomike pritet të jetë në nivelin 4.6 për qind gjatë vitit 2008.

Ekonomia amerikane dhe disa nga vendet e industrializuara shfaqën shenja ngadalësimi, ndërkohë që ekonomitë e mëdha të vendeve në zhvillim vijuan të luajnë rolin kryesor në rritjen ekonomike botërore. Rreziqet për ecurinë ekonomike botërore janë shtuar, kryesisht në gjysmën e dytë të vitit 2007. Baza e këtyre rreziqeve qëndron në përkeqësimin e gjendjes financiare në tregjet perëndimore, kryesisht ato amerikane.

Përgjithësisht, tregjet financiare perëndimore përbëjnë një sistem referimi për orientimin e kapitaleve edhe në vendet e mëdha në zhvillim. Problemi kryesor i ekonomisë amerikane mbetet përkeqësimi i vërejtur në tregun e banesave dhe implikimet potenciale në tregun e kredive dhe rrjedhimisht, në ekonominë reale. Këto zhvillime janë shoqëruar me përshpejtim të ritmit të inflacionit. Rritja e çmimeve të naftës dhe e disa prej produkteve bujqësore, mund të ndikojë kërkesën reale në ekonomi, si rezultat i rënies së fuqisë blerëse. Vlerësimet aktuale ia atribuojnë rritjen e çmimit të naftës në dollarë, kërkesës së lartë të vendeve në zhvillim përkundrejt një stanjacioni në ofertë. Për më tepër, tensionet gjeopolitike ushtrojnë ndikim në kahun e ofertës dhe në përkeqësimin e pritshmërive në ecurinë e çmimit, në bursat ndërkombëtare.

	2005	2006	2007*	2008*
Ekonomia globale	4.8	5.4	5.2	4.8
Ekonomitë e industrializuara	2.5	2.9	2.5	2.2
Eurozonë	1.5	2.8	2.5	2.1
- Gjermani	0.8	2.9	2.4	2.0
- Francë	1.7	2.0	1.9	2.0
- Itali	0.1	1.9	1.7	1.3
ShBA	3.1	2.9	1.9	1.9
Japoni	1.9	2.2	2.0	1.7

Burimi: FMN, World Economic Outlook, tetor 2007.

*Parashikime.

Tabelë 1. Ecuria e rritjes ekonomike.

Çmimet e produkteve agro-ushqimore janë rritur, si rezultat i rënies së përkohshme të ofertës. Vlerësimet aktuale theksojnë ndikimin e motit të thatë në ofertën për këto produkte, ndërsa në kahun e kërkesës çmimi mund të jetë

rritur edhe si rezultat i përdorimit të disa produkteve bujqësore në industrinë e biofuel².

Tabelë 2. Treguesit makroekonomikë kryesorë (*rritja vjetore në përqindje).

	PBB-T3*	Norma e papunësisë*	IÇK*	Deficiti buxhetor (në % të PBB-së)
USA	+3.5	4.9 (dhjetor)	+3.4 (dhjetor)	-3.7
Eurozonë	+1.6	8.3 (nëntor)	+2.2 (dhjetor)	-2.9
- Gjermani	+1.4	11.2 (dhjetor)	+2.1 (dhjetor)	-3.9
- Francë	+1.8	9.6 (nëntor)	+1.5 (dhjetor)	-3.2
- Itali	+0.1	7.5 (shtator)	+2.0 (dhjetor)	-4.3
Britani	+1.7	5.0 (nëntor)	+2.0 (dhjetor)	-3.1
Japoni	+2.9	4.6 (nëntor)	-0.8 (nëntor)	-6.5

Burimi: Departamenti Amerikan i Punës, Departamenti Amerikan i Tregtisë, Revista "The Economist", 21 janar 2006.

• EKONOMIA AMERIKANE

Ekonomia amerikane ka njohur rënie të ritmeve ekonomike gjatë vitit 2007, pas një performance të mirë disavjeçare. Kjo ecuri është ndikuar kryesisht nga situata në tregun e banesave dhe përkeqësimi i prirjes së investimeve të rezidentëve. Ulja e çmimit të banesave ka dhënë implikime në kontraktimin e kredisë dhe të likuiditetit në ekonomi. Për të parandaluar ndikimin në rritjen ekonomike, FED uli normën bazë të interesit në katër muajt e fundit të vitit 2007 me 1 pikë përqindjeje³.

Gjatë vitit 2007, ekonomia amerikane shënoi ritëm të lartë rritjeje vjetore, në tremujorin e tretë të vitit. Pas një rritjeje me ritme më të ulta gjatë gjysmës së parë të vitit 2007, produkti i brendshëm bruto regjistroi një rritje në nivelin 2.8 për qind dhe 2.5 për qind në dy tremujorët e fundit, në bazë vjetore. Kontribuesit kryesorë në rritjen e PBB-së ishin investimet fikse të kompanive dhe rritja e eksporteve, si pasojë e zhvlerësimit të dollarit. Konsumi, i cili nuk është ndikuar ende nga rënia në vlerën e banesave luajti një rol të rëndësishëm në rritjen e kërkesës. Tregu i banesave ka ushtruar një ndikim negativ në rritjen ekonomike gjatë vitit. Tregues të tjerë të ekonomisë dëshmojnë për një ecuri jo të mirë në sektorin e ndërtimit edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2007. Rënia në nivelin e shitjeve të banesave dhe rënia e investimeve në to, kanë shënuar përkeqësim të kushteve të tregut të pasurive të paluajtshme. Norma e papunësisë është rritur gjatë tremujorit të fundit të vitit, me rreth 0.4 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. FED uli normën bazë të interesit gjatë mesit të muajit shtator me 0.5 pikë përqindjeje, si pasojë e krizës së kredive të dorës së dytë dhe e trazirave në tregjet financiare. Gjatë muajve tetor dhe dhjetor, FED-i uli me 0.5 pikë përqindjeje të tjera normën bazë të interesit, duke e çuar në nivelin 4.25 për qind.

Pas rritjes së shpejtë të çmimeve gjatë muajve të parë të vitit, inflacioni i çmimeve të konsumit u zbut gjatë periudhës qershor-gusht. Ndërkohë që inflacioni mesatar vjetor u rrit nga 3.4 për qind gjatë tremujorit të tretë të vitit, në 4 për qind gjatë tremujorit të fundit. Kontribuesit kryesorë në këtë rritje ishin rritja e çmimit të naftës, e çmimeve të produkteve të tjera, të listuara në bursat ndërkombëtare dhe e çmimeve të produkteve ushqimore. Në vijim të

këtyre zhvillimeve, në muajin janar të këtij viti, FED uli normën bazë të interesit me 1.25 pikë përqindjeje në një mbledhje të paparashikuar. Njëpërmjet kësaj uljeje, FED synoi shmangien e një skenari të rënies në ekonominë reale në sajë të kontraktimit të mëtejshëm të likuiditetit dhe të kredisë për ekonominë⁴.

- *EKONOMIA E EUROZONËS*

Aktiviteti ekonomik në Eurozonë ka vijuar të zgjerohet me një ritëm më të moderuar gjatë vitit 2007, krahasuar me një vit më parë. Produkti i brendshëm bruto u rrit me 2.7 për qind në vitin 2007, nga 2.8 për qind në vitin 2006, sipas vlerësimit më të fundit të Komisionit Evropian. Gjatë këtij viti është vërejtur ngadalësim i prodhimit industrial, rritje në sektorin e shërbimeve dhe përmirësim në kushtet e tregut të punës.

Treguesit makroekonomikë afatshkurtër dëshmojnë për një ngadalësim të aktivitetit ekonomik. Gjatë tremujorit të tretë, produkti i brendshëm bruto regjistroi rritjen më të lartë të vitit 2007. Kontribuesit kryesorë në këtë rritje të aktivitetit ekonomik ishin të gjithë përbërësit e kërkesës së brendshme, sikurse edhe eksportet neto. Gjatë muajve të fundit të vitit, investimet e bizneseve dhe eksportet kanë ardhur në rënie, si rezultat i forcimit të euros dhe i rënies së kërkesës nga tregjet amerikane. Përkeqësimi i situatës së likuiditetit është përcjellë edhe në tregjet financiare evropiane. Këto zhvillime mund të ndikojnë ekonominë e Eurozonës, duke përkeqësuar ecurinë në tregun e banesave të disa ekonomive kombëtare, sikurse sektorin e ndërtimit dhe shpenzimet për konsum. Megjithatë, përmirësimi i kushteve në tregun e punës dhe normat e larta të kthimit në aktivitetin ekonomik të kompanive private, zbusin ndikimin negativ të trazirave në produktin e brendshëm bruto. Sipas parashikimeve paraprake të Komisionit Evropian (të muajit shkurt të vitit 2008), ekonomia e Eurozonës pritet të rritet me 1.8 për qind gjatë këtij viti.

Inflacioni i çmimeve të konsumit është luhatur rreth vlerës së synuar prej 2 për qind, që prej fundit të vitit 2006. Megjithatë, prirja e inflacionit të çmimeve të konsumit ka qenë në rritje që prej muajit shtator të vitit të kaluar. Norma vjetore e inflacionit pësoi rritje në 3.1 për qind në muajin dhjetor, përkundrejt 2.1 për qind në muajin shtator. Presionet në tregjet botërore për energji dhe produkte ushqimore kanë kontribuar në rritjen e inflacionit. Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka paralajmëruar se rritja e lartë e agregatëve monetarë në vitet e fundit sinjalizon rreziqe për stabilitetin e çmimeve, në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Megjithatë, parashikimet aktuale rezultojnë në një normë inflacioni prej 2.3 për qind gjatë vitit 2008.

BQE rriti dy herë me nga 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në gjysmën e parë të vitit 2007, duke e çuar atë në nivelin 4 për qind. Pavarësisht dobësimit të mëtejshëm në tregun e banesave, rritjes së çmimit të naftës dhe të çmimeve të produkteve ushqimore, dhe trazirave të vazhdueshme në tregjet financiare, BQE ka lënë të pandryshuar normën bazë të interesit në gjysmën e dytë të vitit. Komunikimi i politikës monetare nga BQE, ka theksuar përparësinë e stabilitetit të çmimeve dhe ankorimin e pritjeve afatmesme për inflacionin.

- ÇMIMI I NAFTËS

Kërkesa botërore për naftë vlerësohet të jetë rritur me rreth 1.4 për qind krahasuar me një vit më parë. Çmimi i naftës në tregjet ndërkombëtare e filloi vitin rreth nivelit 55 usd/fuçi për të arritur nivelin mbi 90 usd/fuçi, në dy muajt e fundit të vitit 2007. Rritja e çmimit gjatë vitit 2007, jo vetëm e kompensoi uljen e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2006, por shënoi nivele të paarritura më parë. Në rritjen e nivelit të çmimit të naftës kanë kontribuar faktorë kryesisht të kahut të kërkesës. Megjithatë, shtimi i sfidave teknologjike dhe ekonomike për prodhimin e naftës vështirëson shtimin e ofertës në të njëjtin ritëm me kërkesën. Gjithashtu, prania e tensioneve gjeopolitike kontribuon në rritje të përkohshme të çmimit. Sipas vlerësimeve aktuale, oferta e naftës nga vendet jo pjesëtare të OPEC-ut është rritur me rreth 0.6 për qind, gjatë vitit 2007.

Rreth 1/3 e rritjes së kërkesës botërore gjatë viteve 2005-07, i atribuohet vetëm Kinës. Rritja e lartë në Kinë, në Indi dhe në Lindjen e Mesme ka kompensuar efektin e ngadalësimit ekonomik të ShBA-së, aktualisht konsumatorit më të madh të naftës në botë. Kërkesa për naftë ka qenë e ulët në shumë nga vendet e OECD-së, duke vërejtur konsum në rënie në Evropë dhe Japoni gjatë gjysmës së parë të vitit. Temperaturat e larta në dimër kanë reduktuar kërkesën për të në këto vende. Rritja e lartë e konsumit të vendeve jo pjesëtare të OECD-së, pavarësisht çmimeve të larta, pasqyron rritjen e shpejtë të të ardhurave në tregjet e vendeve në zhvillim. Rritja e lartë ekonomike në vendet në zhvillim ka vijuar të rrisë kërkesën për naftë, pavarësisht dobësimit të perspektivës së rritjes në ekonomitë e zhvilluara.

Gjithashtu, zhvlerësimi i dollarit ka dhënë ndikimin e tij në rritjen e çmimit të naftës, duke qenë se prodhuesit kërkojnë një çmim më të lartë të naftës që të marrin të njëjtën pagesë për të, në monedhën e vendit të tyre. Çmimi i naftës, i konvertuar me kursin mesatar të këmbimit euro/usd ka rezultuar më i ulët. I shprehur në euro, çmimi mesatar i naftës bruto gjatë vitit 2007 rezulton rreth, 52.5 euro/fuçi, kundrejt një çmimi mesatar vjetor prej rreth 52 euro/ fuçi në vitin 2006. Megjithatë, në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, çmimi i naftës ka vërejtur rritje në rreth 62-63 euro/fuçi.

Rritja e lartë e çmimit të naftës është ndikuar edhe nga zgjedhja e investitorëve për të investuar në mjete alternative në vend të mjeteve financiare të shprehura në dollarë, duke u përqendruar tek nafta dhe produktet e tjera të para. Zhvlerësimi i dollarit, kombinuar me trazirat financiare të lidhura me tregun e kredive me probleme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë nxitur këtë sjellje të investitorëve. Në dallim nga krizat e naftës të viteve '70 dhe '80, rritja e çmimit të naftës bruto gjatë vitit 2007 nuk ka shkaktuar rënie ekonomike apo rënie të ndjeshme në shpenzimet e konsumit. Ndikimet e saj janë shprehur në një thellim të deficitit tregtar dhe rritje të presioneve inflacioniste. Ngadalësimi i rritjes ekonomike të ekonomisë amerikane dhe të ekonomive konsumatore të naftës, si Kina dhe India, pritet të ushtrojë rol stabilizues në kërkesën për naftë gjatë vitit 2008. Sipas parashikimeve të OPEC-ut për vitin 2008, kërkesa botërore për naftë do të rritet me vetëm 1.4 për qind, ndërkohë që oferta do të rritet me rreth 1.1 për qind. Çmimi mesatar i naftës gjatë vitit 2008 parashikohet të arrijë nivelin 90.6 usd/fuçi.

1.2. EKONOMIA E VENDEVE TË RAJONIT

• EKONOMIA E GREQISË

Gjatë vitit 2007, Greqia ka regjistruar rritje ekonomike relativisht të lartë, thellim të deficitit të llogarisë korente dhe rënie të papunësisë, në raport me ekonominë e Eurozonës. Rritja ekonomike vlerësohet në mbi 4 për qind, ndërsa pritet të stabilizohet nën këtë normë gjatë viteve 2008 dhe 2009. Kërkesa e brendshme ka nxitur rritjen ekonomike, ndërkohë që tregtia me jashtë ka kontribuar negativisht, si rezultat i rritjes me një normë më të lartë të importeve në krahasim me eksportet. Deficiti i llogarisë korente vlerësohet të thellohet më tej në 14 për qind të PBB-së gjatë vitit 2007. ai është i shprehur në deficit më të lartë tregtar, në pagesat më të larta për interesa dhe suficitit më të ulët të transfertave korente. Papunësia gjatë gjysmës së parë të vitit 2007 ra në nivelin e 8.6 për qind, duke pasqyruar edhe ndikimin e rritjes ekonomike. Deficiti i fiskal parashikohet në 2.5 për qind të PBB-së nga 2.7 për qind, në vitin 2006.

• EKONOMIA E ITALISË

Ekonomia e Italisë është karakterizuar nga një ecuri ekonomike më e ulët se një vit më parë, si dhe rënie e investimeve dhe e papunësisë. Rritja ekonomike rezultoi më e ngadaltë në gjysmën e parë të vitit 2007, si pasojë e një rritjeje më të ulët të eksporteve. Investimet fikse ndoqën prirjen e PBB-së. Kërkesa e jashtme është ndikuar nga vlerësimi i euros. Papunësia pësoi rënie të lehtë në fillim të vitit dhe ka ruajtur këtë prirje edhe në gjysmën e dytë të vitit. Rritja ekonomike parashikohet të jetë në nivelet potenciale prej rreth 1.5 për qind gjatë vitit 2008 dhe atij 2009.

• EKONOMIA E REPUBLIKËS ISH-JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

Ekonomia e RIJM ka regjistruar një rritje ekonomike vjetore më të mirë krahasuar me vitin 2006, e shoqëruar me rritje të presioneve inflacioniste gjatë fundit të vitit dhe përmirësim në tregun e punës dhe në pozicionin fiskal. PBB-ja gjatë viteve 2007 dhe 2008, parashikohet të rritet me 5 për qind. Ecuri të mirë kanë regjistruar sektori i transportit dhe telekomunikacionit dhe tregtia me shumicë dhe pakicë. Këta janë sektorët me kontributin kryesor në rritjen ekonomike të vendit. Inflacioni i çmimeve të konsumit pësoi një rritje të dukshme në fundin e vitit 2007, duke pasqyruar rritjet e çmimeve të produkteve ushqimore, çmimit të energjisë dhe kostos së banesave. Norma mesatare vjetore e inflacionit ishte 2.3 për qind gjatë vitit 2007 dhe parashikohet të jetë në nivelin 3 për qind gjatë vitit 2008. Rezervat valutore janë rritur dhe norma bazë e interesit mbetet ende e ulët. Rritja e lartë e

Grafik 1. Çmimet e naftës së papërpunuar (në usd për fuçi).



Burimi: Administrimi i Informacionit të Energjisë
[\[http://tonto.eia.doe.gov/dnav/pet/pet_pri_spt_s1_m.htm\]](http://tonto.eia.doe.gov/dnav/pet/pet_pri_spt_s1_m.htm);
 llogaritje të veta.

eksporteve dhe remitancave, ka luajtur një rol kryesor në zhvillimet makro. Gjatë periudhës janar-tetor, tregtia me jashtë u rrit me një normë vjetore prej 26 për qind. Importi i energjisë elektrike dhe eksporti i hekurit dhe çelikut ishin përkatësisht kontribuesit kryesorë të rritjes në importe dhe në eksporte. Gjatë kësaj periudhe deficiti tregtar u rrit me 20 për qind. Ndërkohë që, gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, llogaria korente regjistroi një suficit më të lartë se 4 për qind të PBB-së.

- **EKONOMIA E TURQISË**

Aktiviteti ekonomik është rritur me një normë më të ulët krahasuar me 2 vitet e fundit, në prani të uljes së normës vjetore të inflacionit, ndërsa situata fiskale është përkeqësuar. Sipas vlerësimeve të OECD-së, produkti i brendshëm bruto është rritur me 5.1 për qind gjatë vitit 2007. Në mungesë të goditjeve të jashtme parashikohet që aktiviteti ekonomik gjatë viteve 2008 dhe 2009, do të rritet me rreth 6 për qind. Politika monetare shtrënguese dhe përkeqësimi i kreditimit në shkallë botërore, vlerësohet të kenë kufizuar rritjen e kërkesës së brendshme. Përmirësimi i llogarisë korente ka kontribuar pozitivisht në aktivitetin ekonomik. Deficiti i llogarisë korente vlerësohet në rreth 7.7 për qind kundrejt 8.1 për qind të PBB-së, gjatë vitit 2006.

Tabelë 3. Treguesit kryesorë makroekonomikë për ekonomitë e rajonit gjatë vitit 2005*.

Vendet	Rritja PBB-së (në %)		Inflacioni vjetor (në %)	Papunësia (në %)	Balanci fiskal (në % të PBB)*	Llogaria korente (në % të PBB)*
	2006	2007*				
Bosnja dhe Hercegovina	6.2	>6	1.0(T3)	43.5(T3)	-13.7(T3)
Kosovë	3.1	3.5	4.9(T3)	45*	6.5	-24
Kroaci	4.8	6.0	2.5*	11.0*	-2.2	-8.5
Mali i Zi	6.5	7.1(T3)	5.1(T3)	11.9	8.7(T3)	-31.1(T3)
Maqedoni	3.7	5.0	2.3	34.4*	-0.9	-2.8
Serbi	5.7	7.2 (T3)	6.6	19.6 (T3)	-0.2 (T3)	-16.8(T3)
Turqi	6.1	5.1	8.8	9.7*	-0.7	-7.9

Burimi: Komisioni Evropian, "Candidate and Pre-Accession Countries' Economies Quarterly, Përditësuar në 11 janar 2008".

*Parashikime.

Zhvillimet makro kanë qenë nën ndikimin e politikës monetare shtrënguese të vitit 2006 dhe situatës së paqëndrueshme politike. Pas një ritmi më të ulët rritjeje në fillimin e vitit, ekonomia e Turqisë shënoi një ecuri më të mirë pas zgjedhjeve të verës. Procesi i disinflacionit është ngadalësuar si rrjedhojë e rritjes së çmimit të energjisë, çmimeve të ushqimeve dhe çmimeve të administruara. Norma e inflacionit ka arritur në nivelin 8.4 për qind, në muajin dhjetor të vitit 2007 nga niveli 9.7 për qind, në muajin dhjetor të vitit 2006. Situata fiskale gjatë vitit 2007 është ndikuar nga zgjedhjet e përgjithshme. Deficiti i fiskal për vitin 2007 pritet të jetë më tepër se 1 për qind e PBB-së.

SHËNIME

¹ Vlerësim i FMN-së (www.imf.org).

² Përdorimi i produkteve bujqësore për prodhimin e energjisë.

³ FED: Komiteti Federal i Tregut të Hapur.

⁴ Skenari i rënies së ekonomisë supozon pozicionimin e ekonomisë në një periudhë rënieje ekonomike të vazhdueshme dhe/ose rritjeje të papunësisë gjatë disa tremujorëve. Një situatë e tillë, mund të rezultojë në marxhinalizim (humbje) të rolit të politikës monetare dhe rënie të mëtejshme ekonomike.

KAPITULLI II. AKTIVITETI EKONOMIK

2.1. EKONOMIA ME PAK FJALË

Rritja ekonomike për vitin 2007 vlerësohet të ketë arritur në nivelin 6.0 për qind. Ashtu si dhe në vitet e kaluara, rritja ekonomike sigurohet nga ecuria në rritje e sektorëve të shërbimeve, industrisë dhe transportit dhe telekomunikacioneve. Ndërkohë, sipas vlerësimeve më të fundit, sektori i ndërtimit vazhdon të karakterizohet nga probleme të ndryshme, të cilat kanë çuar në një ngadalësim të prodhimit në këtë sektor.

Viti 2007 regjistroi një rritje të lartë të investimeve të huaja direkte, të cilat llogariten në 6 për qind të PBB-së. Një faktor tjetër që ka ndikuar në rritjen ekonomike ka qenë edhe ecuria pozitive e eksporteve, të cilat në vitin 2007 ishin 28 për qind më të larta se ato në vitin 2006.

Tabelë 1. Treguesit kryesorë makroekonomikë.

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Rritja reale e PBB-së (në %) ¹	8.9	7.7	6.5	4.7	6.0	6.0	5.5	5.0	6.0
PBB (me çmime korente, në miliardë lekë ²)	489	531	589	625	683	766	836	896	980
PBB (me çmime korente, në miliardë usd) ³	3.5	3.7	4.1	4.5	5.6	7.4	8.4	9.1	10.3
PBB (në usd për frymë)	1052	1086	1329	1438	1807	2389	2672	2903	3256
Numri i të punësuarve (në mijë)	1081	1068	1065	921	928	917	932	934	936
Përqindja e papunësisë	18.0	16.9	14.6	15.8	15.0	14.6	14.2	13.8	13.2
Përqindja e inflacionit (v/v)	-1.0	4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5	2.9
Deficiti i buxhetit (me grantet, në % të PBB-së)	-12.1	-8.2	-7.9	-6.6	-4.5	-5.1	-3.6	-3.1	-3.4
Borxhi publik (në % të PBB-së)	69.7	71.3	66.8	65.3	61.7	56.6	56.7	55.9	37.5
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së) ⁴	-32.3	29.4	25.8	23.5	20.6	18.0	17.5	17.2	16.9
Llogaria korente (pa transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	-8.5	-7.0	-6.1	-10.0	-7.9	-5.6	-7.7	-7.2	-10.0
Kursi mesatar i këmbimit, lek/usd	137.7	143.7	143.5	140.1	121.9	102.8	99.8	98.1	90.4
Kursi mesatar i këmbimit, lek/euro	147.0	132.6	128.5	132.4	137.5	127.7	124.2	123.1	123.6

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, vlerësime të FMN-së dhe Banka e Shqipërisë.

Kërkesa e brendshme mbeti e lartë gjatë gjithë vitit 2007, duke u reflektuar më së shumti në zgjerimin e kredisë konsumatore dhe në rritjen e importeve (më në veçanti shtimin e importeve për makineri dhe pajisje).

I gjithë aktiviteti ekonomik i vendit është zhvilluar në kushtet e një ambienti me inflacion nën kontroll, megjithë vështirësitë e shkaktuara nga lëvizjet e pandërprera të çmimeve të produkteve ushqimore në tregun ndërkombëtar. Çmimet e drithërave pësuan rritje të konsiderueshme, ndërkohë që të njëjtën ecuri regjistruan edhe artikujt ushqimorë në përgjithësi.

Për të përmbushur me sukses objektivin e saj për stabilitetin e çmimeve, Banka e Shqipërisë, duke vlerësuar rreziqet e rrjedhura prej zhvillimeve në anën e


kërkesës dhe në atë të ofertës, reagoi tre herë në drejtim të shtrëngimit të politikës monetare. Për rrjedhim, që nga muaji nëntor 2007, përqindja e marrëveshjeve të riblerjes me afat maturimi njëjavor, arriti nivelin 6.25 për qind.

Politika fiskale ka qenë një tjetër faktor, me kontribut pozitiv mbi ecurinë e përgjithshme të ekonomisë gjatë vitit 2007. Përgjithësisht, politika fiskale mund të konsiderohet si e shtrënguar, ku spikat një deficit buxhetor më i ulët se ai i planifikuar.

Viti 2007 përkon me reforma të rëndësishme në ekonomi. Ndër to veçohen përfundimi i Regjistrimit të Kredive, riorganizimi dhe forcimi i mbikëqyrjes së sektorit financiar, administrimi më i mirë i taksave dhe i shpenzimeve publike, privatizimi i Albtelecomit, përmirësimi i ambientit të biznesit nëpërmjet krijimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe reduktimi i mëtejshëm i tarifave doganore mbi një sërë produktesh, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Bashkimin Evropian.

2.2. PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit, ndërmarrjet prodhuese kanë realizuar një vëllim shitjesh rreth 18 për qind më të lartë sesa gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2006. Normat më të larta të rritjes vjetore janë regjistruar në sektorin e industrisë, në atë të tregtisë, në transport dhe telekomunikacion dhe në shërbimet e tjera.



Sektori i ndërtimit, për të dytin vit radhazi ka regjistruar një normë mjaft të ulët të rritjes së shitjeve, për periudhën janar-shtator. Në krahasim me vitet e mëparshme, sektorët që paraqesin përshpejtim të ritmeve të rritjes së shitjeve janë: industria, tregtia me shumicë, transporti dhe telekomunikacioni, dhe shërbimet e tjera.

2.2.1. INDUSTRIJA

Nëndega e industrisë nxjerrëse siguron rreth 8 për qind të shitjeve të përgjithshme të degës së industrisë⁵. Shitjet e industrisë nxjerrëse janë rritur me rreth 20 për qind në vitet 2005-2006, por kanë shënuar një rritje në nëntëmujorin e parë të vitit 2007, me rreth 50 për qind.

Tabelë 2. Tregues të sektorit të industrisë për vitin 2006 dhe për periudhën janar-shtator 2007 (ndryshim vjetor në përqindje).

	Shitjet		Punësimi		Paga	
	2006	2007*	2006	2007*	2006	2007*
Industria nxjerrëse	30.7	50.8	0.2	5.7	3.0	7.0
Industria përpunuese	22.7	18.1	1.2	1.4	2.7	5.9
Energji, ujë, gaz	0.9	22.6	-0.6	0.2	3.1	0.9
Industria gjithsej	17.7	21.3	0.6	1.5	2.8	4.7


Burimi: INSTAT, Shitjet nga TVSH-ja dhe Statistikat Afatshkurtra.

2.2.1.1. Industria Nxjerrëse

Shitjet e industrisë nxjerrëse gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2007 ishin rreth 50 për qind më të larta sesa ato, të së njëjtës periudhë të një viti më parë. Kjo është një ndër rritjet më të larta për nëntëmujorin, që nga viti 2003. Në mungesë të të dhënave për prodhimin, aktiviteti i kësaj nëndege vlerësohet në bazë të analizës së ecurisë së eksporteve të metaleve dhe mineraleve.

Këto eksporte gjatë vitit 2007 zinin rreth 30 për qind të vlerës së eksporteve të përgjithshme të vendit. Gjatë vitit 2007, Shqipëria ka eksportuar metale bazë dhe artikuj të prodhuar prej tyre, në një vlerë prej rreth 117 milionë eurosh. Kjo vlerë ishte rreth 15 për qind më e lartë se vlera e këtyre eksporteve gjatë vitit 2006.

Eksportet e artikujve të ndryshëm, të prodhuar nga metalet bazë, përbënin rreth 30 për qind të vlerës së përgjithshme të eksporteve të metaleve. Ndërsa, artikujt që kanë zënë peshën kryesore në eksportet e metaleve të përpunuara gjatë vitit 2007 janë: hekuri dhe çeliku, bakri dhe alumini.



Eksportet e artikujve mineralë shënuan një rritje prej rreth 160 për qind gjatë vitit 2007. Rreth 35 për qind e këtyre eksporteve ishte naftë bruto dhe 30 për qind xeheror kromi.

Eksportet e këtyre dy llojeve artikujsh gjatë vitit 2007 ishin rreth dy herë më të larta sesa eksportet e vitit 2006. Rritja e madhe në vlerën e eksporteve është shkaktuar edhe nga rritja e çmimeve të këtyre produkteve në tregjet botërore.

2.2.1.2. Industria Përpunuese

Shitjet e industrisë përpunuese u rritën me rreth 18 për qind gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2007. Industria ushqimore ka shënuar rritjen më të lartë vjetore të shitjeve (28 për qind). Kjo industri ka siguruar mesatarisht rreth 20 për qind të shitjeve të përgjithshme të industrisë përpunuese, gjatë viteve të fundit. Industria tekstile ka regjistruar norma pozitive rritjeje të shitjeve gjatë nëntëmujorëve të parë të dy viteve të fundit, në ndryshim nga vitet 2004-2005, kur ky ndryshim ishte negativ.

Një përmirësim gradual është vërejtur edhe në nëndegën e prodhimit të lëkurëve dhe këpucëve, e cila është rritur me përkatësisht 8 dhe 15 për qind, në dy vitet e fundit⁶. Prodhimi i artikujve mineralë jometalikë është rritur me më tepër se 20 për qind në krahasim me vitin e kaluar, duke shënuar një kthesë pozitive nga viti 2006.

Tabelë 3. Rritja vjetore e shitjeve të nëndegëve të industrisë përpunuese (në %).

NËNDEGA ⁷	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Ushqimore	-2	12	11	-9	20	28
Tekstile	0	20	-12	-11	5	18
Lëkurë, këpucë	-5	27	1	6	8	15
Punime me dru	-4	-24	22	-7	-7	8
Letra, kartoni	-20	22	-10	25	2	3
Koksifikimi, rafinimi	-3	-23	67	18	111	10
Kimike	7	-33	21	5	14	13
Kauçuk, plastikë	-18	108	-21	72	11	16
Artikuj mineralë jometalikë	-18	26	17	38	-6	23
Metalurgji dhe përpunim metalesh	-24	17	5	30	29	16
Makina, pajisje, pjesë ndërrimi	-31	68	-24	-2	20	-6
Pajisje elektrike dhe elektronike	34	95	52	-13	28	10
Mjete transporti	5	-81	113	-6	-13	1
Të tjera përpunuese	4	160	22	6	-8	33
INDUSTRIA PËRPUNUESE	9	15	9	11	20	18

Burimi: INSTAT.

2.2.1.3. Prodhimi dhe Përdorimi i Energjisë Elektrike

Viti 2007 përbën një nga periudhat më të vështira për sa i përket prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike. Për një pjesë të konsiderueshme të vitit, vendi u përball me një situatë të vështirë, në origjinë të të cilës ishte përgjysmimi drastik i prodhimit vendas.

	2006	2007	Ndryshimi vjetor (në %)
BURIMET	6,794	5,881	-13
Prodhim	5,551	2,947	-47
Import (përfshirë këmbimet)	1,242	2,935	136
PËRDORIMET	6,794	5,881	-13
Konsum/humbje vetjake	102	48	-53
Eksport (përfshirë këmbimet)	637	106	-83
Humbjet në rrjet	2,481	2,085	-16
-Humbjet në shpërndarje	2,260	1,873	-17
Përdorimi nga konsumatorët	3,573	3,641	2
-Konsumatorë familjarë	2,124	2,078	-2
-Konsumatorë jofamiljarë	1,448	1,563	8

Burimi: INSTAT.


Tabelë 4. Bilanci i energjisë elektrike (në GWH).

Në këto rrethana, importi i energjisë elektrike u gjykua si alternativa e vetme ndërkohë që burimet alternative të energjisë, si nafta dhe nënproduktet e saj shënuan çmime rekord në tregjet ndërkombëtare.

Nga një vështrim i shpejtë mbi statistikën e prodhimit dhe përdorimit të energjisë, bie në sy se ende mbizotëron konsumi familjar i energjisë i cili së bashku me humbjet në rrjet, përbën 70 për qind të energjisë së përdorur gjithsej.

Në vitin 2007 vëllimi i burimeve të energjisë elektrike ishte rreth 13 për qind më i ulët sesa në vitin 2006. Gjatë këtij viti është prodhuar rreth 50 për qind më pak energji elektrike dhe është importuar rreth 1.4 herë më shumë energji sesa në vitin 2006⁸. Vlera e importeve në milionë euro për vitin 2007, pa përfshirë këmbimet, ishte rreth 4.8 herë më e lartë sesa në vitin 2006. Profili i përdorimit të energjisë nuk ka shënuar ndryshime të theksuara në krahasim me vitet e mëparshme.

Rreth 35 për qind e sasisë së energjisë së furnizuar ka humbur në rrjetin e shpërndarjes, ndërkohë që konsumatorët familjarë dhe ata jofamiljarë kanë përdorur përkatësisht 35 për qind dhe 27 për qind të energjisë elektrike, të furnizuar gjithsej.



Kufizimi i ndjeshëm në prodhimin në vend të energjisë elektrike dhe në mënyrë të veçantë në prodhimin prej hidrocentraleve, ndërmjet të tjerash u shkaktua si rezultat i kushteve mjaft të pafavorshme atmosferike.

Viti i kaluar, evidentoi edhe një herë domosdoshmërinë për ndërtimin e burimeve të reja energjitike alternative. Rritja e imunitetit të ekonomisë ndaj burimeve hidroenergjitike, përbën një përparësi të madhe kombëtare të natyrës strategjike.

Nga ana tjetër, me të njëjtën rëndësi duhet të vlerësohet minimizimi i humbjeve në rrjet të cilat edhe pse janë ulur me 16 për qind gjatë vitit 2007, përsëri qëndrojnë në nivele kritike, me pasoja të drejtpërdrejta në gjendjen financiare të Korporatës Elektroenergjitike.

2.2.1.4. Ndërtimi

Viti 2007 nuk ishte i mbarë për sektorin e ndërtimit. Sipas të dhënave në dispozicion, vlerësohet se këtij sektori pothuajse i ka munguar rritja gjatë vitit të kaluar dhe për rrjedhim, edhe kontributi që jep në rritjen ekonomike të vendit.

Në analizat dy – tre viteve të fundit, Banka e Shqipërisë ka theksuar kujdesin që i duhet kushtuar degës së ndërtimit, një sektor i cili për shumë kohë ka qenë forcë udhëheqëse.

Tabelë 5. Tregues të sektorit të ndërtimit për vitet 2004-2006 dhe për periudhën janar-shtator 2007 (ndryshim vjetor në përqindje).

	2004	2005	2006	2007*
Shitjet	23.8	19.9	21.1	5.4
Punësimi	9.8	4.5	-0.4	-4.3
Paga	16.3	10.2	6.1	14.9
Vëllimi	15.0	11.2	1.7	-5.8
-Ndërtime të reja	21.1	11.8	9.9	-11.7
-Rindërtime	38.1	35.4	1.3	-9.0
-Punime inxhinierike	8.8	12.7	-15.4	14.2

Burimi: INSTAT, Statistikat Afatshkurtra.

Rritja vjetore e shitjeve në sektorin e ndërtimit gjatë vitit 2007 ka qenë pothuajse e pakonsiderueshme, duke qenë disa herë më e ulët sesa mesatarja vjetore e tre viteve të mëparshme (5 për qind nga rreth 20 për qind).

Si vëllimi i ndërtimeve të përgjithshme, ashtu edhe ai i ndërtimeve të reja kanë shënuar rënie në bazë vjetore, për periudhën janar-shtator 2007.

Tabelë 6. Disa tregues të industrisë së ndërtimit (ndryshime vjetore, në përqindje).

	2006			2007	
	III	IV	I	II	III
Vëllimi i ndërtimeve	-6.5	16.2	0.3	-1.9	-15.8
Ndërtime të reja	2.7	8.6	-5.7	-10.4	-19.1
Indeksi i punësimit	-0.4	1.2	-1.7	-4.5	-6.7
Konsumi i dukshëm i çimentos	19.24	-6.40	-27.01	6.00	-7.81
Indeksi i kushtimit në ndërtim	1.8	2.4	3.3	3.0	2.1

Burimi: INSTAT.


Vëllimi i punimeve inxhinierike ka qenë më i lartë sesa ai i një viti më parë, por ndërtimet e reja për banim dhe rindërtimet kanë shënuar rënie në krahasim me një vit më parë. Treguesi i punësimit në këtë sektor ka rënë me rreth 4 për qind, ndërkohë që pagat janë rritur me rreth 15 për qind.

2.2.1.5. Indeksi i çmimeve të banesave

Çmimet e banesave kanë vijuar të rriten edhe gjatë muajve të fundit të vitit 2007, megjithëse ritmi i rritjes ka rënë krahasuar me një tremujor më parë.

Kështu, në tremujorin e katërt të vitit çmimet e banesave për qytetin e Tiranës, të matura nga indeksi i çmimeve të banesave, në terma vjetorë janë rritur me 16.7 për qind, kundrejt rritjes me 24.8 për qind një tremujor më parë.

Rritja e çmimeve të banesave vlerësohet të ketë ardhur si pasojë e presioneve që janë krijuar në treg, për shkak të zvogëlimit të kapaciteteve të lira. Sipas statistikave afatshkurtra të INSTAT-it, si vëllimi i ndërtimeve në përgjithësi, ashtu edhe vëllimi i ndërtimeve të reja në veçanti, kanë regjistruar ritme negative rritjeje gjatë tremujorit të tretë, për të dytin tremujor radhazi. Ngadalësimi në rritjen e vëllimit të ndërtimeve, konfirmohet edhe nga ulja e vazhdueshme e konsumit të dukshëm të çimentos dhe nga rënia e indeksit të punësimit. Për të njëjtën periudhë edhe kostot e lidhura me ndërtimin, që maten nga indeksi i kushtimit në ndërtim, kanë vazhduar të rriten. Megjithatë, ritmi i rritjes së kostove të prodhimit është disa herë më i ulët sesa ritmi i rritjes së çmimeve.



2.2.1.6. Aktiviteti i hoteleve

Shifra e afarizmit e gjeneruar nga aktiviteti i hoteleve, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2007, ka shënuar një rritje të theksuar në krahasim me rritjen mesatare të vitit 2006. Kjo rritje ka qenë veçanërisht e lartë në dy tremujorët e parë të vitit. Numri i të punësuarve në hotelet e vendit është rritur me rreth 8 për qind, ndërkohë që paga ka shënuar një rritje të lartë prej rreth 35 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

	2006	T1-07	T2-07	T3-7
Shifra e afarizmit	5.4	26.7	34.4	6.8
Të punësuar	-2.9	11.5	4.0	7.8
Paga	14.2	53.0	40.2	11.5
Netë qëndrimi	16.7	14.4	27.3	4.8
Shqiptarë	11.6	17.0	29.4	3.1
Të huaj	23.5	8.5	21.8	18.7

Burimi: INSTAT, Statistikat Afatshkurtra.

Tabelë 7. Tregues të aktivitetit të hoteleve për vitin 2006 dhe për tre tremujorët e parë të vitit 2007 (ndryshim vjetor në %).

Kohëzgjatja e qëndrimit në hotele si për rezidentët, ashtu edhe për jorezidentët është rritur me rreth 15-16 për qind gjatë vitit 2007, një rritje kjo e krahasueshme me atë të vitit 2006.

2.2.1.7. Transporti dhe Telekomunikacioni

Shitjet e sektorit të transportit, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2007 ishin rreth 44 për qind më të larta sesa në të njëjtën periudhë të vitit 2006. Numri i personave të punësuar në transportin hekurudhor ka vazhduar të ulet, ndërsa numri i personave të punësuar në transportin detar, ka mbetur mesatarisht i pandryshuar gjatë vitit 2007, pas një rritjeje me rreth 45 për qind gjatë vitit 2006.

Tabelë 8. Tregues të aktivitetit të transportit dhe telekomunikacionit për vitin 2006 dhe për tre tremujorët e parë të vitit 2007 (ndryshim vjetor në %).

	2006	T1-07	T2-07	T3-7
Transport – ndryshimi vjetor i shitjeve nga TVSH	-5.5	49.3	46.8	37.7
A. Transporti hekurudhor				
- Të punësuar	-13.7	-5.8	-5.8	-4.1
- Paga	-7.5	-0.3	-2.6	-0.4
B. Transporti detar				
- Të punësuar	44.3	22.9	-10.9	-6.5
- Paga	59.1	25.7	47.5	24.3
C. Transporti ajror				
- Të punësuar	-31.0	0.0	0.0	0.0
- Paga	11.3	0.0	0.0	0.0
Komunikacion -ndryshimi vjetor i shitjeve nga TVSH	12.0	-5.4	23.3	9.6
- Të punësuar	5.7	9.9	9.8	2.2
- Paga	5.4	13.9	11.8	18.4

Burimi: INSTAT, Statistikat Afatshkurtra.

Niveli i pagave në transportin detar ka vazhduar të rritet me ritme të larta vjetore, pavarësisht rritjes me rreth 60 për qind në vitin 2006. Sektori i komunikacionit ka regjistruar rritje mesatare pozitive të shitjeve, gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2007. Numri i të punësuarve dhe niveli i pagave në këtë sektor, kanë vazhduar të rriten në secilin prej tremujorëve në krahasim me tremujorët përkatës të vitit të kaluar.

2.3. ÇMIMET

2.3.1. ÇMIMET E KONSUMIT


Gjatë vitit 2007, norma e inflacionit pësoi luhatje të ndjeshme, duke kaluar nga vlerat e ulëta të tremujorit të dytë (1.8 për qind), në një dyfishim të kësaj vlere në dy tremujorët e tjerë në vijim. Inflacioni vjetor në tremujorin e katërt të vitit 2007 shënoi të njëjtën vlerë me tremujorin paraardhës prej 3.6 për qind. Vlerën më të lartë inflacioni e realizoi në muajin shtator (4.4 për qind), ndërkohë që norma e inflacionit ra në dy muajt e fundit të vitit, duke iu afruar objektivit të Bankës së Shqipërisë. Faktorët e ofertës dhe të kërkesës kanë ushtruar presion në drejtim të rritjes së inflacionit në pjesën e dytë të vitit, ndonëse presionet janë paraqitur më të zbutura në tremujorin e fundit të vitit krahasuar me atë paraardhës.

Ecuria e inflacionit gjatë vitit 2007 reflektoi nivelin e lartë të çmimeve të disa produkteve ushqimore bazë si dhe rritjen e mëtejshme të çmimit të naftës. Në tremujorin e katërt dhe veçanërisht në tremujorin e dytë, kushtet më të favorshme të motit rritën ofertën vendase, duke ushtruar presion në drejtim të uljes së çmimeve për një pjesë të produkteve ushqimore të papërpunuara të sezonit. Nga ana tjetër, çmimet e disa artikujve të tjerë ushqimorë, kryesisht të përpunuar (midis të cilëve, produkti më i rëndësishëm është buka), duke filluar nga tremujori i tretë i vitit u karakterizuan nga rritje të njëpasnjëshme, që ndikuan drejtpërdrejt në rritjen e inflacionit total.

Megjithë një stabilizim të përkohshëm, situata e çmimeve të kësaj kategorie mallrash vazhdoi të mbetej e paqartë edhe në fundin e vitit, për shkak të varësisë së tyre nga çmimet e importit, të cilat vazhduan të shënonin norma të larta inflacioni. Për më tepër, rritja e mëtejshme e çmimit të karburanteve, e shoqëruar me krizën energjitike, bëri që të rriteshin kostot e prodhimit duke krijuar presione të mëtejshme për rritjen e çmimeve të konsumit. Në tremujorin e tretë dhe atë të katërt të vitit, kurba e inflacionit pësoi një zhvendosje në rënie si rezultat i shuarjes së efektit të rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe të akcizave të duhanit, të ndërmarra gjatë vitit 2006. Ky efekt kompensoi me disa pikë përqindjeje veprimin e faktorëve të ofertës.


Matjet alternative të inflacionit neto tregojnë se norma e lartë e inflacionit erdhi si rezultat i kontributit të lartë të rritjes së çmimit të ushqimeve të përpunuara. Nga ana tjetër, rritja e çmimit të energjisë nuk u krye në mes të vitit 2007, siç ishte parashikuar. Për rrjedhojë, kontributi i kategorisë së çmimeve të administruara tek norma e përgjithshme e inflacionit, u bë pothuajse i papërfillshëm.

Grafik 5. Inflacioni total dhe inflacioni bazë (ndryshime vjetore në %).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 6. Matje alternative të inflacionit neto: Inflacioni pa ushqimet (majtas) dhe inflacioni pa ushqimet dhe çmimet e administruara dhe pa ushqimet dhe shërbimet (djathtas).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Kategoritë “Ushqime të përpunuara”, “Ushqime të papërpunuara”, “Strehim” dhe “Shërbime” formuan pjesën më të madhe të normës vjetore të inflacionit, gjatë vitit 2007.

Inflacioni relativisht i lartë vjetor në tremujorët e tretë e të katërt të vitit 2007, u përcaktua kryesisht nga inflacioni i kategorisë “Ushqime të përpunuara”.

Hapësirë informuese 1. Zhvillimet në çmimet e produkteve ushqimore në tregjet botërore dhe në Shqipëri.

Çmimet e produkteve ushqimore dhe bujqësore në tregjet botërore kanë regjistruar një prirje rritëse që prej vitit 2001, ndërkohë që përshpejtuan ndjeshëm ritmet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2007.


Sipas Bankës Qendrore Evropiane⁹, rritja e fundit e çmimeve të produkteve ushqimore ka ardhur kryesisht nga faktorë të kahut të ofertës të tillë si: rritja e çmimeve të lëndëve energjitike, shtrenjtimi i plehrave kimikë, nivelet e ulëta të rezervave dhe moti i thatë.

Megjithatë, nuk kanë munguar edhe presionet nga ana e kërkesës, të cilat janë nxitur nga dy faktorë:

I pari, lidhet me ndryshimin në sjelljen konsumatore të disa ekonomive në zhvillim si Kina, India dhe me mënyrën e përdorimit të produkteve të tjera bujqësore për të ushqyer bagëtinë.

I dyti, lidhet me programet e qeverive për zhvillimin e burimeve alternative për prodhimin e karburanteve (bio-karburanteve) nëpërmjet lëndëve të para bujqësore.

Grafik 7. Indeksi i çmimeve të produkteve ushqimore¹⁰.



Rrjedhimisht, fermerët janë orientuar drejt prodhimit të këtyre bimëve (si misri për shembull), duke shkaktuar rënien e ofertës për produktet e tjera bujqësore dhe rritjen e çmimeve të tyre.

Rritja e çmimeve të këtyre produkteve në tregjet botërore ka shkaktuar rritjen e ndjeshme të çmimeve të produkteve ushqimore, në pothuajse të gjitha vendet evropiane. Megjithatë, masa në të cilën kjo goditje është përçuar në vende të veçanta ka variuar ndjeshëm.

Struktura e tregut ku tregtohet me pakicë, shkalla e konkurrencës në këtë treg si dhe në rrjetin e shpërndarjes janë faktorë që mund të shpjegojnë reagimin e ndryshëm të tregtarëve me pakicë ndaj një goditjeje të jashtme të njëjtë dhe rrjedhimisht, ndryshimet e vërejtura në ecurinë e çmimeve të konsumit për produktet ushqimore ndërmjet vendeve.

Tabelë 9. Inflacioni vjetor i grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” (në përqindje).

	BE	Greqi	Itali	Hungari	Sloveni	Rumani	Turqi	Kroaci	Maqedoni	Serbi	Shqipëri
2003	1.9	4.9	3.2	1.4	4.5	14.6	27.6	0.6		0.9	4.1
2004	3.0	0.9	2.1	5.6	0.2	9.4	8.6	0.2	-1.6	11.1	-0.1
2005	0.9	0.8	-0.1	1.6	-1.0	6.1	3.9	3.2	1.6	19.5	-0.4
2006	2.3	3.4	1.8	8.2	2.3	3.9	7.8	-2.0	3.3	10.6	1.1
2007	3.4	2.2	2.9	12.0	7.2	3.9	12.4	0.8	1.6	6.0	3.1
2008 M1	6.3	5.2	4.5	13.6	13.0	10.0	9.2				

Burimi: EUROSTAT, HCPI dhe Institutet Statistike Kombëtare të katër vendeve të fundit.


Në një ekonomi të orientuar drejt importeve, si është ekonomia jonë, ndryshimet në çmimet e produkteve ushqimore në tregjet botërore japin efekt si në çmimet e produkteve të gatshme ushqimore të importuara ashtu edhe në çmimet e mallrave, që shërbejnë si lëndë e parë për prodhimin vendas.

Nga analiza krahasuese e vendeve të rajonit rezulton se Shqipëria ka qenë midis vendeve që e kanë ndjerë më shumë rritjen e çmimeve të produkteve ushqimore (kryesisht drithit). Meqë kategoria “Ushqime të përpunuara” zë peshën më të madhe në shportën e mallrave të konsumit (rreth 24 për qind), për shkak të mungesës së prodhimit në vend dhe ndoshta edhe për motive spekulimi nga tregtarët e tregtisë me pakicë, kostot e rritura iu kaluan konsumatorit vendas.

E ardhmja për çmimet e produkteve ushqimore në botë dhe në vend, mbetet shumë e pasigurt. Megjithëse oferta për produktet bujqësore do të rritet në mënyrë që të plotësojë kërkesën në rritje, periudha e përshtatjes mund të shoqërohet me kosto shtesë. Gjithashtu, zhvillimet në çmimet e produkteve ushqimore varen nga disa faktorë që janë të vështirë për t’u parashikuar, duke përfshirë motin, përparimet teknologjike dhe politikat për lëndët energjitike. Për më tepër, prodhues të mëdhenj të drithit kanë adoptuar politika mbrojtëse, duke aplikuar taksa të larta për eksportet e drithërave. Në afat të mesëm vlerësohet që rreziku të jetë i qenësishëm.


Kategoria “Ushqime të përpunuara” shënoi një normë vjetore inflacioni prej 9.5 për qind dhe 10.6 për qind, respektivisht në dy tremujorët e fundit të vitit. Ndërkohë që gjatë tetë viteve të mëparshme, inflacioni vjetor i kësaj kategorie ka regjistruar vlera pothuajse të papërfillshme. Ritmet e larta të rritjes në çmimet e kësaj kategorie që prej muajit gusht 2007, janë shkaktuar kryesisht nga rritja e çmimit të bukës në vend.

Grafik 8. Ndryshimi vjetor i indeksit të vlerës njësi të importeve për produkte ushqimore (në%).




Burimi: INSTAT.

Grafik 9. Prodhimi i drithit në vend dhe importi i tij.



Burimi: Vjetari statistikor MBUMK, ACIT.



Ndërkohë, me rritje paraqiten edhe çmimet e nënkategorive të produkteve të bulmetit dhe vajrave, të cilat reflektojnë kostot më të larta të prodhimit, për shkak të krizës energjitike në vend dhe shtrenjimit të çmimeve të kësaj kategorie mallrash në vendet partnere kryesore tregtare të Shqipërisë (Itali dhe Greqi).

Inflacioni vjetor i kategorisë “Ushqime të papërpunuara” pësoi një rënie të lehtë në tremujorin e fundit të vitit (5.5 për qind), nga 6.6 për qind që ishte një tremujor më parë. Gjithsesi, këto vlera ishin larg atyre të shënuara në dy tremujorët e parë të vitit respektivisht -0.5 dhe -3.6 për qind. Brenda kësaj kategorie, çmimet e perimeve shënuan rënie më të madhe në nivel vjetor.

Tabelë 10. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).

	T4-06	T1-07	T2-07	T3-07	T4-07
Ushqime të përpunuara (pp)	0.5	0.7	0.6	1.6	2.4
- Bukë dhe drithëra* (pp)	0.1	0.0	0.3	4.5	7.2
- Alkol dhe duhan* (pp)	1.6	1.7	1.9	1.3	0.7
Ushqime të papërpunuara (pp)	-0.2	0.2	-0.7	0.4	0.5
- Fruta* (pp)	-1.4	-2.4	-3.1	1.1	2.6
- Perime* (pp)	0.0	3.0	-0.6	1.7	-0.4
Shërbime (pp)	0.2	0.2	0.3	0.4	0.4
Çmime të administruara (pp)	0.9	0.8	0.8	0.4	0.1
- Lëndë djegëse dhe energji* (pp)	7.8	7.6	7.8	2.7	0.3
Strehim (pp)	1.1	0.9	0.9	0.6	0.2
Indeksi i Çmimeve të Konsumit (v/v, %)	2.6	2.8	1.8	3.6	3.6


Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

*Kontributi në inflacionin vjetor të kategorisë.

Zhvillimet në çmimet e kësaj kategorie janë të lidhura ngushtë me prodhimin e brendshëm bujqësor, i cili për shkak të kushteve më të favorshme klimaterike ka ndihmuar në rritjen e ofertës vendase në pjesë të veçanta të vitit. Zhvillimet e favorshme të ofertës vendase kanë zbutur presionet inflacioniste që përçohen nga kërkesa e lartë për këta mallra të konsumit të përditshëm si dhe nga çmimet e larta të importit.

Kategoritë e tjera të shportës dhanë një kontribut në rënie në vlerën e inflacionit në vitin 2007. Inflacioni vjetor i kategorive “Strehim” dhe “Mallra të administruar” është luhatur rreth vlerave 4-5 për qind, deri në muajin shtator. Ndërsa në pjesën e mbetur të vitit mesatarja e inflacionit vjetor ka qenë 0.8 për qind. Kjo rënie është ndikuar edhe nga efekti statistikor i bazës së lartë të krahasimit me tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Inflacioni i kategorisë “Shërbime” vazhdon të shënojë ritme të larta rritjeje. Norma vjetore e inflacionit të kësaj kategorie shënoi 4 për qind, në muajin dhjetor. Mesatarisht, norma e inflacionit në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2007 është rritur me 1.5 për qind, krahasuar si me gjashtëmujorin e parë të vitit 2007 ashtu dhe me periudhën


korresponduese të një viti më parë. Rritja ka reflektuar në pjesën më të madhe rritjen e çmimeve të shërbimeve të hotelerisë dhe të restoranteve, të cilat janë përballur me kosto shtesë, të shkaktuara nga përdorimi i alternativave zëvendësuese, për sigurimin pa ndërprerje të energjisë elektrike.



Pavarësisht rritjes së çmimit të karburanteve, kontributi i kategorisë "Mallra konsumi joushqimorë" ka qenë i pandjeshëm në inflacionin e këtij viti. Po kështu ka ndodhur dhe me kategorinë "Mallra konsumi afatgjatë", e cila ka regjistruar norma negative inflacioni prej një periudhe të gjatë, prirje kjo më e dukshme në tremujorin e fundit. Ndikimi i luhatjeve të inflacionit të këtyre kategorive tek norma e përgjithshme është më i rëndësishëm, me kompozimin e ri të shportës së inflacionit, ku të dyja këto kategori marrin një peshë më të madhe në shpenzimet mesatare të popullatës.

2.3.2. MATJE TË TJERA TË INFLACIONIT

Inflacioni bazë. Norma mesatare e inflacionit bazë gjatë vitit 2007 ishte 2.6 për qind apo 0.8 pikë përqindjeje më e lartë se sa ajo e një viti më parë. Prirja rritëse e inflacionit bazë, e nisur që prej fillimit të vitit 2005, konfirmoi praninë e presioneve inflacioniste me natyrë jo të përkohshme në ekonominë e vendit. Shtimi i tyre u theksua ndjeshëm gjatë pjesës së dytë të vitit 2007, gjë që u faktua në vlerat e larta të inflacionit bazë. Në këtë periudhë, mesatarja e normës vjetore të inflacionit bazë mesatar arriti 3.4 për qind, duke kapur nivelet më të larta të këtij treguesi në pesë vitet e fundit. Rritjet e vazhdueshme të çmimeve të disa artikujve¹¹, bënë që komponentja e përhershme e inflacionit¹² të shënojë vlera relativisht të larta në një periudhë afatmesme, ndërkohë që kontributi mesatar vjetor i saj në inflacionin total për vitin 2007¹³ ishte i konsiderueshëm, në rreth 2 pikë përqindjeje.



Inflacioni në sektorin e mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm. Shtimi i presioneve inflacioniste me origjinë jashtë ekonomisë së vendit është reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në inflacionin e përgjithshëm të vitit 2007, nëpërmjet rritjes së çmimeve të mallrave të tregtueshëm,¹⁴ sidomos gjatë pjesës së dytë të vitit. Inflacioni në sektorin e mallrave të tregtueshëm gjatë vitit 2007, pasqyroi në mënyrë të ndjeshme luhatjet dhe koniukturat e pafavorshme të çmimeve në tregjet e huaja. Çmimet e këtij sektori në Shqipëri, janë ndikuar dukshëm nga ato të grupit “Ushqime” të shportës së konsumit të Greqisë¹⁵. Rritjet e çmimeve të naftës, të gazit dhe të energjisë, në tregjet ndërkombëtare kanë ndikuar në çmimet e lëndëve të para dhe të mallrave të ndërmjetëm të importuar, duke shtuar kostot e prodhimit dhe të shërbimeve në ekonominë e vendit.

Si rezultat i pranisë së faktorëve të mësipërm, inflacioni vjetor i sektorit të tregtueshëm të çmimeve të konsumit paraqiti një luhatshmëri mjaft të lartë gjatë vitit 2007. Ndërsa periudha janar-korrik 2007 regjistroi vlera të ulëta historike rreth një mesatareje prej 0.3 për qind, pjesa e mbetur e vitit u përball me rritje të konsiderueshme të vlerave të këtij treguesi. Muaji shtator 2007 shënoi vlerën më të lartë historike të inflacionit vjetor të sektorit të tregtueshëm në vite (7.1 për qind). Ndërkohë që, në muajt e fundit të vitit ritmet rritëse të tij u frenuan duke u luhatur rreth një mesatareje prej 5.3 për qind. Inflacioni në sektorin e patregtueshëm të çmimeve të konsumit, dominohet kryesisht nga shërbimet si edhe nga mallra të tjerë pothuaj të paimportuar. Ai shpjegon në mënyrë më të drejtpërdrejtë presionet inflacioniste, të gjeneruara më së shumti nga kërkesa e brendshme. Këto të fundit kanë vijuar të jenë të konsiderueshme edhe gjatë vitit 2007. Ky vlerësim, mbështetet edhe nga shifra relativisht e lartë e inflacionit mesatar vjetor në sektorin e patregtueshëm të çmimeve të konsumit (3.6 për qind). Gjatë periudhës janar-korrik të këtij viti vlera mesatare e tij ishte rreth 4.5 për qind, ndërkohë që frenimi i rritjes së inflacionit të këtij sektori filloi të shfaqej pas muajit gusht 2007 e në vijim. Nga ky muaj filloi të reflektohet shuarja e efektit të çmimit të energjisë, të rritur administrativisht një vit më parë. Ndërkohë

që në prirjen rënëse të inflacionit të sektorit të patregueshëm, vlerësohet të kenë ndikuar edhe vendimet e kaluara të politikës monetare¹⁶, të cilat kanë synuar frenimin e ritmeve mjaft të larta të kërkesës agregate në ekonomi.

Hapësirë informuese 2: Të rejat e rishikimit të shportës së IÇK-së: 2007.

- Duke krahasuar shportat e IHÇK.

Një vështrim krahasues mbi strukturën e shportës së IHÇK¹⁷ së grupvendeve sipas kohëanëtarësisë së tyre në BE¹⁸ tregon se:

- struktura e shportës sipas 12 grupeve kryesore, është mjaft më e qëndrueshme, përgjatë periudhës referuese në vendet me ekonomi më të konsoliduara, anëtare të hershme të BE (aneks 1 - tabelë 1);
- në anëtarët e vjetër, peshën kryesore në shportën e IHÇK përgjatë periudhës 1996-2008 e zënë shpenzimet për shërbime, strehim lëndë djegëse dhe energji ndërkohë që shpenzimet për mallra të tjerë (ushqimorë dhe joushqimorë) zënë rreth 1/3 e saj;
- në anëtarët e rinj, (aneks 1 - tabelë 2 dhe 3), pesha e shpenzimeve për shërbime, strehim lëndë djegëse dhe energji shënon rënie, duke u vlerësuar përkatësisht në secilin grup në nivel mesatar afër 57 për qind dhe 44 për qind;
- kalimi nga grupvendet anëtare më të hershme të BE në ato më të rejat, shoqërohet me ndryshime më të thella të strukturës së shportës;
- reduktimi në kohë i peshës së grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" shënon vlerat më të larta për anëtarët e rinj.

- Shporta e re e IÇK në Shqipëri: dhjetor 2007.

Që prej periudhës 1992-1993, historia e kompozimit dhe e rishikimit të shportës së IÇK-së në Shqipëri, numëron tre të tilla përkatësisht në vitet 1993, 2001 dhe 2007. Struktura e shpenzimeve mesatare të një familjeje sipas shportës së parë, tregoi se rreth 83.5 për qind e tyre orientoheshin për "Mallra ushqimorë dhe joushqimorë" dhe vetëm 16.5 për qind e tyre shkonin për grupet e ndryshme të shërbimeve dhe për "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji".

Shporta e IÇK-së së vitit 2001, solli një listë më të detajuar të grupeve kryesore të shpenzimeve për konsum, të krahasueshme me atë të standardeve të statistikave ndërkombëtare¹⁹. Reduktim të ndjeshëm pësoi pesha e grupit ushqimor, ndërkohë që shpenzimet e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji", u rritën dukshëm dhe grupi "Hotele, kafene dhe restorante" hyri si një zë më vete në shportën e konsumit. Përmbajtja e shportës më të re të IÇK-së dhe peshat e artikujve të saj rezultuan në bazë të "Anketës së Buxhetit të Familjes", të realizuar nga INSTAT gjatë periudhës tetor 2006 - shtator 2007, pranë një kampioni të gjerë familjesh të shpërndara në të gjithë territorin e vendit.

Kjo anketë mblodhi të dhëna mbi shpenzimet e tyre në nivel prefekturë, si në zonat e qyteteve ashtu edhe të fshatrave. Në rishikimin e shportës së vitit 2001, u mblodh informacion vetëm në zonat e qyteteve (urbane) të Shqipërisë. Shporta e vitit 2001 përfshinte 262 artikuj për të cilët merrej informacion për çmimet, ndërsa shporta e re do të mblodhë çmimet e një liste më të gjerë artikujsh, 272 të tillë. Një tjetër aspekt i rishikimit më të fundit të shportës së IÇK-së është diferencimi i peshave të artikujve sipas prefekturave. Kështu, artikujt e shportës do të kenë pesha të ndryshme midis prefekturave, në varësi të modelit të konsumit të familjeve në çdo prefekturë.

Shporta e re do të mbledhë informacion edhe për kategorinë e vetëkonsumit, e cila supozohet të zërë një peshë relativisht të konsiderueshme në konsumin e familjeve në fshat. Si periudhë bazë në llogaritjen e indeksit, do të shërbejë muaji dhjetor 2007. Struktura e shportës së re (tabelë 3), tregon një rënie të lehtë të peshës së grupeve "Ushqime dhe pije joalkolike" dhe "Hotele, kafene dhe restorante", një rënie të ndjeshme të peshës së grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" dhe rritje të dukshme në peshën e grupit "Mobilim". Rritja e peshës së grupeve "Shëndet", "Transport", "Komunikim" rezulton mjaft e moderuar. Lidhja e IÇK-ve sipas shportës së vjetër me ato të shportës së re, vlerësohet të jetë bërë në mënyrën më të përshtatshme të mundshme.

Megjithatë, efektet e kalimit nga shporta e vjetër (2001) në të reën (2007) në serinë e plotë të IÇK-së, pritet të shuhet plotësisht 12 muaj pas prezantimit të indeksit me shportën e re.

2.3.3. ÇMIMET E PRODHIMIT

Lëkundjet në indeksin e çmimeve të prodhimit (IÇP) pritet të japin ndikimin e tyre në ecurinë e çmimeve të konsumit. Megjithatë, një lidhje statistikore midis çmimeve të prodhimit dhe atyre të konsumit në bazë të të dhënave të disponueshme në vite, nuk është evidentuar ende. Arsyeja për këtë mospërputhje mund të jetë fakti që pjesa e prodhimit në vend nuk ka qenë përcaktuese në ofertën e mallrave në tregun shqiptar, duke mos ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në çmimet e konsumit. Nga ana tjetër, përcimi i kostove në hallkën përfundimtare të konsumit, mund të jetë penguar dhe nga faktorë të tjerë si: rritja e konkurrencës në segmentin e tregtisë me pakicë, si dhe nga kohëvonesat që mund të kërkojë një kalim i tillë.

Gjatë vitit 2007, rritja e kostove të prodhimit, u përcoll në një shkallë më të lartë në çmimet e konsumit. Një arsye është se rritja e çmimeve të konsumit ka ardhur, në pjesën më të madhe të saj, nga rritja e çmimeve të mallrave (në mënyrë të veçantë janë rritur çmimet e mallrave ushqimorë dhe atyre energjitikë), ndërkohë që çmimet e shërbimeve nuk kanë pësuar luhatje të theksuara. Koniuktura e pafavorshme e çmimeve të mallrave në tregun botëror, ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë si në çmimet e mallrave në tregun e pakicës (çmimet e konsumit) ashtu edhe në ato që shërbejnë si lëndë të para për prodhimin në vend (çmimet e prodhimit). Situata e përkeqësuar energjitike, gjatë gjysmës së dytë të vitit, ka ndikuar në rënieën e produktivitetit, duke ushtruar presion në rritjen më tej të kostove të prodhimit. Si përfundim, si kanali i kostove të prodhimit ashtu dhe ai i çmimeve të importit ndikuan në kahun rritës mbi çmimet e konsumit. Fakti që sektori "Industria përpunuese" punon, në pjesën më të madhe të tij me lëndë të parë të importuar, pati si pasojë, që ky i fundit të shënojë rritjen më të madhe vjetore të çmimeve, nga 14.4 për qind në tremujorin e parë të vitit, në 6.7 për qind në tremujorin e katërt. Mesatarisht, çmimet e prodhimit për këtë sektor kanë pësuar një rritje të dukshme me gati 9 për qind, ndërkohë që gjatë vitit të kaluar rritja ishte nën 1 për qind. Në këtë industri rritja e ndjeshme u regjistrua kryesisht tek sektorët "Industria ushqimore" dhe "Industria tekstile dhe e veshjeve", duke u reflektuar dhe në ecurinë e çmimeve të konsumit. Ndryshimet vjetore

të çmimeve në sektorin “Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit” si dhe në atë të “Industrisë nxjerrëse”, regjistruan norma në rënie krahasuar me një vit më parë, por pa ndikuar ndjeshëm në totalin e çmimeve të prodhimit.

	IÇP	IÇP Industria përpunuese gjithsej	IÇP Industria përpunuese ushqimore	IÇK- Kategoria “Ushqime të përpunuara”	IÇP Industria nxjerrëse
T1:06/T1:05	0.9	0.7	-0.1	0.0	7.3
T2:06/T2:05	-0.1	-0.5	-4.4	0.5	10.8
T3:06/T3:05	0.4	1.2	-2.1	1.1	8.4
T4:06/T4:05	-0.7	1.5	1.4	2.4	8.3
T1:07/T1:06	2.1	14.4	2.5	3.2	8.1
T2:07/T2:06	3.3	7.3	11.3	2.9	2.8
T3:07/T3:06	3.8	5.2	12.8	7.3	0.9
T4:07/T4:06	5.2	6.7	16.5	10.8	3.2

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 11. Normat vjetore të ndryshimit të disa përbërësve të IÇP-së dhe të IÇK-së së kategorisë “Ushqime të përpunuara” (në %).

2.4. TREGU I PUNËS

2.4.1. PUNËSIMI DHE PAPANËSIA

Duke u mbështetur në të dhënat zyrtare të disponueshme për fundin e tremujorit të tretë të vitit 2007, mund të konkludohet se numri i të punësuarve ka ardhur në rritje. Ndërkohë, njësoj si vitet e kaluara vazhdon e njëjta mënyrë vlerësimi për forcat e punës të sektorit bujqësor. Në fund të muajit shtator, numri i të punësuarve ishte 936 mijë vetë.

Përgjithësisht, vihet re një përputhje e pranueshme midis ecurisë së sektorëve ekonomikë me zhvillimet e tregut të punës. Punësimi është rritur me ritme të larta në sektorin e industrisë dhe në atë të shërbimeve.

Më konkretisht, punësimi në sektorin e industrisë u rrit me 7 për qind në bazë vjetore, si pasojë e rritjes me 10 për qind në degët e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese. Për sektorin e shërbimeve-hotele, indeksi i punësimit tregon një rritje prej 8 për qind.

Në sektorin e ndërtimit, numri i të punësuarve gjatë tremujorit të tretë ka vazhduar të bjerë, paralelisht me ngadalësimin e prodhimit dhe të shitjeve në bazë vjetore. Sektori i transportit vijon të regjistrojë një vëllim më të lartë shitjesh, me një numër më të vogël punonjësish.

Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror ra me rreth 3 mijë vetë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2007 krahasuar me një vit më parë, ndërkohë që në sektorin privat u punësuan rreth 5 mijë vetë. Rritja e punësimit në bazë vjetore ishte në nivele më të larta në sektorin privat (rreth 4,700 persona). Norma e papunësisë regjistroi nivelin prej 13.18 për qind në fund të tremujorit të tretë të vitit 2007. Kjo normë ra me 0.6 pikë përqindjeje në nivel vjetor, duke regjistruar rënien më të lartë të papunësisë që prej vitit 2004.


Tabelë 12. Ecuria e treguesve të papunësisë dhe të të punësuarve (në mijë persona).

	IV-05	I-06	II-06	III-06	IV-06	I-07	II-07	III-07
FORCAT E PUNËS	1086	1083	1081	1084	1085	1080	1078	1078
Të punësuar gjithsej	932	931	931	934	936	933	933	936
Sektorët								
- sektori shtetëror	175	174	172	171	169	168	167	167
- privat jobujqësor	215	215	217	222	224	223	224	227
- privat bujqësor	542	542	542	542	542	542	542	542
Të PAPUNË	154.0	151.9	150.1	149.7	148.6	147.7	145.1	142.2
Përfitojnë pagesë papunësie	11.2	11.5	11.2	11.4	11.3	10.3	9.9	9.7
Shkalla e papunësisë	14.2%	14.0%	13.9%	13.8%	13.7%	13.7%	13.5%	13.2%

Burimi: INSTAT.


Rënia e numrit të të papunëve me ritme më të shpejta se rritja e numrit të të punësuarve, u pasqyrua në një rënie të numrit të vlerësuar të forcave të afta për punë. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2007, forca e aftë për punë u zvogëluar me 6 mijë individë në bazë vjetore.

Grafik 13. Ecuria e pagës në sektorin e industrisë dhe ndërtimit.



Burimi: INSTAT.

Grafik 14. Ecuria e pagës mesatare në sektorin publik (ritje vjetore, në përqindje).



Burimi: INSTAT.

Shfaqja e kësaj dukurie në nivele më të larta mund të jetë rezultat i natyrës informale të marrëdhënieve të punës, i emigracionit dhe mospërputhjes midis ofertës dhe kërkesës për punë.

Zbatimi i programeve të praktikave profesionale për punëkërkesit dhe konsolidimi i qendrave të formimit profesional në rrethet jashtë Tiranës, të zbatuar gjatë vitit 2007, pritet të rrisin ofertën e punës, për periudhat e ardhshme.

2.4.2. ECURIA E PAGAVE

Pagat²⁰ e të gjithë sektorëve kanë ardhur në rritje gjatë vitit 2007, megjithëse kjo nuk ka qenë e njëtrajtshme. Rritja e pagës mesatare në sektorin shtetëror në nivel vjetor ishte rreth 23 për qind, gjatë tremujorit të tretë të vitit dhe rreth 12 për qind krahasuar me tremujorin paraardhës.

Në fund të tremujorit të tretë, mesatarja vjetore e rritjes së regjistruar të këtij niveli page ishte rreth 18 për qind, më e larta që prej vitit 2002. Rritja mesatare e pagave në sektorin privat nuk ndoqi rritjen e theksuar të tremujorit të dytë, duke shënuar rritje mesatare vjetore prej rreth 13 për qind në tremujorin e tretë.

Paga minimale e miratuar dhe pagesat për papunësinë nuk kanë ndryshuar që prej vitit 2006, ndërkohë që numri i personave që përfitojnë pagesë papunësie ka ardhur në rënie.

Rritja e pagave në sektorin e industrisë dhe ndërtimit shënoi një normë më të lartë, përkatësisht rreth 23 për qind dhe 19 për qind. Pagat u rritën me një normë më të ulët në sektorin e shërbimeve prej rreth 12 për qind, 28 pikë përqindjeje më pak se gjatë tremujorit të dytë të vitit.

2.5. SEKTORI FISKAL

Edhe gjatë vitit 2007, autoritetet kryesore në fushën e vendimmarrjes ekonomike dhe financiare, Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Banka e Shqipërisë, arritën të harmonizonin dy politikat bazë në ekonomi, atë fiskale me atë monetare. Ky harmonizim u pasqyrua në programin afatmesëm të zhvillimit të vendit, i cili edhe gjatë vitit 2007 gëzoi mbështetjen e FMN-së, si pjesë e lehtësive që ofrohen prej saj PRGF dhe EFF. Panorama e fundvitit paraqet një ecuri të kënaqshme të treguesve kryesorë fiskalë, të cilët kanë qëndruar në kufijtë e përcaktuar nga Ministria e Financave. Politika fiskale, në pjesën më të madhe të vitit 2007, mund të cilësohet si shtrënguese, pasi ka qenë më shumë e orientuar drejt vjeljes së të ardhurave, sesa drejt kryerjes së shpenzimeve. Megjithatë, si edhe në vitet paraardhëse, në muajin e fundit të këtij viti është vërejtur përqendrimi i realizimit të shpenzimeve, gjë që ka ndikuar në rritjen e luhatshmërisë së normave të interesit në tregjet financiare. Ndërkohë, me shumë kujdes duhet analizuar edhe ecuria e tatimit mbi fitimin, i cili gjatë vitit 2007 si rrallë herë ka pësuar rënie në raport me vitin e kaluar.

Tabelë 13. Treguesit fiskalë në përqindje ndaj PBB-së.


	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Të ardhura totale	25.05	26.12	24.98	24.97	24.83	24.09	24.55	24.98	25.69	25.70
- Të ardhura tatimore	17.74	17.72	19.91	19.59	20.71	20.95	22.10	22.49	23.01	23.33
Shpenzimet totale	34.61	35.14	32.62	31.89	30.92	28.98	29.62	28.43	28.98	29.14
- Shpenzime kapitale	5.92	7.24	6.94	7.44	6.09	4.53	5.10	4.69	5.72	5.79
Deficiti buxhetor	(9.56)	(9.02)	(7.64)	(6.93)	(6.09)	(4.89)	(5.07)	(3.45)	(3.29)	(3.44)
- Financim i brendshëm	6.74	5.92	5.73	4.85	3.44	3.45	4.11	2.85	2.65	2.94
- Financim i huaj	2.81	3.10	1.92	2.08	2.65	1.44	0.96	0.60	0.64	0.50

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Të ardhurat buxhetore në fund të vitit ishin realizuar në masën 96 për qind të nivelit të planifikuar, ndërsa shpenzimet buxhetore u realizuan në masën 94 për qind të planit.²¹

Për të dy treguesit vërehet një ngadalësim në ritmin e rritjes nga një vit më parë. Megjithatë, rritja vjetore me rreth 9.7 për qind e të ardhurave dhe me 10.2 për qind e shpenzimeve buxhetore, qëndron mbi nivelin mesatar të rritjes vjetore të tetë viteve të fundit. Në raport me PBB-në, situata fiskale nuk paraqet ndryshim të dukshëm ndaj një viti më parë, pasi raportet kanë qenë pothuajse të pandryshuara (përkatësisht 25.7 për qind për të ardhurat dhe 29.1 për qind për shpenzimet). Të ardhurat buxhetore janë shpërndarë njëtrajtësisht përgjatë muajve të

Grafik 15. Ecuria e treguesve kryesorë fiskalë gjatë vitit 2007 (në miliardë lekë)²².



Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

vitit, ndërsa shpenzimet buxhetore janë kryer me ritme të ngadalta deri në muajin e fundit të vitit, në të cilin janë realizuar më tepër se 20 për qind e shpenzimeve të përgjithshme të tij. Ndryshe nga planifikimi, deficitit buxhetor (prej 3.44 për qind të PBB-së) është regjistruar vetëm në muajin dhjetor, ndërkohë që gjatë 11 muajve të parë të vitit, balanca buxhetore ka regjistruar suficit, që është luhatur në intervalin prej 4.7-10.2 miliardë lekësh.

2.5.1. TË ARDHURAT BUXHETORE

Politika e re fiskale që nisi të zbatohet në fillim të gjashtëmujorit të dytë të vitit, si edhe reformat e bëra në drejtim të përmirësimit të administrimit të sistemit të taksave, kanë ndikuar pozitivisht në realizimin e të ardhurave të karakterit tatimor. Të ardhurat buxhetore prej 251.6 miliardë lekësh rezultojnë me plotësim të planit vjetor në masën 95.8 për qind dhe me një rritje vjetore me rreth 9.7 për qind.

Rritja vjetore e të ardhurave, edhe pse pozitive, është paraqitur më e ulët sesa në tre vitet e mëparshme. Kategoritë e të ardhurave që kanë paraqitur rënie në krahasim me vitin e kaluar janë: të ardhurat nga pushteti vendor, të ardhurat nga tatimi mbi fitimin²³ si edhe të ardhurat nga taksat doganore. Këto të fundit, pasqyrojnë zbatimin e direktivave, që rrjedhin nga marrëveshjet e lëvizjes së lirë të mallrave.

Tabelë 14. Rritja vjetore e treguesve kryesorë të të ardhurave buxhetore (në përqindje).

	Mesatare 00-07	2006	T1 07	T2 07	T3 07	T4 07	2007	Përqindje ndaj PBB
Të ardhura totale	9.4	12.4	6.7	16.5	13.1	3.8	9.7	25.7
Të ardhura tatimore	13.5	11.8	7.5	10.3	12.1	13.9	11.1	23.3
- TVSH	14.6	15.1	25.8	18.5	18.9	11.9	18.2	9.0
- Tatimi mbi fitimin	17.5	15.7	- 11.5	- 4.0	- 10.2	4.1	- 5.4	2.1
- Akcizat	20.0	24.2	15.8	27.7	31.4	22.7	24.9	2.9
- Tatimi mbi të ardhurat personale	23.6	15.9	19.4	57.1	125.5	80.5	73.0	1.5
- Taksat doganore	- 1.0	2.7	- 23.6	- 33.9	- 31.8	- 28.8	- 29.6	1.0
- Pushteti lokal	23.0	- 7.5	- 9.2	- 5.1	- 16.3	- 30.4	- 15.4	1.0
- Buxheti i pavarur	11.1	8.6	- 3.1	3.1	0.2	28.6	7.4	4.3
Të ardhura jotatimore	- 12.3	12.1	- 1.0	42.7	129.5	21.4	38.5	2.2


Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar gjatë vitit 2007, kanë përfaqësuar rreth 38 për qind të të ardhurave tatimore dhe 34 për qind të të ardhurave të përgjithshme. Paketa e re fiskale eliminoi përjashtimet dhe lehtësitë, që ishin akorduar për TVSH-në përpara zbatimit të kësaj pakete. Një nga elementet kryesore të politikës së re fiskale, kishte të bënte me zbatimin e taksës së sheshtë në të ardhurat personale, duke synuar eliminimin e shkallëzimit tatimor progresiv, me qëllim arritjen e një shpërndarjeje më të njëtrajtshme të barrës fiskale. Duke parë shifrat e këtij zëri, evidentohet një rritje vjetore me 74 për qind, duke kontribuar me 2.7 për qind në rritjen vjetore të të ardhurave të përgjithshme.

Një element tjetër i rëndësishëm i paketës së re fiskale ishte rritja e akcizës për pijet alkoolike dhe duhanin. Si rezultat i zbatimit të këtij vendimi, rritja e të ardhurave nga akciza i shtoi rreth 2.5 pikë përqindjeje normës së rritjes vjetore të

të ardhurave të përgjithshme gjatë këtij viti²⁴. Paketa e re fiskale solli dhe një rishpërndarje të peshës së zërave të të ardhurave. Rritje të peshës në totalin e të ardhurave paraqitën të ardhurat nga TVSH-ja, të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale, si edhe të ardhurat e karakterit jotatimor, si rezultat i rritjes së shumës së mbledhur nga dividenti, pas privatizimit të kompanisë Albtelecom. Me ulje të peshës përkatëse ndaj totalit të të ardhurave rezultuan të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, nga taksat doganore, nga pushteti vendor si edhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Realizimi i të ardhurave buxhetore në përputhje me parametrat e përcaktuar është rezultat i politikave dhe reformave që kanë synuar konsolidimin e mëtejshëm fiskal, në mbështetje të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik.

Grafik 16. Të ardhurat e përgjithshme sipas kategorive (në % ndaj totalit).



Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

2.5.2. SHPENZIMET BUXHETORE

Reformat e ndërmarra në harkun kohor të një viti, kanë synuar rritjen e eficiencës së shpenzimeve buxhetore në funksion të vijueshmërisë së prirjes në rritje të investimeve publike.

Shpenzimet buxhetore prej 285.3 miliardë lekësh përfaqësojnë rreth 93.5 për qind të nivelit të programuar, ndërkohë që rritja vjetore e tyre ishte 10.2 për qind. Rreth 8 pikë përqindjeje të kësaj norme kanë ardhur si rezultat i rritjes së lartë vjetore të shpenzimeve korente dhe vetëm 2.2 pikë përqindjeje i atribuohen rritjes të shpenzimeve kapitale.


Këto të fundit u realizuan në masën 83 për qind të nivelit të programuar. Në raport ndaj PBB-së, shpenzimet korente dhe ato kapitale rezultuan përkatësisht 23 dhe 5.8 për qind. Gjatë vitit 2007 është vërejtur një tkurrje në ritmin e rritjes së shpenzimeve kapitale në krahasim me një vit më parë, por megjithatë rritja vjetore ishte rreth 3 pikë përqindjeje mbi nivelin mesatar të rritjes së tetë viteve të fundit.

Tabelë 15. Rritja vjetore e treguesve kryesorë të shpenzimeve buxhetore (në përqindje).

	Mesatare 00-07	2006	T1 07	T2 07	T3 07	T4 07	2007	Përqindje ndaj PBB
Totali i shpenzimeve	7.1	11.4	14.7	7.2	16.6	6.6	10.2	29.1
Shpenzime korente	7.0	5.6	9.5	7.1	11.9	10.4	9.8	23.0
- Personeli	8.5	5.7	1.1	1.3	2.0	10.2	4.2	6.0
- Sigurimet shoqërore	9.7	7.4	14.2	17.3	17.7	16.7	16.5	1.0
- Interesat	- 3.2	-3.9	-7.2	6.2	- 12.7	27.9	2.1	2.6
Të brendshme	- 3.8	-5.0	- 7.1	4.9	- 12.8	32.9	2.3	2.4
Të huaja	22.5	9.9	-8.8	17.3	- 11.3	- 4.2	0.3	0.2
- Operative mirëmbajtjeje	3.8	-7.0	19.2	9.9	11.4	8.0	10.7	2.6
- Buxheti vendor	18.2	13.6	31.6	1.6	- 17.1	- 12.1	- 5.9	2.2
Shpenzimet kapitale	7.8	33.2	78.8	8.1	52.5	- 2.3	11.0	5.8
Financimi i brendshëm	16.9	45.7	149.2	2.7	27.0	33.8	36.1	4.9
Financimi i huaj	- 5.2	11.5	- 37.4	21.9	189.4	- 75.3	- 45.8	0.9

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Grafik 17. Shpenzimet totale sipas kategorive (në % ndaj totalit).




Struktura e shpenzimeve buxhetore ka qenë e ngjashme me atë të vitit të mëparshëm. Shpenzimet korente dhe kapitale, kanë përfaqësuar përkatësisht 79 dhe 20 për qind të shpenzimeve të përgjithshme.

Në krahasim me një vit më parë vërehet një rritje e peshës së shpenzimeve për sigurime shoqërore e shëndetësore, dhe rënie e barrës fiskale për shërbimet e borxhit publik.

Ulja e barrës fiskale për shërbimin e borxhit të brendshëm është pjesërisht rezultat i kohëzgjatjes së afatit të maturimit të borxhit nga 242 ditë në vitin 2006, në 346 ditë në vitin 2007.

Zgjatja e afatit të maturimit të borxhit të qeverisë pasqyron politikën e Ministrisë së Financave, për zhvendosjen e emetimit të letrave me vlerë nga ato afatshkurtra në ato afatgjata.

Grafik 18. Shpenzimet e interesave të borxhit të brendshëm dhe të huaj (në % ndaj PBB).



Pjesë e këtij procesi ka qenë dhe prezantimi i instrumenteve të reja të borxhit, siç ishin obligacionet me afat maturimi 7-vjeçar. Një element të ri të strukturës së shpenzimeve buxhetore përbën transferimi i 8.0 miliardë lekëve në favor të KESH-it. Ky transferim ka qenë pjesërisht në formë huaje dhe pjesërisht në formë mbështetjeje, me qëllim përmirësimin e financave të kësaj ndërmarrjeje, të cilat janë përkeqësuar gjatë viteve të fundit.

2.5.3. DEFICITI BUXHETOR

Deficiti buxhetor prej 33.7 miliardë lekësh ishte rreth 8.7 miliardë lekë, nën kufirin e programuar nga Ministria e Financave. Deficiti shënoi një rritje vjetore prej 14.7 për qind, ndërkohë që raporti i deficitit ndaj PBB-së ka mbetur i pandryshuar në rreth 3.3 – 3.4 për qind. Rreth 85 për qind e deficitit buxhetor është financuar nga burime të brendshme.

Krahasuar me strukturën e dy viteve paraardhëse, në vitin 2007 u vërejt një rënie e ndjeshme e peshës së financimit të deficitit me anë të emetimit të letrave me vlerë dhe një rritje e konsiderueshme e peshës së financimit të deficitit nga të ardhurat e privatizimit.²⁵

Prirja që ka shfaqur ky tregues gjatë viteve më të fundit, është pasqyrë e strategjive dhe politikave të Ministrisë së Financave në funksion të pakësimit të rrezikut fiskal dhe njëkohësisht, të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik në vend.

Tabelë 16. Rritja vjetore e treguesve kryesorë të deficitit buxhetor (në përqindje).

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Mesatare	% PBB
Deficiti	- 6.0	1.1	- 6.2	- 10.5	12.2	- 26.0	4.2	14.7	-2.1	- 3.4
Financimi i brendshëm	7.3	- 5.7	24.3	11.8	29.0	- 24.5	1.4	21.8	2.1	2.9
Financimi i huaj	- 31.4	21.2	6.1	- 39.5	- 27.9	- 32.4	17.9	- 14.6	-8.8	0.5

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Hapësirë informuese 3: Elementet e politikës së re fiskale dhe reformat strukturore, të ndërmarra në harkun kohor njëvjeçar.

Viti 2007 shënoi një sërë reformash dhe iniciativash, të cilat “u kurorëzuan” me miratimin e paketës së re fiskale në fillimin e gjysmës së dytë të vitit. Elementet kryesore të kësaj pakete të re konsistonin në:

- Aplikimin e taksës së sheshtë për tatimin mbi të ardhurat personale, në masën 10 për qind.
- Rritjen e akcizës për disa mallra, siç ishin pijet alkolike dhe duhani, duke i përafuar ato me nivelin e akcizave të rajonit.
- Rritjen e taksave nacionale, që konsiston në rritjen e taksës së importit të automjeteve të përdorura ose siç quhet ndryshe, taksa e ambientit.
- Rritjen në nivelin e taksave vendore ose më konkretisht, aplikimi i taksës së pasurisë për ndërtesat, të cilat ndodhen në pronësi apo përdorim brenda territoreve të fshatrave turistike.
- Reduktim të taksave doganore, si pasojë e zbatimit të marrëveshjeve që synojnë reduktimin ose eliminimin e tyre.
- Nga këndvështrimi i shpenzimeve buxhetore, politika fiskale ka synuar rritjen e pagave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë me përparësi arsim e shëndetësi, si edhe reduktimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Ndër reformat e tjera strukturore të ndërmarra në harkun kohor të një viti, të cilat mund të konsiderohen si faktorë pozitivë të performancës fiskale janë:

- Reforma për përcaktimin e pagës referuese mujore, e cila mund të cilësohet si një hap i rëndësishëm në luftën kundër informalitetit dhe evazionit fiskal.
- Reforma në administrimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të taksave, të cilat jo vetëm kanë përmirësuar klimën për zhvillimin e biznesit, por në të njëjtën kohë konsiderohen si masa të rëndësishme në përmirësimin e sistemit të vjeljes së taksave.
- Reforma për alokimin sa më eficient të shpenzimeve publike, me synimin e orientimit të shpenzimeve në sektorët parësorë të ekonomisë.
- Zgjatja e afatit të maturimit të borxhit të brendshëm dhe prezantimi i instrumenteve të reja të borxhit.
- Privatizimi i Albtelecom.
- Vendosja e kufijve për transaksionet në cash. Ky element konsiston në detyrimin ligjor të të gjitha subjekteve punëmarrëse që të kryejnë pagesat nëpërmjet sistemit bankar.
- Akordimi i lehtësive fiskale për sektorët e energjisë dhe bujqësisë.

2.6. BILANCI I PAGESAVE


2.6.1. ZHVILLIME KRYESORE

Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjatë vitit 2007 regjistroi një thellim të mëtejshëm të deficitit të llogarisë korente, i cili vlerësohet të ketë arritur në 11 për qind të PBB-së, krahasuar me 7.3 për qind një vit më parë. Zgjerimi i deficitit korent pasqyron aktivitetin e shtuar të shkëmbimeve tregtare, i cili pavarësisht rritjes së eksporteve, ka regjistruar një deficit tregtar në rritje. Ashtu si dhe në periudhat e mëparshme, dërgesat nga emigrantët kanë financuar pjesën më të madhe të bilancit tregtar (rreth 44 për qind). Megjithatë, duhet theksuar se rritja e tyre në vitin 2007 ishte vetëm 1.3 për qind. Ky vit karakterizohet gjithashtu, edhe nga një rritje e madhe e flukseve të kapitalit përfaqësuar kryesisht nga investime të huaja direkte. Treguesi relativ i këtyre kundrejt PBB-së, u vlerësua në 6 për qind, me një rritje prej rreth 2 pikë përqindjeje kundrejt një viti më parë.

Tabelë 17. Tregues të përmbledhur të bilancit të pagesave.

	në milionë euro			në përqindje ndaj PBB-së		
	2005	2006	2007	2005	2006	2007
Llogaria korente	(492.1)	(535.1)	(878.1)	7.3	7.3	11.0
Bilanci tregtar	(1,476.7)	(1,685.4)	(2,135.1)	21.9	23.1	26.8
- Eksport	530.2	630.6	786.3	7.9	8.6	9.9
- Import	(2,006.9)	(2,316.0)	(2,921.5)	29.8	(31.7)	36.7
Shërbime (neto)	140.4	(66.8)	2.8	2.1	0.9	0.0
Të ardhura (neto)	136.1	208.6	216.3	2.0	2.9	2.7
Transferata korente (neto)	988.9	1,008.5	1,037.9	14.7	13.8	13.0
Llogaria kapitale (neto)	438.5	552.1	838.7	6.5	7.6	10.5
Bilanci i përgjithshëm	125.1	206.6	148.6	1.9	2.8	1.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.



2.6.2. LLOGARIA KORENTE

Viti 2007 është karakterizuar nga një aktivitet tepër intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të konsiderueshme si të shpenzimeve korente ashtu dhe të të ardhurave. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me rreth 20 për qind krahasuar me vitin 2006, duke shënuar një nivel prej 8.3 miliardë eurosh nga të cilat 60 për qind kanë shkuar për shpenzime.

Mëse 96 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Ndërkohë, 60 për qind e të ardhurave është krijuar nga eksportet e mallrave dhe shërbimeve dhe pjesa tjetër, ka ardhur në formën e transfertave korente (33 për qind) dhe të ardhurave nga puna dhe nga investimet (7.4 për qind).

Deficiti korent për vitin 2007, u vlerësua në nivelin 878 milionë euro, me një rritje prej rreth 64 për qind kundrejt vitit 2006, duke qenë i barazvlefshëm me rreth 11 për qind të PBB-së.

2.6.2.1. Tregtia e mallrave

Fluksi i madh i shkëmbimeve tregtare që karakterizoi vitin 2007, rezultoi me një vëllim të përgjithshëm tregtar prej 3.8 miliardë eurosh, i vlerësuar ky 26 për qind më i lartë se viti paraardhës. Kontributi i tregtisë së mallrave në llogarinë korente mbetet në nivele të larta, rreth 44 për qind e të gjitha transaksioneve korente gjatë vitit. Intensifikimi i aktivitetit tregtar ishte reflektim dhe i disa faktorëve siç ishte rritja e përgjithshme e çmimeve, luhatjet në kursin e këmbimit si dhe ulja graduale e tarifave doganore, pjesë e proceseve liberalizuese tregtare.

Edhe pse dinamika e tregtisë na flet për ritme të larta rritëse si në importe (26 për qind) ashtu edhe në eksporte (25 për qind), baza e ulët e këtyre të fundit nuk mundi të ndikojë në përmirësimin e deficitit tregtar. Ai arriti vlerën e 2.1 miliardë eurove ose 27 për qind më i lartë se viti 2006.

Kapaciteti prodhues në vend, i pamjaftueshëm për të kënaqur kërkesën gjithmonë e në rritje të ekonomisë shqiptare për mallra, ka bërë që raporti i mbulimit të importeve nga eksportet të mbetet në nivele të ulëta, 26 për qind (gjatë 5-vjeçarit të fundit, ky raport është luhatur rreth këtyre niveleve).

Në një analizë të importeve sipas përdorimit të tyre përfundimtar, vërejmë një përqendrim të theksuar drejt mallrave të ndërmjetëm (53 për qind), ndërkohë që mallrat kapitalë dhe ata të konsumit përfaqësuan përkatësisht 30 për qind dhe 14 për qind të totalit të importit, gjatë vitit 2007.

Mallrat e ndërmjetëm përfaqësohen konsiderueshëm nga mallrat industrialë të përpunuar (60 për qind), si dhe lëndë djegëse për qëllime industriale.

Gjatë vitit 2007 mund të thuhet se ka një rënie të ndjeshme në importet për mallra konsumi me rreth 7 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2006, ndërkohë që rritjen më të ndjeshme e kanë pasur mallrat kapitalë me 36 për qind²⁶.



	Importet (në %)		Eksportet (në %)		'07/'06 në %	
	2006	2007	2006	2007	Import	Eksport
Ushqime dhe kafshë të gjalla	13.3	12.5	4.2	3.6	18.2	6.2
Pije dhe duhan	3.2	2.9	1.3	1.4	15.6	32.4
Materiale të papërpunuara	3.6	2.2	5.5	9.6	(20.8)	116.9
Lëndë djegëse	10.6	14.7	4.3	7.9	75.1	129.1

Tabelë 18. Struktura e tregtisë së jashtme.

Yndyra bimore dhe shtazore	1.3	1.1	0.1	0.1	7.7	61.1
Produkte kimike	10.5	9.9	1.0	1.0	19.7	32.1
Mallra të përpunuar	25.6	24.8	22.4	21.3	22.1	18.3
Makineri dhe pajisje	20.1	20.7	3.9	4.2	30.2	34.9
Mallra të tjerë të përpunuar	11.8	11.2	57.2	50.8	19.2	10.7
TOTALI	100.0	100.0	100.0	100.0	26.3	24.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kahun e eksporteve shfaqen rritje të konsiderueshme pothuajse në të gjithë grupmallrat. Varësia e theksuar e eksporteve tona nga industria e tekstileve dhe këpucëve vazhdon të karakterizojë edhe këtë vit, duke kontribuar me 48 për qind në totalin e tyre. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2007 rritje të forta kanë shfaqur artikuj të tillë si produkte minerale (3 herë më e lartë se viti 2006) dhe naftë e papërpunuar (72 për qind). Kontributi më i madh i takon riaktivizimit të eksporteve të kromit në tregje të përqendruara si ai i Kinës dhe i Suedisë.

Fillimi i vitit 2007 përkoi me reduktimin e tarifave doganore për një sërë produktesh, si pjesë e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Bashkimin Evropian. Ky liberalizim ka bërë që të rritet diversifikimi i shpërndarjes së aktivitetit tregtar sipas vendeve, duke ulur mbizotërimin klasik të Italisë dhe të Greqisë.

Tabelë 19. Importi sipas partnerëve tregtarë.

	Pesha në totalin e importit			'07/'06 në %
	2005	2006	2007	
Vendet e BE-së - 15, nga të cilat:	60.4	57.5	54.1	18.9
Gjermani	5.4	5.6	5.5	22.5
Greqi	16.6	15.8	14.6	16.7
Itali	29.3	28.1	27.2	22.0
Anëtarët e rinj të BE-së - nga të cilat:	6.9	8.1	5.7	(11.0)
Bullgari	2.8	2.7	1.8	(18.1)
Çeki	1.0	1.1	0.8	(8.1)
Rumani	0.7	1.7	0.4	(68.8)
Vende të tjera evropiane, nga të cilat:	8.0	9.1	11.6	61.3
Rusi	4.1	4.1	4.1	25.9
Ukrainë	2.9	3.9	2.6	(14.5)
Vendet e Ballkanit	11.0	12.3	13.2	35.8
Bosnje Hercegovinë	0.1	0.3	0.3	40.3
Kosovë	0.4	0.5	0.6	53.2
Kroaci	1.2	1.4	0.9	(20.1)
Maqedoni	1.2	1.6	1.9	52.0
Serbi-Mal i Zi	0.6	0.9	2.2	207.2
Turqi	7.5	7.6	7.3	21.3
Amerikë	2.1	2.0	2.5	60.8
Azi, nga të cilat:	7.5	6.7	7.6	44.2
Kinë	6.7	6.0	6.7	40.5
Të tjera	4.2	4.5	5.3	47.7
Totali	100.0	100.0	100.0	26.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Unifikimi i marrëdhënieve tregtare me vendet e rajonit²⁷ pati ndikim të menjëhershëm në tregti, duke bërë që këto vende të shfaqin ritmet më të larta rritëse. Kjo u ndje më shumë në kahun e eksporteve, të cilat u vlerësuan 71 për qind më të larta se viti paraardhës. Tregu kosovar duket se thith pjesën më të madhe të eksporteve tona me Rajonin, duke qenë dhe i vetmi vend me të cilin ne kemi suficit tregtar. Kostoja e ulët e mallrave nga vende të tilla si Turqia dhe Kina kanë rritur rëndësinë e këtyre partnerëve për konsumatorin vendas. Edhe gjatë këtij viti ato vazhdojnë të shfaqin ritme rritëse të qëndrueshme, ndërkohë që partnerë të tjerë si Gjermani, Zvicër, Rusi, po konsolidohen në tregun shqiptar.

	Pesha në totalin e eksportit			Ndryshimi
	2005	2006	2007	2007/2006 (%)
Vendet e BE-së - 15, nga të cilat:	88.0	87.8	81.8	16.1
Gjermani	3.3	3.2	2.4	(3.6)
Greqi	10.5	9.6	8.3	7.2
Itali	72.4	72.6	68.0	16.8
Anëtarët e rinj të BE-së - nga të cilët:	1.4	0.8	1.3	90.6
Bullgari	0.6	0.4	0.7	105.8
Çeki	0.1	0.1	0.0	(46.2)
Rumani	0.2	0.1	0.3	355.2
Vende të tjera evropiane, nga të cilat:	0.1	0.1	0.3	200.5
Rusi	0.1	0.1	0.3	485.1
Ukrainë	0.0	0.0	0.0	115.6
Vendet e Ballkanit	8.5	8.8	12.1	70.9
Bosnje Hercegovinë	0.2	0.5	0.4	(8.3)
Kosovë	4.1	3.8	4.8	58.7
Kroaci	0.0	0.3	0.1	(59.0)
Maqedoni	1.6	1.6	2.4	83.7
Serbi-Mal i Zi	0.8	1.4	2.2	106.2
Turqi	1.7	1.3	2.2	116.3
Amerikë	1.1	0.5	0.7	63.3
Azi, nga të cilat:	0.5	1.6	2.6	98.0
Kinë	0.5	1.1	2.6	180.4
Të tjera	0.3	0.4	1.3	370.0
Totali	100.0	100.0	100.0	24.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 20. Eksporti sipas partnerëve tregtarë.

2.6.2.2. Shërbimet

Vlera e transaksioneve të shërbimeve, vlerësohet të jetë rritur me 3 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 37 për qind ndaj PBB-së. Pozicioni neto i tregtisë në shërbime ka rezultuar pozitiv, si pasojë e rritjes më të shpejtë të të ardhurave nga eksporti (22 për qind) kundrejt shpenzimeve për import (15 për qind) në këtë sektor.

Tregtia në shërbime shfaqet dinamike veçanërisht në kahun e eksporteve, të cilat vazhdojnë të ruajnë epërsinë ndaj eksportit të mallrave me rreth 1.9 herë më shumë.

Shërbimet e udhëtimit, duke pasqyruar kërkesën në rritje, përbëjnë grupin më të madh si nga ana e eksportit ashtu dhe nga ana e importit të shërbimeve, respektivisht me 69 dhe 64 për qind. Të ardhurat neto më të larta se një vit më parë kanë mundur të financojnë rreth 4 për qind të deficitit tregtar, për vitin 2007.

Si zhvillim i spikatur mund të përmenden prurjet valutore nga eksporti në turizëm, të cilat arritën nivelin 1 miliard euro, të vlerësuara 27 për qind më shumë se ato nga eksporti i mallrave, fakt ky që tregon haptazi drejtimin e burimeve të ekonomisë shqiptare.

Njëkohësisht, kërkesa për mallra e shërbime e udhëtarëve shqiptarë në vendet e huaja, çoi në regjistrimin e një importi shërbimesh udhëtimi prej rreth 923 milionë eurosh. Këto shpenzime, zënë rreth 97 për qind të prurjeve të emigrantëve dhe vlerësohen me një rritje vjetore rreth 20 për qind.

Shqipëria vazhdon të jetë importuese neto e shërbimeve të transportit dhe të sigurimit, fenomen ky që vjen si pasojë e rritjes së importeve të mallrave.

Ecuri pozitive është vërejtur dhe në tregun e sigurimeve që ka rritur interesin e investitorëve të huaj për blerjen e disa kompanive.

Përmirësim i bilancit të tregtisë karakterizon pothuaj të gjithë sektorët e tjerë të shërbimeve. Zhvillimet e sektorëve të shërbimeve dallohen nga një rritje e shpejtë në shërbimet financiare e të komunikacionit, zgjerim i teknologjisë në shërbimet e informacionit, shumëllojshmëri e shërbimeve kulturore duke shfaqur potenciale konkurruese në tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve.

2.6.2.3. Të ardhurat dhe transfertat korente

Bilanci pozitiv i të ardhurave faktoriale në fund të vitit (216 milionë euro), vlerësohet të jetë rritur vetëm 3.6 për qind kundrejt vitit paraardhës. Kjo rritje pasqyron rënien e të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë dhe atyre kufitarë, me 10 për qind në terma vjetorë.

Shqipëria gjatë vitit 2007, ka paguar 24 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm, të cilat vlerësohen lehtësisht në rënie kundrejt vitit 2006 (4 për qind).

Totali i dërgesave nga emigrantët, për vitin 2007 vlerësohet të jetë rreth 947 milionë euro (me një rritje të lehtë vjetore prej 1.3 për qind) ose sa 12 për qind e PBB-së. Kjo normë rritjeje vlerësohet si më e ulta këta dhjetë vitet e fundit (norma mesatare e rritjes ka qenë 11.7 për qind) dhe shpjegohet me zhvendosjen e një pjese të flukseve valutore të emigrantëve, për qëllim investimi në Shqipëri (pasuri të paluajtshme apo investim në instrumente

financiare). Kontributi i këtyre dërgesave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 44 për qind, me një rënie prej 11 pikë përqindjeje kundrejt vitit të kaluar.

Transfertat zyrtare, kryesisht në formë të asistencës teknike, vlerësohen në masën 60 milionë euro, duke regjistruar një rritje prej 18 milionë eurosh, kundrejt një viti më parë.

2.6.3. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Viti 2007, karakterizohet nga një lëvizje shumë e madhe e kapitalit në të dyja kahet, si në flukset hyrëse ashtu edhe ato dalëse. Përfunduar transfertat e njëanshme të kapitalit, llogaria financiare këtë vit përkufizohet në rritje të madhe si të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën, ashtu edhe të mjeteve tona jashtë ekonomisë shqiptare.

Megjithatë, viti u mbyll me një bilanc pozitiv të llogarisë kapitale dhe financiare rreth 839 milionë euro, duke mbuluar rreth 96 për qind të deficitit të llogarisë korente.

Transfertat kapitale, të cilat karakterizohen kryesisht nga grante me karakter investimi si në sektorin shtetëror ashtu edhe atë privat, vlerësohen 90 milionë euro.

Gjatë vitit 2007, ekonomia shqiptare ka thithur prurje valutore në formën e kapitaleve të huaja me rreth 806 milionë euro. Kjo rritje, e cila vlerësohet 45 qind më lart se viti 2006, vjen kryesisht nga investimet direkte, nga huamarrja koncensionare afatgjatë si dhe nga depozitat e vendosura në sistemin tonë bankar nga jorezidentët.

Investimet e huaja direkte kanë regjistruar një shifër rekord në vitin 2007: rreth 463 milionë euro ose 75 për qind më shumë se viti i kaluar. Privatizimi i Albtelecomit, rritja e pjesëmarrjes së kapitalit të huaj në zotërimin e sektorit financiar, kanë luajtur rolin kryesor në këtë rritje. Investitorët nga vendet e Bashkimit Evropian (Itali, Greqi) vazhdojnë të dominojnë investimet në fushën e industrisë përpunuese të tekstileve dhe të këpucëve.

Lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, të cilat mbeten një faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë me pjesën tjetër të botës, gjatë këtij viti vlerësohen 129 milionë euro, nga të cilat 93 për qind kanë shkuar në sektorin publik. Kjo rritje ka financuar kryesisht investimet në infrastrukturë.

Shërbimi i borxhit të jashtëm për vitin 2007 ka reduktuar detyrimet tona me rreth 54 milionë euro. Kjo shifër përfaqëson vetëm 7 për qind të eksporteve tona gjatë vitit 2007, gjë që tregon për një aftësi paguese të kënaqshme. Ndërkohë, huamarrja private duket se ka ngadalësuar ritmet e rritjes së saj.

Këtë vit, një rëndësi të veçantë kanë marrë detyrimet financiare afatshkurtra në formën e rritjes së depozitave të jorezidentëve dhe detyrimeve të tjera të krijuara nga sektorët financiarë dhe ata jofinanciarë. Kjo shumë regjistron vlerën 249 milionë euro, 66 për qind e të cilës është në monedhën evropiane.

Rritja pasqyron kryesisht zhvendosjen e prurjeve valutore të emigrantëve nga dërgesa korente, në depozita në sistemin bankar. Detyrimet në formën e kredisë tregtare u rritën me 11.8 milionë euro, e reflektuar kjo nga rritja e importeve për këtë periudhë.

Ndërkohë, mjetet valutore të investuara jashtë vlerësohen të rritura me 57.4 milionë euro dhe kryesisht përfaqësojnë investime afatshkurtra dhe afatmesme të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente.



2.6.4. REZERVA VALUTORE

Pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave rezulton pozitiv duke bërë që rezervat valutore të autoritetit monetar, të rriten me 148.6 milionë euro. Si rezultat, niveli i tyre në fund të vitit 2007 shënoi vlerën 1.5 miliardë euro, duke qenë i mjaftueshëm për të mbuluar rreth 4 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

2.6.5. POZICIONI NDËRKOMBËTAR I INVESTIMEVE

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve në fund të vitit 2007, shënoi 1.2 miliardë euro ose rreth 15 për qind të PBB-së. Kundrejt vitit 2006, pozicioni debitor neto është rreth 2.2 herë më i lartë se ai i fundvitit 2006. Thellimi i pozicionit neto negativ përfaqëson rritjen më të shpejtë të detyrimeve në formën e investimeve direkte në Shqipëri kundrejt mjeteve, si dhe të investimeve të tjera. Në sqajë të rritjes së detyrimeve, kryesisht të investimeve të huaja, shkalla e hapjes financiare të ekonomisë në tregun ndërkombëtar financiar vlerësohet rreth 73 për qind ose rreth 5 pikë përqindjeje më e lartë se në vitin 2006²⁸.

Tabelë 21. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve të Shqipërisë (në fund të periudhës, në milionë euro).

Total në fund të vitit	2006	2007	Ndryshimi
Mjetet e huaja	2,316.95	2,345.11	28.16
Detyrimet e huaja	2,860.25	3,562.62	702.37
Pozicioni Neto i Investimeve	(543.30)	(1,217.51)	(674.21)

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mjetet e huaja u rritën me vetëm 0.176 miliardë euro në terma vjetorë. Struktura monetare e totalit të mjeteve prej 2.3 miliardë eurosh është tërësisht likuide. Pesha e rezervës valutore përbën rreth 61 për qind të totalit, ndërsa

investimet e tjera, kryesisht depozita të bankave tregtare, rreth 34 për qind. Në kontrast, totali i detyrimeve të huaja prej 3.6 miliardë eurosh përfaqëson investime afatgjata në formën e investimeve të huaja direkte prej 43.6 për qind dhe investimeve të tjera, prej 56.4 për qind²⁹.

Total në fund të vitit	2006	2007	Ndryshimi në %	Struktura
Investimi direkt jashtë	18.35	13.06	-28.9%	0.6
Investimet e portofolit	87.47	61.26	-30.0%	2.6
Investime të tjera	809.63	800.50	-1.1%	34.1
- nga të cilat Monedha dhe Depozita	752.2	759.5	1.0%	32.4
Mjetet e Rezervës	1,401.51	1,470.29	4.9%	62.7
Totali i Mjeteve	2,316.95	2,345.11	1.2%	100.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Tabelë 22. Përbërja e mjeteve të huaja, në milionë euro.

2.6.5.1. Borxhi i Jashtëm

Borxhi i jashtëm i Shqipërisë vazhdoi të rritet gjatë vitit 2007, ndonëse me ritëm më të ulët sesa në vitin 2006. Totali i borxhit të jashtëm, arriti nivelin 2 miliardë euro, nga 1.8 miliardë që ishte në fund të vitit 2006. Kjo rritje është shkaktuar kryesisht nga rritja e detyrimeve afatshkurtra të bankave tregtare (në formën e huave dhe monedhave e depozitave).

Duke parë kompozimin e borxhit të jashtëm, mbizotërojnë huatë afatgjata me rreth 73 për qind të totalit. Huatë afatshkurtra përbëjnë 11.3 për qind. Ndërkohë, monedhat dhe depozitat zënë 3.5 për qind të totalit të borxhit.

Treguesit relativë të borxhit të jashtëm paraqiten të përmirësuar, në fund të vitit 2007. Raporti i borxhit të jashtëm kundrejt eksporteve të mallrave dhe shërbimeve të ekonomisë shqiptare gjatë vitit, arriti në 87.8 për qind në fund të vitit 2007, duke rënë me 12 pikë përqindjeje nga niveli që kishte ky raport në fund të vitit 2006. Rënia e këtij raporti vjen si rezultat i rritjes më të shpejtë të eksporteve të Shqipërisë përkundrejt rritjes së detyrimeve të borxhit të jashtëm gjatë këtij viti.



Ndërkohë, raporti i borxhit të jashtëm mbi produktin e brendshëm bruto ka pothuaj të njëjtin nivel si një vit më parë, rreth 25 për qind e PBB-së.

Në fund të vitit 2007, detyrimet në euro zinin pjesën më të madhe të borxhit të jashtëm, me rreth 49 për qind, ndjekur nga ato në sdr me 36 për qind. Detyrimet e borxhit të jashtëm në formën e instrumenteve në dollarë amerikanë kanë zënë një pjesë të vogël (rreth 7 për qind) të totalit të detyrimeve.

SHËNIME

¹ Të dhënat për PBB-në dhe rritjen reale të saj për vitet 1999-2000 janë të INSTAT-it. Për pjesën tjetër të dhënat janë vlerësime të Ministrisë së Financave, të FMN-së dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë.

² Tabela është ndërtuar duke u bazuar në PBB-në nominale të rishikuar.

³ PBB nominale, e konvertuar me kursin mesatar të periudhës.

⁴ Borxhi qeveritar duke përfshirë borxhin e garantuar nga qeveria.

⁵ Mesatare e viteve 2001-2007.

⁶ Gjatë periudhës janar-shtator për secilin vit.

⁷ Norma e rritjes është llogaritur për periudhën janar-shtator të çdo viti, për efekt krahasimi me vitin 2007.

⁸ Në vëllim të matur në GwH.

⁹ Buletini Mujor, shtator 2007.

¹⁰ Përfshin çmimet e drithërave, vajit vegjetal, mishit, peshkut, sheqerit, bananes dhe portokallit.

¹¹ Rritja e çmimit të bukës dhe të drithërave dhe e disa produkteve të tjera përpunuara. Këta artikuj zënë një peshë të konsiderueshme në shportën e çmimeve të konsumit.

¹² Një përjasje e përshtatshme e saj është inflacioni bazë, i cili matet mbi rreth 78 për qind të shportës së IÇK-së.

¹³ Norma vjetore e inflacionit total për vitin 2007 ishte 3 për qind.

¹⁴ Sektori i çmimeve të mallrave të tregtueshëm, zë rreth 52 për qind të shportës së IÇK-së.

¹⁵ Ushqimet në shportën e llogaritjes së indeksit të çmimeve të mallrave të tregtueshëm zënë rreth 70 për qind.

¹⁶ Në periudhën janar 2006-dhjetor 2007, norma bazë e interesit është rritur 5 herë, me nga 0.25 pikë përqindjeje në secilin rast.

¹⁷ IHÇK (HCPI) - indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit, tregues i përafërt i IÇK-ve të vendeve anëtare të BE.

¹⁸ Nga tabela 1 në 3 (përfshirë Shqipëria) janë grupuar shtetet sipas kohëgjatësisë si anëtare në BE (nga anëtarët më të hershme në ato më të reja). Në tabelën 1 janë listuar disa prej vendeve të BE, partnere të rëndësishme tregtare me të cilat Shqipëria ka marrëdhënie tregtare.

¹⁹ Sipas klasifikimit COICOP, të EUROSTAT.

²⁰ Ashtu si për punësimin edhe në këtë rast të dhënat janë të vlefshme deri në fund të 9-mujorit.

²¹ Plani më i fundit është rishikuar në muajin nëntor me miratimin e aktit normativ, për rialokimin e shpenzimeve buxhetore. Sipas këtij skeduli të ardhurat dhe shpenzimet totale janë parashikuar në nivele më të ulëta nga buxheti suplementar i miratuar në korrik të këtij viti, me respektivisht 1.7 miliardë dhe 4.7 miliardë lekë.

²² Të dhënat e Ministrisë së Financave për vitin 2007 janë të dhëna paraprake.

²³ Të ardhurat nga tatim fitimi mendohet të kenë pësuar ulje nga një vit më parë, në sajë të përkeqësimit të gjendjes financiare të kompanive publike.

²⁴ Me fjalë të tjera, rritja e të ardhurave nga akciza, ka kontribuar me 2.5 pikë përqindjeje në normën e rritjes vjetore të të ardhurave të përgjithshme prej

9.7 për qind.

²⁵ Të ardhurat nga privatizimi i Albtelecom që përfaqësojnë financimin e deficitit janë rreth 13.3 miliardë lekë. Ndërsa emetimi i letrave me vlerë ishte rreth 17.3 miliardë lekë ose 3.7 miliardë lekë më i ulët nga një vit më parë.

²⁶ Importi i energjisë elektrike ka kontribuar në rritjen e importit. Të dhëna të detajuara për këtë sektor raportohen në seksionin "2.2.1.3. Prodhimi dhe Përdorimi i Energjisë Elektrike".

²⁷ Marrëveshja e tregtisë së lirë me vendet e Evropës Juglindore, CEFTA ka hyrë në fuqi në korrik 2007.


²⁸ Pozicioni ndërkombëtar i investimeve përbën diferencën e mjeteve ndaj detyrimeve valutore të ekonomisë. Ndërsa, shkalla e hapjes financiare llogaritet si raport i totalit të mjeteve valutore bruto dhe detyrimeve valutore ndaj PBB-së. Këto llogaritje përfshijnë sektorin financiar dhe atë real të ekonomisë.

²⁹ Ecuria e kursit të këmbimit ka ndikuar në pozicionin ndërkombëtar neto. Zhvlerësimi i dollari amerikan ndaj euros ndikoi në zbehjen e rritjes së mjeteve valutore neto. Instrumentet valuore në usd përbëjnë rreth 37 për qind të mjeteve me jashtë, kundrejt rreth 7 për qind të detyrimeve me jashtë.

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE

3.1. ZHVILLIMET MONETARE


Ecuria e treguesve monetarë ka evidentuar ritmet e larta të ofertës së parasë në formën e kredisë për ekonominë, kundrejt një zbutjeje të kërkesës së brendshme për para. Në tërësi, këto zhvillime janë në përputhje me prirjen e uljes së ritmit të qarkullimit të parasë në ekonomi dhe të thellimit të ndërmjetësimit financiar në ekonomi. Këto prirje konstatohen në rritjen më të shpejtë të parasë kundrejt PBB-së dhe në rritjen e tepricës së kredisë për ekonominë, në rreth 30 për qind të PBB-së. Megjithatë, gjatë vitit 2007 janë intensifikuar presionet në çmimet e konsumit dhe ato të prodhimit, në ekonomi.




Ritmi vjetor i rritjes së parasë së gjerë, agregatit M3, ka njohur ngadalësim në rreth 13 për qind. Zbutja e ritmeve të agregatëve monetarë në fund të vitit kundrejt ritmeve të larta të kredisë për ekonominë, shënon stabilizimin e kërkesës së brendshme për mjete monetare. Paralelisht, zbehja e kontributit të fluksit të mjeteve valutore neto të sistemit në zgjerimin e agregatit M3, konstaton ndikimin më të lartë të flukseve të ofertës drejt pozicionit të jashtëm të ekonomisë. Në këtë linjë, ritmi vjetor i M2 është ulur në rreth 5 për qind, kundrejt rreth 12 për qind në vitin 2006, në prani të ecurisë së qëndrueshme të kredisë në lekë për sektorin publik.

Struktura sektoriale e stokut të parasë ka evidentuar ritme të larta të gjenimit të parasë në formën e kredisë së brendshme. Kreditimi i sektorit privat ka vazhduar të dominojë strukturën sektoriale të stokut të parasë në

ekonomi gjatë vitit 2007. Në vlerësim mesatar, kredia për sektorin privat të ekonomisë ka gjeneruar flukse monetare prej rreth 15-16 pikë përqindjeje, në terma të agregatit M3. Ndërsa, kontributi i sektorit publik në zgjerimin e parasë ka rezultuar i qëndrueshëm në rreth 2 pikë përqindjeje, sikurse në vitet e fundit. Prirja në rënie e kontributit të mjeteve valutore neto në M3 përkon me përkeqësimin e llogarisë së jashtme të ekonomisë dhe zgjerimin e balancës së kursim-investimeve.




Zhvillimet monetare gjatë vitit kanë regjistruar luhatje sezonale, megjithëse ulja e kërkesës për para likuide në gjysmën e dytë të vitit, sinjalizon një prirje të qëndrueshme të zhvillimeve monetare. Kërkesa për likuiditet pasqyron pjesërisht kërkesën e përqendruar të sektorit publik për mjete monetare në fund të vitit. Megjithatë, në krahasim me vitin 2006, kërkesa për para (likuide) rezulton më e ulët. Gjendja e parasë jashtë bankave është ulur me 5 për qind, në terma vjetorë¹. Gjithashtu, luhatje është konstatuar dhe në ecurinë e parasë së gjerë në terma realë. Në fund të vitit, M3 real është rritur me rreth 10 për qind kundrejt rritjes vjetore prej 15 për qind në tremujorin e parë.



3.1.1. ZHVILLIMET NË STRUKTURËN KOHORE TË M3

Struktura kohore e parasë së gjerë në ekonomi ka ruajtur prirje të theksuar të zhvendosjes drejt përbërësve jolikuidë. Kjo prirje është në përputhje me rritjen e ndërmjetësimit të sistemit. Peshat e depozitave totale ndaj agregatit M3 është rritur në rreth 80 për qind në fund ose rreth 4 pikë përqindjeje më lart, se në vitin 2006. Prirja e rritjes së depozitave ndaj M3 është konstatuar në

katër vitet e fundit, megjithëse norma reale e interesit ka rezultuar e luhatshme. Rritja e lehtë e normës së inflacionit ka pakësuar kthimin real nga kursimet. Megjithatë, rritja e normës bazë dhe transmetimi i saj në tregjet e parasë me një kohëvonesë, ka rikthyer normën reale të kthimit në mbi 2 për qind.




Krahas zhvillimeve makroekonomike, përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të pagesave dhe zgjerimi i rrjetit bankar në vend, ndikojnë pozitivisht në strukturën kohore të parasë së gjerë dhe në pakësimin e parasë cash në ekonomi.

3.1.1.1. Paraja jashtë bankave

Stoku i parasë jashtë bankave në ekonomi pasqyron kryesisht kërkesën për transaksione në ekonomi. Gjatë vitit 2007, raporti i parasë jashtë bankave ndaj PBB-së është luhatur në rreth 16-17 për qind. Stabiliteti makroekonomik dhe norma e ulët e inflacionit në ekonomi gjatë viteve të fundit, janë shoqëruar me një ecuri të qëndrueshme të këtij treguesi, ndërsa janë pasqyruar luhatjet sezonale të kërkesës për likuiditet gjatë vitit. Në vlerësim mesatar, raporti i stokut të parasë ndaj PBB-së ka njohur një rënie të lehtë prej rreth 0.5 pikë përqindjeje, në rreth 16 për qind kundrejt rreth 16.5 për qind në vitin 2006.

Në terma të parasë së gjerë paraaja jashtë bankave përbën rreth 20 për qind të M3. Në fund të vitit 2006, ky raport rezultoi rreth 24 për qind. Prirja rënëse e peshës së parasë jashtë sistemit ndaj M3, është në përputhje me prirjen e rritjes së ndërmjetësimit bankar, të realizuar në vitet e fundit. Ecuria e parasë jashtë sistemit në terma vjetorë, ka qenë nën ndikimin e faktorëve sezonalë të fundvitit. Kështu, në fund të vitit 2007, rritja vjetore e parasë jashtë bankave rezultoi -5 për qind, kundrejt rritjes pozitive prej 9 për qind, në vitin 2006.

Grafik 5. Pesha e stokut të parësë në qarkullim ndaj PBB-së dhe ndaj M3.




Burim: Banka e Shqipërisë.

3.1.1.2. Depozitat në lekë

Niveli i depozitave të sistemit në lekë, në vitin 2007 është rritur me rreth 10 për qind. Në periudhën afatmesme, përbërja kohore e agregatit M2 është zhvendosur drejt depozitave në lekë. Në fund të vitit 2007, pesha e tyre ndaj M2 është rritur në 69 për qind kundrejt rreth 66 për qind, një vit më parë. Krahas kësaj prirjeje, zhvillimet sezonale në tregjet e parësë kanë ndikuar në kërkesën për likuiditet dhe rrjedhimisht, edhe në strukturën e M2. Në këto kushte, sistemi bankar ka ruajtur ecuri të qëndrueshme të situatës së likuiditetit në periudhën afatmesme. Megjithatë, në periudhën afatshkurtër, kërkesa për likuiditet ka qenë nën ndikimin e zhvillimeve sezonale të kërkesës për mjete monetare. Ndërsa në gjysmën e parë të tij sistemi bankar ka gjeneruar teprica likuiditeti, në gjysmën e dytë të vitit kërkesa për para likuide ka qenë në rritje. Plotësimi sezonal i kësaj kërkesë, ka mundësuar qëndrueshmërinë e normave të interesave.


Grafik 6. Struktura kohore e M2 dhe rritjet vjetore të M2 dhe depozitave në lekë (dijathtas).



Burim: Banka e Shqipërisë.

3.1.1.3. Zhvillimet në strukturën valutore

Rritja e parasë së gjerë në ekonomi ka rezultuar në flukse të larta valutore në formën e depozitave. Në vitet e fundit, rritjes së depozitave në valutë në sajë të prurjeve valutore nga remitancat , i janë shtuar flukset e parasë në valutë të gjeneruara nga ndërmjetësimi financiar. Kështu, ndërsa niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar është luhatur afër një prirjeje të qëndrueshme, niveli i depozitave në valutë është rritur me ritme të shpejta. Në fund të vitit 2007, pesha e depozitave në valutë ndaj depozitave totale është rritur në rreth 42.5 për qind, kundrejt 38.5 për qind në vitin 2006. Ndërkohë, pesha e mjeteve valutore neto ndaj depozitave totale ka pësuar rënie në rreth 10 për qind në vitin 2007, kundrejt 14 për qind në fund të vitit 2006.



Në këto kushte, zhvendosja e strukturës valutore të M3 drejt përbërësit valutor të depozitave, përfshin pjesërisht flukset monetare të krijuara nga kërkesa e brendshme për mjete monetare në ekonomi. Gjatë vitit 2007, depozitat në valutë u rritën me rreth 30 për qind, ndërsa mjetet valutore neto të sistemit kanë qëndruar në të njëjtin nivel kundrejt vitit 2006. Gjithashtu, pesha e depozitave në valutë ndaj M3 është rritur në 34 për qind, kundrejt 29 për qind në fund të vitit 2006.

Hapësirë informuese 4. Euroizimi dhe struktura valutore e parasë.

Shkalla e dollarizimit (euroizimit) në një ekonomi ndërthuret me optimizimin e situatës financiare dhe të rrezikut nga ana e agjentëve ekonomikë. Strategjia e agjentëve i përgjigjet performancës dhe politikave makroekonomike të një vendi, sikundër edhe zhvillimit teknologjik. Ndërthurja e të gjitha këtyre elementeve njëkohësisht e bën të paqëndrueshme çdo lidhje midis shkallës së euroizimit dhe ndonjë treguesi makroekonomik. Mënyra e reagimit të agjentëve ekonomikë ndaj politikave makro në formën e euroizimit e bën më të vështirë hartimin dhe implementimin e politikave standarde. Megjithatë, ekziston një literaturë e gjerë teorike mbi sjelljen e agjentëve

që zgjedhin euroizimin, e cila ndihmon në interpretimin e lidhjeve të mundshme midis shkallës së euroizimit dhe treguesve të ndryshëm makroekonomikë.

Një nga motivet parësore për euroizim vjen nga ndërprerja ose luhatja e tregjeve dhe shërbimeve financiare në periudha tranzitore. Përgjithësisht, stabilizimi i tyre nuk shoqërohet me një proces të kundërt de-euroizues. Euroizimi kryesisht merr formën e depozitave në valutë. Literatura ekonomike numëron disa faktorë që mund të veprojnë ndaj strukturës valutore të parasë së gjerë. Përveç efekteve tranzitore sikurse paqëndrueshmëritë e përkohshme, të cilat iniciojnë një proces euroizimi, veprojnë edhe efekte psikologjike dhe faktorë të tjerë. Kështu, intensiteti i përcimit të ndryshimeve të kursit të këmbimit apo luhatja e tij, sikurse edhe luhatja e normave të interesave dhe e indeksit të çmimeve mund të shoqërohen me rritje ose ulje të shkallës së euroizimit. Megjithatë, mbetet e vështirë për të interpretuar çdo raport midis shkallës së euroizimit dhe këtyre faktorëve në një lidhje shkak-pasojë. Gjatë viteve '90 shkalla e euroizimit (dollarizimit) në vendet në tranzicion, luhatej nga 40 për qind në rreth 80 për qind. Kjo shkallë euroizimi përfaqëson nivelin e depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave të sistemit bankar. Në Shqipëri, raporti i depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave përbën rreth 40 për qind. Ndër faktorët potencialë që shoqërojnë një proces euroizimi, rritja në terma vjetorë e normës së interesit ka pasqyruar luhatjet në shkallën e euroizimit gjatë viteve '90.




3.1.1.4. Kredia për Sektorin Privat

Në kushtet e një situatë të qëndrueshme makroekonomike, kërkesa e ekonomisë për financim gjatë vitit 2007 ka vijuar të jetë e lartë. Bankat tregtare, në përgjigje të kësaj kërkesë kanë thelluar rolin e tyre si ndërmjetës financiarë, duke ofruar produkte të reja të përshtatura me nevojat e klientëve. Këto zhvillime pozitive kanë nxitur zgjerimin e portofolit të kredisë si dhe përmirësimin e ndjeshëm të treguesve të ndërmjetësimit financiar.

Raporti i kredisë për ekonominë ndaj prodhimit të brendshëm bruto u rrit ndjeshëm me 8.8 pikë përqindjeje, duke arritur në 30.1 për qind në fund të vitit. Në këto nivele është zgjeruar dhe raporti i kredisë ndaj ofertës së parasë dhe ndaj aktiveve të sistemit, duke shënuar përkatësisht nivelet 38 për qind dhe 40 për qind, në dhjetor 2007.

Megjithatë, gjatë vitit 2007, norma e rritjes së kredisë është ngadalësuar në 50.4 për qind², duke shënuar normën më të ulët të dy viteve të fundit. Gjithsesi edhe në këto nivele, rritja e portofolit të kredisë vlerësohet të jetë e lartë dhe mbart në një periudhë afatmesme rreziqe potenciale si për stabilitetin e çmimeve ashtu edhe për atë financiar.

Grafik 9. Ecuria e portofolit të kredisë.




Struktura e kredisë sipas monedhave nuk ka pësuar ndryshime të ndjeshme gjatë vitit. Kredia në valutë dominon tepriçën e kredisë me 72.3 për qind të portofolit, krahasuar me 71.1 për qind në dhjetor të vitit 2006. Në ndryshim nga dy vitet e fundit, viti 2007 tregoi një prirje më të madhe të bankave drejt kredisë në valutë. Në veçanti në pjesën e dytë të vitit, kredia në valutë shënoi ritme më të larta rritjeje (mesatarisht prej 53.5 për qind) krahasuar me kredinë në lekë (mesatarisht prej 49.8 për qind).

Shpërndarja e portofolit të kredisë sipas monedhave, favorizohet nga diferenca e ndjeshme e normës së interesit për kredinë në lekë ndaj asaj në monedhë të huaj, shoqëruar në të njëjtën kohë nga një vlerësim i qëndrueshëm i lekut gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, edhe kuotimi i çmimeve të disa produkteve të ndërmjetme apo të përfunduara³ në monedhë të huaj (në euro), mendohet se nxit kërkesën për kredi në euro. Kjo kredi, në dhjetor 2007 arriti në 90 për qind të portofolit të kredisë në valutë.


Kontributin kryesor në rritjen e kredisë e japin bizneset, që dominojnë portofolin e kredisë me 63%. Megjithatë, në dy vitet e fundit ky kontribut është

Grafik 10. Ecuria e portofolit të kredisë sipas monedhave.



në rënie të qëndrueshme, si rezultat i orientimit të bankave drejt bankingut me pakicë (*retail banking*), financimit të individëve. Në dhjetor të vitit 2007 norma vjetore e rritjes së kredisë për biznese u zvogëluua në 43%, si pasojë e ngadalësimit të ritmeve të kredisë për investime si dhe rritjes më të shpejtë të kredisë për kapital qarkullues. Kjo e fundit karakterizohet nga periudha afatshkurtra maturimi dhe për pasojë, nivelet e larta të shlyerjes të kredisë kanë ndikuar në rritjen më të ulët të portofolit të kredisë për biznese. Gjatë vitit, bankat kanë kredituar më shumë bizneset që ushtrojnë aktivitetin në tregti (me 38.1%), industri (26.1%) dhe ndërtim (21.1%[1]). Bujqësia mbetet sektori më pak i kredituar nga sistemi bankar, duke thithur vetëm 1.2% të kredisë dhënë bizneseve.


Grafik 11. Ecuria e portofolit të kredisë së bizneseve.



Kreditimi i individëve ka ruajtur norma të larta rritjeje, mesatarisht 67 për qind për vitin 2007, duke dhënë një kontribut më të lartë në zgjerimin e portofolit të kredisë. Kjo ecuri është mbështetur në ritmet e larta (mesatarisht

prej 77 për qind) të rritjes së portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme, e cila dominon kredinë për individë. Nën presionin e konkurrencës në treg, bankat kanë prezantuar oferta atraktive (tërheqëse), të cilat i janë përgjigjur më mirë kërkesës në rritje për kredi hipotekare. Ndërkohë, gjatë vitit 2007 kredia konsumatore u rrit me ritme më të ulta. Kjo solli dhe zvogëlim të peshës së saj ndaj totalit të kredisë për individë në 25.5 për qind, krahasuar me 27.5 në vitin 2006. Në muajin korrik, kredia konsumatore shënoi rritje të ndjeshme me 5 miliardë lekë e nxitur nga kërkesa për financimin e pushimeve verore. Në ndryshim nga një vit më parë kjo rritje nuk u përsërit në festat e fundvitit. Ngadalësimi i ritmeve të kredisë konsumatore, në veçanti gjatë tremujorit të katërt, është ndikuar si nga rritja e kostos për këtë kredi ashtu edhe nga prirja e bankave për t'u treguar më të kujdesshme në zgjerimin e këtij produkti.

Grafik 12. Ecuria e portofolit të kredisë për individët.



Burim: Banka e Shqipërisë.

Hapësirë informuese 5. Kriza e kredive hipotekare në SHBA dhe implikimet e saj për stabilitetin financiar.


Në përgjigje të kërkesës së lartë për të blerë shtëpi në fund të viteve '90 dhe gjatë viteve 2001 – 2005, kredia hipotekare në SHBA u rrit ndjeshëm. Në prani të normave të ulëta të interesit, një niveli të mirë likuiditeti, si dhe çmimeve të larta të shtëpive, bankat amerikane ofruan kredi hipotekare me kushte lehtësuese, duke rritur ekspozimin e tyre edhe ndaj segmentit të kredimarrësve me rrezik relativisht të lartë. Kredi të tilla hipotekare, dhënë individëve me mundësi më të lartë moskthimi, të quajtura subprime, vlerësohet të përbëjnë rreth 15-25 për qind të kredisë hipotekare dhënë në SHBA. Kreditë për këtë kategori u dhanë fillimisht me normë të ulët interesi, të fiksuar për dy vjet, e cila më pas do të ishte e ndryshueshme në varësi të normave të interesit në treg. Rritja e normës së interesit në SHBA, e cila filloi që në mes të vitit 2004 e shtrenjtoi këstin e kredisë për kredimarrësit, ndërkohë që çmimet në rënie të banesave, të vëna si kolateral kufizuan më tej mundësitë e kredimarrësve për të shitur shtëpitë dhe për të shlyer kredinë. Kjo situatë solli rritjen e kredive me probleme për bankat amerikane, me përkeqësime të dukshme veçanërisht në segmentin e kredisë hipotekare subprime.

Problemet e mësipërme në tregun bankar të SHBA-së tronditën tregjet globale financiare si rrjedhojë e shndërrimit të kredive hipotekare subprime në instrumente investimi. Kështu, kreditë subprime, u grupuan dhe iu shitën investitorëve në formë letrash me vlerë. Investitorët përfitonin më pas pagesa periodike, të cilat lidheshin me pagesat e shlyerjes së kredive. Këto letra me vlerë kryesisht u blenë nga fondet e pensionit, kompanitë e sigurimit, kompanitë e investimit si dhe bankat në mbarë botën, dhe u përdorën si kolateral për të përfituar financime afatshkurtra në tregun ndërbankar dhe atë të parasë. Procesi i shndërrimit të kredive hipotekare subprime në letra me vlerë, përveçse ofroi diversifikim të rrezikut për bankat që jepnin kredi të tilla, nga ana tjetër shkëputi njësinë që analizonte rrezikun (bankën), nga njësia që mbarhte rrezikun e vërtetë (blerësit e letrave me vlerë të mbështetura nga kreditë hipotekare subprime).

Në muajt e parë të vitit 2007 rritja e kredive me probleme në segmentin e kredive hipotekare subprime u bë edhe më e dukshme. Bankat filluan të shtrëngojnë standardet e kredidhënies dhe agjencitë e vlerësimit të rrezikut filluan të ulin vlerësimin për cilësinë e letrave me vlerë të mbështetura nga këto kredi. Rënia e besimit të investitorëve në këto letra me vlerë u reflektua në rënien e kërkesë për to. Këto zhvillime përçuan pasiguri në tregun ndërbankar dhe shumë banka nuk ishim më të gatshme për t’u ofruar fonde afatshkurtra bankave të tjera. Kjo krizë besimi u shndërrua në krizë likuiditeti në fillim të muajit gusht, ku LIBOR njëditor u rrit me 50 pikë përqindje brenda një dite.

Në këto kushte, Banka Qendrore Evropiane, duke vlerësuar se tensioni në tregjet amerikane po godiste tregun e parasë dhe atë ndërbankar në Evropë, injektoi likuiditet prej më shumë se 130 miliardë euro nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes, në mënyrë që të shmangte ndonjë krizë të mundshme likuiditeti në sistemin bankar evropian. Një operacion i tillë nuk ishte ndërmarrë që pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001. Ndërkohë, Banka Federale e Rezervave, përveç injektimit të likuiditetit në treg, uli disa herë normën bazë të interesit. Banka e Anglisë ushtroi funksionin e saj si “huadhënëse e dorës së fundit” për të shpëtuar bankën angleze Northern Rock, e cila në mënyrë të veçantë mbështetej kryesisht në financime afatshkurtra për aktivitetin e saj kreditues, dhe u godit më shumë nga të gjitha institucionet e tjera nga kjo turbullirë financiare.

Grafik 13. Ecuria e LIBOR-it dhe rezultatet e vërtetimit të analistëve të kredisë të bankave.



Efektet negative të krizës së kredive hipotekare subprime në tregjet financiare botërore, u zbutën deri-diku nga masat e marra prej bankave qendrore. Pavarësisht se disa institucione të mëdha financiare regjistruan humbje, si rrjedhojë e investimit në letra me vlerë të mbështetura nga kredi të tilla, deri tani nuk ka patur pasoja të rënda në tregjet e vendeve të zhvilluara apo në zhvillim. Megjithatë, pasojat e krizës së verës së vitit 2007 mund të ndihen edhe gjatë vitit 2008, duke qenë se problemet në kreditë hipotekare subprime nuk janë materializuar ende plotësisht, duke mbetur faktorë potencialë që mund të çenojnë sërish stabilitetin e tregjeve rajonale apo globale.

Efektet e kësaj krize në tregjet financiare evropiane dhe amerikane nuk duket të jenë përçuar në sistemin bankar shqiptar. Bankat që operojnë në Shqipëri janë degë apo bija të bankave të huaja, kryesisht italiane, austriake, franceze, turke dhe greke. Sipas vlerësimeve të bankave qendrore të këtyre vendeve, asnjë nga bankat nuk rezulton të jetë prekur në mënyrë direkte nga kjo krizë, madje edhe ekspozimi indirekt është i ulët. Bazuar në këto vlerësime, si dhe në faktin që për bankat mëmë filialet apo degët që operojnë në Shqipëri përfaqësojnë një pjesë shumë të vogël të aktivitetit të tyre, mund të presim që edhe nëse kriza e mësipërme do të prodhojë probleme të mëtejshme, pasojat e tyre të pasqyrohen në nivele minimale në sistemin tonë bankar.

Pavarësisht se zhvillimet në tregun global financiar nuk shfaqin rreziqe të ndjeshme për sistemin tonë financiar, ato shërbejnë si raste nga të cilat duhet të nxirren mësim. Mësimi i parë dhe kryesor që mund të nxjerrim prej krizës së mësipërme lidhet me pasojat e lehtësimit të standardeve dhe kushteve të kredidhënies, në prani të kërkesës së lartë për kredi dhe konkurrencës në rritje mes bankave. Një situatë e ngjashme është edhe ajo që po kalon sistemi bankar shqiptar. Gjithashtu, edhe tregu i kredive hipotekare është në rritje të lartë prej disa vitesh tashmë. E gjithë kjo situatë kërkon kujdes maksimal nga ana e bankave në drejtim të ruajtjes së cilësisë së kreditimit, si dhe vëmendje të vazhdueshme nga ana e Bankës së Shqipërisë. Së fundi, mbi të gjitha, kriza e origjinuar nga kreditë supprime është një shembull i transformimit të rrezikut dhe mosvlerësimit si duhet të tij nga ana e investitorëve. Si rrjedhojë, ajo që gjithmonë nevojitet është një mbikëqyrje e kujdesshme dhe efektive nga ana e institucioneve përgjegjëse për mbarëvajtjen e sistemit financiar, në mënyrë që zhvillimi i mëtejshëm i tij të mbahet nën kontroll dhe brenda parametrave të shëndetshëm.


3.2. TREGJET FINANCIARE DHE NORMAT E INTERESIT

3.2.1. OPERACIONET NË TREG TË HAPUR

Përgjatë vitit, ndërhyrjet në treg të hapur kanë qenë instrumenti kryesor për zbatimin e politikës monetare. Këto kanë patur për qëllim administrimin e nivelit të likuiditetit në sistemin bankar dhe të normave afatshkurtra të interesit, në të njëjtën linjë me objektivat e politikës monetare. Në përgjithësi, viti 2007 është karakterizuar nga kërkesë më e lartë për likuiditet, e cila është plotësuar nëpërmjet operacioneve në treg të hapur. Niveli mesatar ditor i likuiditetit llogaritet 4.8 miliardë lekë nga 7.4 miliardë lekë një vit më parë, por kjo gjendje nuk ka qenë e njëtrajtshme përgjatë vitit. Ndërsa në vitin 2006, kërkesa për likuiditet u evidentua në tremujorin e fundit të vitit, në 2007 ajo u shfaq që në tremujorin e dytë. Në tremujorin e parë të vitit

2007, sistemi ka rezultuar me tepriçë likuiditeti, ndikuar nga kthimi i parasë në sistem dhe efekti pozitiv i veprimeve të qeverisë, si dhe likuiditeti i siguruar nga ankandet e anasjellta të riblerjes në fundvitin e kaluar. Kjo sasi likuiditeti është tërhequr nëpërmjet ankandëve të marrëveshjeve të riblerjes me afat 7-ditor dhe operacioneve strukturore, ankande të marrëveshjes së riblerjes me afat njëmuor dhe tremujor. Vëllimi mesatar ditor i tërhequr nëpërmjet këtyre operacioneve llogaritet rreth 7.9 miliardë lekë, nga 5.2 miliardë lekë në vitin e kaluar. Në tremujorin e dytë të vitit dhe në vazhdim, sistemi bankar tregoi rritje të kërkesës për likuiditet. Kjo bëri që kahu i operacioneve të ndryshojë drejt përdorimit të instrumenteve të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes, duke injektuar likuiditet në treg (mesatarisht në vlerën 2.2 miliardë lekë). Mungesa e tij në këtë periudhë ka ardhur kryesisht nga dalja e parasë në sezonin veror dhe niveli i lartë i tepriçave buxhetore. Që prej muajit korrik, një pjesë e këtyre tepriçave është investuar në depozita me afat pranë bankës qendrore, si një alternativë që u prezantua në këtë periudhë.

Grafik 14. Vëllimi mesatar ditor në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes (në miliardë lekë) (majtas) dhe interesi mesatar i ponderuar në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me afat njëjavor dhe ndryshimi i normës bazë (djathtas).




Operacionet në treg të hapur, krahas administrimit me efektivitet të likuiditetit kanë synuar të jenë në përputhje me vendimet e politikës monetare të ndërmarra nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Në gjysmën e dytë të vitit, janë organizuar në formën e ankandëve me çmim të papërcaktuar e me shumë të kufizuar. Lehtësia e depozitës njëditore është përdorur pak a shumë në mënyrë të njëtrajtshme përgjatë vitit. Vëllimi mesatar ditor i depozitës njëditore shënon vlerën 1.5 miliardë lekë, pranë asaj të vitit të kaluar 1.6 miliardë lekë. Kredia njëditore është përdorur në raste shumë të rralla dhe shuma të vogla, dhe nevojat afatshkurta për likuiditet janë siguruar në tregun ndërbankar.

3.2.2. NORMAT E INTERESIT

Normat afatshkurtra të interesit kanë reflektuar politikën shtrënguese të bankës qendrore të sinjalizuar në tre momente, fundmuaj qershor, shtator

dhe nëntor. Interesat e huadhënies në tregun ndërbankar janë luhatur brenda korridorit të ripërcaktuar nga ndryshimi i normës bazë të interesit me +0.75 pikë përqindjeje. Ky treg ka funksionuar për plotësimin e nevojave njëditore dhe shtatëditore për likuiditet, ndërkohë që nevojat për afate më të gjata janë siguruar nga operacionet në treg të hapur. Vëllimi mesatar ditor i huadhënies ka shënuar rritje krahasuar me një vit më parë, nga 1.5 miliardë lekë në 2.0 miliardë lekë, niveli më i lartë në vitet e fundit, por ka qenë më i përqendruar në gjysmën e dytë të vitit.

Me përjashtim të tremujorit të tretë, tregu nuk ka operuar në kushte të presioneve për mungesë likuiditeti, gjë që është reflektuar në ruajtjen e normave njëditore të interesit pranë kufirit të poshtëm. Interesi mesatar i ponderuar për transaksionet njëditore shënon vlerën 4.80 për qind në vitin 2007, nga 4.60 për qind në vitin 2006. Normat e interesit për transaksionet shtatëditore janë luhatur pranë interesit për marrëveshjet e riblerjes me afat shtatëditor dhe në pjesën më të madhe nën këtë nivel. Krahasuar me një vit më parë, norma mesatare e interesit për transaksionet shtatëditore u rrit me 0.43 pikë përqindjeje në 5.67 për qind, duke ndjekur ecurinë e normës bazë të interesit.




Në tregun primar, *yield*-et e bonove të thesarit janë ndikuar si nga orientimi për lëvizjen e normave të interesit ashtu dhe nga faktorë të tregut. Në mars, *yield*-et ranë me rreth 0.70 pikë përqindjeje nga fundviti 2006, duke reflektuar një korrektim ndaj rritjes së tyre në fund të vitit dhe gjendjen e lartë të likuiditetit.

Në fund të muajit qershor, *yield*-i 12-mujor arriti përkatësisht në 7.99 për qind nga 7.07 për qind, në fund të muajit mars. Në rritjen e *yield*-it në këtë periudhë u faktorizua pjesërisht pritja për rritjen e normës bazë të interesit (kjo u rrit me 0.25 pikë përqindjeje në 28 qershor).

Në gjysmën e dytë të vitit, *yield*-et janë zhvendosur në momentin pas vendimit për rritje të normës bazë të interesit, pothuajse në të njëjtën masë të


sinjalizuar (ato 3-mujore) dhe më pas janë luhatur në varësi të ndryshimeve në raportet ofertë/kërkesë. Në përgjithësi, tregu primar ka rezultuar në çlirim të likuiditetit me uljen e kërkesës së qeverisë për financimin me bono thesari (mjete afatshkurtra) dhe zhvendosjen drejt financimit me obligacione (mjete afatgjata).

Gjatë muajit dhjetor, u vu re një hezitim i bankave për të investuar në tregun primar të bonove të thesarit. Kjo gjë solli nga njëra anë çlirim të likuiditetit dhe nga ana tjetër, rritje të *yield*-eve në kushtet kur të gjitha ofertat u pranuan, për të realizuar kufirin e financimit të brendshëm të deficitit. Në fund të muajit dhjetor, *yield*-i 12-mujor rezultoi në nivelin 8.32 për qind ose 0.44 pikë përqindjeje më lart se një vit më parë.



Portofoli i bankave me obligacione të qeverisë është rritur me 55.0 miliardë lekë, gjatë vitit 2007. Gjatë këtij viti, u theksua më tepër preferenca e sistemit bankar për të zhvendosur portofolin drejt obligacioneve, duke ulur atë në bono thesari. Kjo prirje është në linjë me politikën për financimin e brendshëm, ku shumat e emetuara për obligacionet kanë tejkaluar ato të maturuarat. Në fund të vitit, *yield*-et për këto letra me vlerë janë pozicionuar në të njëjtat vlera si një vit më parë, përkatësisht në 8.95 për qind për obligacionet 3-vjeçare dhe 9.65 për qind për ato 5-vjeçare. Gjatë vitit, kërkesa për të investuar në to ka qenë e lartë, duke mos ushtruar presione rritëse.

Duke shfrytëzuar ecurinë e treguesit të financimit të brendshëm në fund të vitit, pjesëmarrësit në ankandet e obligacioneve 2-vjeçare ushtruan presion në rritjen e tij deri në 8.60 për qind. Ky tregues zbriti përsëri në janar të këtij viti në nivelet e nëntorit, 8.35 për qind.




Në muajin dhjetor u emetuan për herë të parë obligacione me maturim 7-vjeçar. Kjo shënoi jo vetëm prirjen për të zgjatur afatin e borxhit, por edhe pjesëmarrjen e institucioneve të huaja financiare në financimin e deficitit publik. Renditja e Shqipërisë nga institucionet përkatëse ndërkombëtare përsa i përket rrezikut të vendit, pritet që të rrisë interesin e institucioneve të huaja për investime në vend. Tregu sekondar për letrat me vlerë të qeverisë vazhdon të mos jetë i zhvilluar dhe transaksionet në këtë treg janë të kufizuara si për nga shumat ashtu dhe nga pjesëmarrësit. Kjo gjë ka kufizuar dhe vlerësimin mbi ecurinë e çmimit të letrave me vlerë në tregun e kapitaleve.

Interesat për depozitat janë rritur duke sjellë dhe një fluks më të lartë të kursimeve. Interesat e depozitave në lekë kanë treguar një reagim të plotë dhe të shpejtë ndaj sinjaleve të politikës monetare, duke përcjellë rritjen e normës bazë në vlerën e kursimeve të publikut.

Në fund të vitit 2007, norma mesatare e ponderuar e depozitave 12-mujore në lekë arriti nivelin 6.33 për qind ose 0.87 pikë përqindjeje më lart se një vit më parë, duke tejkaluar marzhin prej 0.75 pikë përqindjeje të rritjes së normës bazë të interesit.

Depozitat në valutë vazhdojnë të rriten me ritme të larta, mesatarisht 35 për qind në vitin 2007 nga 27 për qind në vitin 2006, pavarësisht nga zgjerimi i diferencës së interesave për këto monedha. Interesat 12-mujorë në euro u rritën me 0.78 pikë përqindjeje gjatë këtij viti, nga 3.45 për qind në 4.23 për qind. Në të njëjtën kohë, norma referencë për monedhën euro është rritur me 0.50 pikë përqindjeje, nga 3.50 për qind në 4.00 për qind. Diferenca me normat e interesit të depozitave në euro (të cilat zënë pjesën më të madhe të depozitave në valutë) është zgjeruar që prej gjysmës së dytë të vitit, gjë që mendohet të ketë mbështetur vlerësimin e monedhës vendase.




Rritja e kërkesës për kredi konsumatore gjatë vitit dhe përpjekjet për të fituar treg në këtë portofol, duket se kanë sjellë dhe një ulje të normave të interesit të kredisë në lekë, në tremujorin e dytë dhe në atë të tretë të vitit.

Forcimi i presioneve inflacioniste dhe tërheqja e vëmendjes për forcimin e kushteve të kredidhënies, ka sjellë rritje të normës së interesit për kredinë në lekë dhe një ngadalësim të kredisë konsumatore në tremujorin e fundit të vitit. Pësha e kredisë në lekë mbetet ende e ulët dhe interesat për këtë tregues janë të luhatshëm nga një periudhë në tjetrën, në varësi të shpërndarjes së kredidhënies.


Gjatë vitit, interesi mesatar i ponderuar për kredinë në lekë shënon vlerën 13.57 për qind nga 13.61 për qind vitin e kaluar. Rritja e konkurrencës së sistemit bankar në kredidhënie, ka ndikuar në ruajtjen e një niveli mesatar të normës së kredisë, pavarësisht orientimit të politikës monetare.

Grafik 19. Interesi mesatar i ponderuar për kredinë e re.



Kjo ka sjellë një ulje të kostos së ndërmjetësimit gjatë këtij viti. Mesatarisht, ky tregues llogaritet në 8.9 pikë përqindjeje, nga 9.4 pikë përqindjeje vitin e kaluar. Kjo shifër është më e ulët për kredinë e akorduar në monedhën evropiane. Rritja e normave të interesit në euro në tregun evropian, në gjysmën e dytë të vitit është reflektuar dhe në tregun e kredive, por me intensitet më të ulët se në atë të depozitave. Norma mesatare e kredisë së re, të akorduar në euro gjatë vitit 2007 është rritur me 0.45 pikë përqindjeje, në 8.43 për qind. Rritja e interesave të kredisë në euro ka ngushtuar diferencën me ata të kredisë në lekë. Ky tregues rezulton 5.1 pikë përqindjeje në vitin 2007 nga 5.6 pikë përqindjeje, në vitin 2006 dhe 6.2 për qind në vitin 2005. Megjithatë, interesat për kredinë në euro kundrejt asaj në lekë, mbeten ende tërheqës dhe kredia në euro mbizotëron peshën e kredidhënies nga sistemi bankar.

Grafik 20. Diferenca midis interesave të kredisë dhe depozitave (mesatare e ponderuar).




3.2.3. KURSI I KËMBIMIT

Tendenca mbiçmuese e lekut është forcuar gjatë vitit 2007, duke kulmuar në tremujorin e fundit të tij. Në terma nominalë efektivë vjetorë, gjatë vitit leku është mbiçmuar kundrejt monedhave të huaja mesatarisht me 1.4 pikë përqindjeje, krahasuar 1.1 për qind mbiçmim në vitin 2006. Paralelisht, gjatë vitit 2007, kursi real efektiv i këmbimit paraqet një rritje vjetore mesatarisht prej 4.4 pikë përqindjeje, ndërkohë që një vit më parë mbiçmimi i lekut kundrejt monedhave të huaja ka qenë 1.0 për qind. Ky mbiçmim nënkupton uljen e konkurrencës ndaj tregjeve ndërkombëtare dhe atraktivitet më të lartë

për importet e mallrave të huaja. Nga ana tjetër, mbiçmimi i kursit efektiv të këmbimit ka ndikuar në përcimin e ulët të inflacionit të importuar dhe zbutjen e inflacionit total. Sjellja mbiçmuese e lekut si në terma realë ashtu edhe nominalë reflekton qëndrueshmërinë makroekonomike në vend, thellimin e diferencës së normave të interesit si dhe nivelet e krahasueshme të inflacionit me partnerët kryesorë.

Krahasuar me një vit më parë, gjatë vitit 2007 leku paraqet një luhatshmëri më të lartë. Rritja e dinamikës reflekton zhvillimet e tregjeve ndërkombëtare si dhe pjesëmarrjen më aktive të agjentëve vendas në tregun valutor. Krahas

reflektimit të zhvillimeve në tregun ndërkombëtar (ku dollari ka humbur pikë të vazhdueshme ndaj euros, duke pasqyruar problemet e ekonomisë amerikane), kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave është ndikuar nga ndryshimi i raporteve kërkesë-ofertë në tregun vendas. Leku është forcuar në periudhat sezonale të prurjeve të emigrantëve për valutë, të konvertimit të kapitalit të disa bankave dhe hyrjeve nga privatizimi. Pozitat e lekut janë forcuar në mënyrë të vazhdueshme ndaj dollarit amerikan mesatarisht 7.8 për qind, duke arritur në 83.38 lekë/usd në fund të 2007, ndërkohë që kanë qenë të luhatshme kundrejt euros. Në terma mesatarë, euro është kuotuar 123.63 lekë gjatë vitit 2007, ndërsa ka patur minimumin në fund të muajit dhjetor, 120.91 lekë.



Hapësirë informuese 6. Përçimi i lëvizjeve të kursit të këmbimit në normën e inflacionit.


Lidhja e çmimeve me kursin e këmbimit është studiuar me interes gjatë viteve '60 dhe në fillimet e viteve '70. Fillimisht u ngritën modele që supozonin një lidhje unitare midis tyre, duke u mbështetur në teorinë e 'Ligjit të një çmimi'. Më pas u ngritën modele të Paritetit të Fuqisë Blerëse (absolute dhe relative), të cilat u përdorën për të identifikuar lëvizjet në kursin e këmbimit. Mirëpo, teste të shumta empirike nuk i mbështetën këto supozime, duke hedhur idenë se lëvizjet në kursin e këmbimit nuk pasqyrohen plotësisht në nivelin e çmimeve të një vendi (përçim i paplotë i kursit të këmbimit). Tashmë ka shumë modele/teori që shpjegojnë pse ky përçim është i paplotë. Së fundmi, punime të shumta empirike kanë dëshmuar se përveçse i paplotë, ky përçim është edhe në rënie.

Në literaturë termi "përçim" gjendet me përcaktime të ndryshme. Shpesh këto përcaktime përmbledhen në dy kategori, të ndara sipas fazave të përçimit të kursit të këmbimit. Përçimi i shkallës së parë i referohet ndjeshmërisë së çmimeve të importit të një vendi ndaj ndryshimeve në kursin e këmbimit të valutës së atij vendi. Përçimi i shkallës së dytë përfaqëson ndjeshmërinë e çmimeve të konsumit ndaj ndryshimeve

në çmimet e importit. Sidoqoftë, në shumë punime nuk bëhen dallime midis këtyre dy fazave, duke përcaktuar direkt si përcim të kursit të këmbimit ndryshimeve të konsumit të një vendi ndaj ndryshimeve në kursin e këmbimit të valutës së atij vendi. Për rrjedhojë, ky përkufizim përfshin efektin e lëvizjeve të kursit të këmbimit si në çmimet e importit ashtu dhe në çmimet e shportës së konsumatorit.

Literatura mbi politikën monetare në Shqipëri shpesh ka konsideruar kanalin e kursit të këmbimit si kanalin më të rëndësishëm për të shpjeguar zhvillimet inflacioniste në Shqipëri (Muça et al, 2004). Nisur nga rëndësia e kursit të këmbimit në një ekonomi të vogël dhe të hapur siç është rasti i ekonomisë shqiptare, banka qendrore nuk i ka injoruar zhvillimet në kursin e këmbimit të lekut. Këto zhvillime janë ndjekur me kujdes dhe, në momente të caktuara, është ndërhyrë për të shmangur luhatjet e konsideruara si çregulluese.

Grafik 22. Rritja vjetore e kursit nominal efektiv të këmbimit dhe inflacioni vjetor (në %).



Për më tepër, kursi i këmbimit është një nga variablat kryesorë të përfshirë në procesin e parashikimit të inflacionit, krahas faktorëve të tjerë që ushtrojnë presione inflacioniste. Po kjo literaturë, ka vërejtur dhe ndryshimin në marrëdhënien mes kursit të këmbimit dhe inflacionit pas viteve 2000 (Peeters, 2005). Gjithashtu, duke qenë në linjë me rezultatet e gjetura edhe në vendet e tjera, përcimi i kursit të këmbimit në çmimet e konsumit në Shqipëri paraqitet me një rënie të lehtë (Istrefi dhe Semi, 2007).

Rezultatet tregojnë se çmimet e konsumit reagojnë shpejt ndaj goditjeve në kursin nominal efektiv të këmbimit. Përcimi i një goditjeje në kursin e këmbimit arrin në 42 për qind, në katër muajt e parë. Brenda vitit, përcimi arrin maksimumin në muajin e nëntë, rreth 99 për qind. Goditjet në kursin e këmbimit janë relativisht të rëndësishme, në shpjegimin e luhatjeve në çmimet e konsumit krahasuar me variablat e tjerë. Deri 24.5 për qind e luhatjeve në çmime shpjegohet nga goditjet në kursin nominal të këmbimit, ndërsa pjesa më e madhe e variancës në çmimet e konsumit shpjegohet nga luhatjet e veta.

Grafik 23. Përcimi i akumuluar i kursit nominal efektiv të këmbimit në çmimet e konsumit.



Si justifikues të ndryshimit të sjelljes së përcimit renditen së bashku faktorë mikro dhe makroekonomikë. Zhvillimet në strukturat e tregut, stabiliteti i lekut, mjedisi inflacionist dhe besueshmëria në Bankën e Shqipërisë pas viteve 2000, duken si "justifikues" të mirë të një përcimi në ulje të kursit të këmbimit në çmimet e konsumit.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se zhvillimet në kursin e këmbimit nuk kanë më rëndësi në formimin e çmimeve të konsumit në Shqipëri. Performanca e rezultateve të çon drejt idesë se ekziston një asimetri në përcimin e kursit të këmbimit: përcimi është më i lartë në kushtet e një nënçmimi të lekut dhe e anasjellta, në rastin e një mbiçmimi.

Duke marrë parasysh faktin se gjatë pesëvjeçarit të fundit luhatshmëria në kursin e këmbimit ka qenë shumë e ulët

mund të justifikojmë vështirësinë e identifikimit të lidhjeve statistikisht të rëndësishme, me tregues të tjerë makroekonomikë. Kështu, autoriteti monetar duhet të jetë i vëmendshëm dhe të zgjedhë reagimin e duhur ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit të lekut.

SHËNIME

¹ Treguesi i parasë jashtë bankave në këtë material është vlerësuar si një tregues më i përshtatshëm i ecurisë së përbërësit likuid të M3, kundrejt agregatit M1. M1, përveç parasë jashtë bankave, përfshin depozitat pa afat në lekë. Këto të fundit kanë shënuar luhatje të theksuara në vitet e fundit, të cilat nuk paraqesin ecurinë e kërkesës për para likuide në ekonomi.

² Dhjetor 2007.

³ Më konkretisht, i referohemi kuotimit në euro të çmimit të pasurive të paluajtshme, automobilave si dhe produkteve ose lëndëve të para që importojnë bizneset e sektorëve të ndërtimit, tregtisë dhe industrisë.

KAPITULLI IV. MBIKËQYRJA BANKARE

4.1. LICENCIMI DHE KUADRI RREGULLATIV

Hyrja në fuqi e ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe zbatimi në vazhdimësi i objektivave afatmesëm dhe afatgjatë të Bankës së Shqipërisë, konsolidoi punën për rishikimin e kuadrit rregullativ të mbikëqyrjes bankare për përputhshmërinë me dispozitat e ligjit të ri, ndërthurjen me zbatimin e parimeve të rishikuara të Komitetit të Bazelit për një mbikëqyrje efektive dhe koncepteve të reja të Akordit të Ri të Kapitalit, direktivave të Këshillit Evropian dhe praktikave më të mira në fushën e rregullimit e mbikëqyrjes së institucioneve financiare, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

4.1.1. KUADRI RREGULLATIV

Gjatë vitit 2007, kuadri rregullativ u pasurua me dy rregullore të reja, ndërkohë që disa prej atyre ekzistuese iu nënshtruan një procesi përmirësimi.

Rregullorja "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja"; krijon bazat e kuadrit rregullator mbikëqyrës për degët e bankave të huaja. Rregullorja parasheh që veprimtaria e degës është administrativisht e varur dhe e autorizuar nga banka mëmë. Ndërkohë që, dhe tërësia e rreziqeve dhe ekspozimi ndaj tyre është përgjegjësi e bankës mëmë, dhe analizohet në kuadër të bankës në tërësi. Rregullorja përcakton instrumentet që garantojnë veprimtari të sigurt dhe të qëndrueshme të degës së bankës së huaj, të licencuar për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Rregullorja "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor"; përfshin kërkesa që lidhen me integritetin, transparencën me klientin, mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit, nivelin e kapitalit, mënyrën e raportimit, mbikëqyrjen etj.. Rregullorja parashikon një ulje të kërkesave për kapital, për subjektet që kryejnë veprimtarinë e këmbimit valutor.

Përmirësime u realizuan edhe në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit". Ato lidhen me përdorimin e koeficientit 150 për qind të aktiveve të bankës, për ponderimin e një pjese të kredisë së rregullt dhe/ ose me probleme, në rastet kur tejkalohej disa kufij të treguesve siç përcaktohet në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë".

Kështu, pjesës së aktiveve të ponderuara me rrezikun, si element i llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit, i shtohen aktive të ponderuara me koeficientin 150 për qind.

4.2. LICENCIMI

Gjatë vitit 2007, Banka e Shqipërisë u përball me ndryshime të rëndësishme strukturore në industrinë bankare, për shkak të procesit të konsolidimit që përfshiu sistemin bankar. Si rrjedhojë e ndryshimeve cilësore dhe sasiore, struktura e kapitalit aksioner të sistemit bankar u rrit, në favor të pjesëmarrjes së kapitalit të huaj.

Ndërkohë që numri i bankave me kapital privat tërësisht shqiptar pësoi një ulje të ndjeshme, në vetëm një bankë (Banka Union) nga tre që ishin një vit më parë, shenjë kjo e interesimit në rritje të grupeve të fuqishme bankare evropiane dhe cilësisë së investimeve vendase.

Ndryshimet në pronësinë e kapitalit të bankave dhe strukturës së aksionerëve të tyre gjatë vitit 2007, u paraqitën:

- Në fillim të muajit qershor 2007, u miratua shitja e 80 për qind të aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Amerikane të Shqipërisë zotëruar nga Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndërmarrjeve, Amerikë tek aksioneri i ri Intesa Sanpaolo S.p.A, Itali.
- Në muajin korrik 2007, iu dha licenca përfundimtare për ushtrimin e veprimtarisë bankare në Republikën e Shqipërisë, Bankës së Parë të Investimit, Albania sh.a. Banka u krijua si rezultat i transformimit nga degë, në filial të Bankës së Parë të Investimit në Bullgari.
- Në të njëjtën periudhë, u miratua shitja e 75.006 për qind e aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Popullore, që i përkiste 32 aksionerëve shqiptarë, tek Banka Societe General, Francë.
- Në muajin gusht u miratua transferimi i pronësisë së 76.129 për qind të aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Italo Shqiptare sh.a., nga aksioneri SanPaolo IMI S.p.A., Itali tek aksioneri Intesa Sanpaolo S.p.A., Itali. Ky transferim konsistoi në bashkimin me përthithje të shoqërisë SanPaolo IMI S.p.A., Itali me shoqërinë Intesa S.p.A., Itali dhe krijimi mbi këtë bazë i shoqërisë Intesa Sanpaolo S.p.A., Itali.
- Mjedesi integrues bankar që shoqëroi shumë banka në Evropë gjatë vitit 2007 përfshiu edhe tregun bankar shqiptar, nëpërmjet integritit të dy bankave të sistemit bankar shqiptar në favor të bankës me përmasa më të mëdha. Si një praktikë që zbatohet për herë të parë në tregun shqiptar, në muajin dhjetor 2007, u dha miratimi i bashkimit me përthithje të Bankës Italo Shqiptare në Bankën Amerikane të Shqipërisë.
- Aksioneri BFSE Holding BV, Holandë kërkoi pjesëmarrjen e tij në Bankën Credins, nëpërmjet blerjes së aksioneve ekzistuese të bankës si edhe nëpërmjet nënshkrimit të aksioneve të reja të bankës, në masën rreth 22.17 për qind të kapitalit aksioner të saj. Miratimi për këtë ndryshim në strukturën e aksionerëve të Bankës Credins u dha, në muajin shkurt 2008.
- ProCredit Holding AG, Gjermani rriti pjesëmarrjen e tij në kapitalin aksioner të Bankës ProCredit, nëpërmjet blerjes së aksioneve që zotëroheshin nga IFC, Amerikë dhe FEFAD, Shqipëri. Pas këtij transaksioni, pjesëmarrja në kapitalin e bankës, e shoqërisë ProCredit Holding AG, Gjermani do të jetë 80 për qind.

Gjatë vitit 2007, bankat vazhduan të shtonin produktet elektronike bankare në shërbim të klientëve të tyre. Tashmë në sistemin bankar shqiptar 11 banka përdorin transaksionet në rrugë elektronike, sipas produkteve në tabelën e mëposhtme.

Ajo që u vu re gjatë këtij viti është shtrirja e shërbimit të *internet banking* edhe në tre banka të tjera të sistemit, ndërkohë që një bankë është në proces për marrjen e këtij miratimi, në përputhje me kërkesat e rregullores “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.

Dëshmi e rritjes së konkurrencës bankare si dhe e rritjes së vëllimit të transaksioneve financiare nëpërmjet bankave, ishte zgjerimi i konsiderueshëm që pësoi rrjeti bankar me degë dhe agjenci të reja. Kështu, numri i degëve dhe i agjencive të hapura gjatë vitit 2007, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë arriti në 103, nga të cilat vetëm 43 janë hapur të reja në rrethin e Tiranës.

Ndërkohë që Banka Amerikane e Shqipërisë gjatë këtij viti shtoi rrjetin e saj bankar jashtë vendit edhe me dy degë të reja në Greqi.

	Degë brenda vendit	Agjenci	Degë jashtë vendit	Gjithsej	Nga këto: në Tiranë	Në proces miratimi
Gjithsej	59	42	2	103	43	23

Tabelë 1. Degë dhe agjenci të reja gjatë vitit 2007.

Në zgjerimin e rrjetit bankar u përfshinë pothuajse të gjitha bankat tregtare.

Nr.	Bankat	Nr. i degëve brenda vendit	Nr. i agjencive	Nr. i degëve jashtë Shqipërisë
1	Banka Raiffeisen	98 ¹		
2	Banka Kombëtare Tregtare	21	20	1
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	3	1	
4	Banka Italo Shqiptare		7	
5	Banka Italiane e Zhvillimit	4		
6	Banka e Tiranës	39	4	
7	Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë	5	19	
8	Banka Ndërkombëtare Tregtare	5		
9	Dega e Bankës Alfa	23	1	
10	Banka Amerikane e Shqipërisë	8	15	4
11	Banka ProCredit	24	1	
12	Dega e Bankës së Parë të Investimeve	1	3	
13	Banka Emporiki	4	7	
14	Banka e Kreditit të Shqipërisë	2	1	
15	Banka Credins	21	4	
16	Banka Popullore	33		
17	Banka Union	12	12	
18	Banka e Parë e Investimeve		3	
	T O T A L I	303	98	5

Tabelë 2. Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2007.

Në vitin 2007 iu dha licenca me nr. 09, datë 06.06.2007 për ushtrimin e veprimtarive si subjekt jobankë, shoqërisë “Partneri Shqiptar në Mikrokredi” sh.a.. Gjatë vitit 2007 është paraqitur kërkesa nga fondi “BESA” për marrjen e licencës si subjekt jobankë.

Subjekti jobankë “Credit Card Services” sh.p.k. (ish-“Diners Club Albania” sh.p.k.) njoftoi, në muajin shkurt 2007 Bankën e Shqipërisë, se pushoi së ekzistuari nëpërmjet likuidimit vullnetar dhe dorëzoi licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Në muajin maj të vitit të kaluar, subjekti jobankë “Credins” sh.a kërkoji shtimin e veprimtarive financiare të tij edhe me një aktivitet shtesë. Kjo kërkesë u miratua nga Banka e Shqipërisë, duke i dhënë shoqërisë “Credins” sh.a të drejtën e kryerjes së shërbimit të qirasë financiare.

Aktualisht, janë të licencuara dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre 6 subjekte jobanka.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9662, datë 28.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” në muajin qershor 2007 dhe të rregullores “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.31, datë 06.06.2007, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.73, datë 27.11.2007, pati një rritje të fluksit të kërkesave të subjekteve për formalizimin e aktivitetit valutor. Vetëm 6-mujorin e dytë të vitit 2007 u paraqitën 58 kërkesa për licencim të zyrave të këmbimit valutor, të cilat u licencuan të gjitha. Gjithashtu, disa zyra këmbimi valutor të licencuara shtuan aktivitetin e tyre nëpërmjet hapjes së zyrave të reja. Në vitin 2007, iu revokua licenca 6 zyrave të këmbimit valutor.

U licencuan 7 shoqëri të reja kursim-kreditit dhe iu revokua licenca 2 shoqërive të tjera. Shoqëritë e kursim - kreditit, të cilave iu është revokuar licenca janë bashkuar mbi bazën e dy shoqërive ekzistuese të kursim-kreditit.

Tabelë 3. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Nr.	Subjektet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	13	14	15	16	17	17	17
2	Subjekte financiare jobanka	2	4	5	7	7	7	6	6
3	Zyra të këmbimit valutor	19	38	58	58	54	58	60	112
4	Shoqëri të kursim-kreditit			113	131	130	131	125	130
5	Unione të shoqërive të kursim kreditit			2	2	2	2	2	2

4.3. ECURIA E SISTEMIT BANKAR

Viti 2007 ka sjellë zhvillime përgjithësisht pozitive dhe të qëndrueshme në sistemin bankar.

Rezultati neto i sistemit bankar për vitin 2007 raportohet rreth 41.8 për qind më shumë ndaj rezultatit neto të vitit 2006. Në raport me PBB, rezultati neto ka rritur dukshëm peshën e tij, duke treguar për një përmirësim të eficiencës së sektorit bankar, krahasimisht me sektorë të tjerë të ekonomisë. Ky raport përlllogaritet rreth 1.1 për qind ndaj rreth 0.8 për qind, që përlllogaritej për vitin 2006 dhe atë 2005.

	Dhjetor '05	Dhjetor '06	Dhjetor '07
Rezultati neto	6.60	7.45	10.6

Tabelë 4. Rezultati neto, miliardë lekë.

Të ardhurat nga aktivitetet kryesore (të ardhura neto nga interesi) rezultojnë 27.3 për qind më shumë se një vit më parë dhe vijojnë të konfirmojnë zhvillime sasiore dhe cilësore në masën dhe strukturën e aktiveve dhe pasiveve. Të dhënat demonstrojnë:

- rritje të konsiderueshme të aktiveve të sistemit, rritje të peshës së aktiveve me rrezik të lartë dhe si rrjedhojë, edhe kthim më të lartë²;
- ndryshimin e dallueshëm të strukturës së maturimit të aktiveve me rrezik të lartë³;
- rritje të peshës së burimeve të veta dhe si rrjedhojë, edhe mundësi më të mira për të gjeneruar burime financimi pa kosto;
- rritje të peshës së portofolit të letrave të tjera me vlerë (përfshirë dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare) që gjenerojnë norma interesi alternative, më të larta sesa bonot e thesarit.

Edhe rezultati neto nga aktivitetet e tjera ka pësuar një rritje të lartë, madje më të lartë sesa rezultati neto nga interesat për rreth 30 për qind. Megjithkëtë, vlerësojmë se varësia e rezultatit të sistemit bankar ndaj rezultatit të aktiviteve kryesore vijon të shfaqë qëndrueshmëri.

Zhvillimet pozitive në treguesin e të ardhurës neto nga interesat, pasqyrohen edhe në dinamikën e treguesit të marzhit neto nga interesat (NIM), i cili ka vazhduar të rritet ndonëse vetëm me 0.1 për qind krahasuar me 0.5 për qind, një vit më parë. Rritja e NIM, shpjegohet me ecurinë në rritje të aktiveve⁴ me rrezik të lartë si dhe me ndryshimin e strukturës së depozitave në favor të atyre në valutë⁵. Kjo, në kushtet kur përgjithësisht normat e interesit në valutë janë më të vogla se në lekë.

Tabelë 5. Marzhi neto nga interesi, në përqindje.

	Dhjetor '05	Dhjetor '06	Dhjetor '07
Të ardhurat nga interesat/ aktivet mesatare që sjellin të ardhura (1)	6.81	7.05	7.72
Shpenzime për interesa/aktivet mesatare që sjellin të ardhura (2)	3.08	2.83	3.37
Marzhi neto nga interesat (NIM)[(1) – (2)]	3.73	4.22	4.35

Performanca e treguesve kryesorë të rentabilitetit, përkatësisht RoAA dhe RoAE, paraqitet e mirë edhe për vitin 2007. Sistemi bankar pasqyron rritje të kthimit nga aktivet mesatare. Ndryshe nga dy periudha më parë, kahu i lëvizjes së RoAA është i njëjtë me kahun e lëvizjes së NIM. Çka tregon për një ndikim më të kontrolluar të shpenzimeve të rritura të veprimtarisë dhe provigjoneve, në përlogaritjen e të ardhurës neto të sistemit bankar. Rritja e RoAA shpjegohet me ritmin më të lartë rritës të rezultatit neto, rreth 41.8 për qind, ndaj aktiveve mesatare, 23.3 për qind.

Treguesit	Dhjetor '05	Dhjetor '06	Dhjetor '07
RoAA	1.40	1.36	1.57
RoAE	22.24	20.17	20.74

Tabelë 6. Treguesit e rentabilitetit, në %.

Dinamika e treguesit të efikasitetit, e matur si raport ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave operacionale⁶, tregon se në harkun kohor të një viti (në terma kumulativë), efikasiteti i sistemit bankar ka treguar përmirësim nga niveli 0.52 në 0.49. Sistemi bankar tregon për një ritëm të lartë të zgjerimit të aktivitetit, si rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve të veprimtarisë me rreth 20.3%. Ndërkohë, vlerësojmë se ritmi më i lartë rritës i shpenzimeve operacionale gjatë vitit 2006, ka shërbyer në rritjen e produktivitetit si edhe konsolidimit përherë e më tepër të sistemit bankar, në vitin 2007.

Gjatë vitit 2007, aktivet e sistemit bankar shënuan rritje me 118.6 miliardë lekë ose 19 për qind më të larta se gjendja e tyre në fund të vitit 2006. Kjo, megjithë zhvillimet pozitive të sistemit bankar në drejtim të shpërndarjes më të mirë të burimeve dhe të aktiveve ndërmjet bankave. Viti 2007 vijon me peshën e konsiderueshme të bankave të mëdha (të agreguara në grupin G3) në totalin e aktiveve të sistemit (përkatësisht me 65 për qind të totalit të aktiveve të sistemit). Kontributin më të madh në rritjen e aktiveve gjatë këtij viti e dhanë bankat e grupit të mesëm, G2⁷, me 52.2 miliardë lekë apo rritje prej 32.3 për qind kundrejt 50.4 miliardë lekëve apo 11.7 për qind, që përlllogaritet për G3. Me gjithë qëndrueshmërinë e veprimtarisë së grupit G3, prirja në rënie e peshës së tij në treg është shenjë e një aktiviteti bankar që tenton të reduktojë përqendrimin.

Tabelë 7. Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë.

	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Indeksi H (aktivet)	0.37	0.32	0.30	0.27	0.21	0.18	0.15
Indeksi H (depozitat)	0.43	0.37	0.35	0.31	0.24	0.20	0.17
Indeksi H (kredia)	0.20	0.17	0.15	0.11	0.10	0.11	0.11

Niveli i përqendrimit për aktivitetin e kredihënies u soll më afër nivelit perfekt të përqendrimit prej rreth 0.06.

Tabelë 8. Totali i aktiveve në miliardë lekë (fondi i periudhës).

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Totali i aktiveve	270.8	318.5	339.3	373.6	426.4	496.6	624.3	742.9
Totali i aktiveve/PBB	50.2	53.5	51.6	50.2	51.9	59.3	69.4	75.9
Totali i kredive/PBB	5.3	4.7	5.9	6.8	8.5	15.3	22.0	29.9

Teprica e kredisë së sistemit bankar, gjatë vitit 2007, shënoi rritje me 94.5 miliardë lekë ose 47.7 për qind më e lartë se teprica e fundvitit 2006. Teprica e kredisë sipas afatit vazhdon të evidentojë zhvendosje graduale drejt kredisë afatgjatë.

Rritja e shpejtë e kredisë është shoqëruar me rritjen e pjesës së portofolit me probleme, i cili ka shënuar rritje me rreth 3.8 miliardë lekë krahasuar me fundvitin 2006. Treguesi i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredive në terma bruto, përlllogaritet 3.4 për qind ndaj 3.1 për qind në fund të vitit 2006. Ndërkohë, treguesi "kredi me probleme / tepricë kredie » (neto), i cili mat madhësinë neto të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë, vazhdon të jetë në nivele të ulëta vetëm 1.8 për qind krahasuar me 1.36 për qind, në fund të vitit 2006.

Në fund të dhjetorit 2007, pesha e kredisë neto me probleme ndaj kapitalit rregullator të sistemit ka arritur në 11.2 për qind, nga 6.8 për qind në fund të dhjetorit 2006. Rritja e këtij treguesi, përgjithësisht, shërben si indikator i kufizimit të aftësisë së sistemit për të mbuluar me kapital rregullator humbjet potenciale nga kredia.

Dhjetor '06	Mars '07	Qershor '06	Shtator '07	Dhjetor '07
6.8	7.4	7.9	8.5	11.2

Tabelë 9. Ecuria e raportit kredia neto me probleme/kapital rregullator (në përqindje).

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin, në fund të vitit 2007 paraqitet në nivelin 17.1 për qind ose 0.9 pikë përqindje më i ulët se në fund të dhjetorit 2006. Ky tregues ka vijuar me prirjen rënëse të shfaqur gjatë viteve të mëparshme. Rënia i atribuohet ritmeve më të larta të rritjes të totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit (25 për qind), kundrejt rritjes së kapitalit rregullator (15.6 për qind). Vlera e këtij treguesi për bankat individuale, në fund dhjetorit 2007 varionte nga 11.3 për qind deri në 106.5 për qind. Ndërkohë që gjatë vitit vlera e tij minimale prej 12 për qind, është shkelur përkohësisht vetëm nga dy banka të sistemit.

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit në %	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Dhjetor 2007	17.1	45.1	15.8	15.5
Dhjetor 2006	18.0	41.3	15.9	16
Dhjetor 2005	18.6	35.0	19.4	14.4
Dhjetor 2004	21.6	47.3	17.8	17.3

Tabelë 10. Mjaftueshmëria e kapitalit.

Gjatë vitit 2007, situata e likuiditetit të sistemit bankar vleresohet të ketë patur një ecuri të kënaqshme. Analiza e treguesve të likuiditetit tregon se aktivet likuide zënë gati gjysmën e totalit të aktiveve dhe shfaqin një prirje në rënie, nga niveli 58 për qind në 50 për qind, apo 63 për qind në fund të vitit 2005. Të marra në shqyrtim sipas grupeve, bankat e grupit G3 edhe gjatë këtij viti shfaqin peshën më të lartë në krahasim me grupet e tjera të aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve, rreth 55 për qind. Në grupet G2 dhe G1 kjo peshë paraqitet në nivele relativisht më të ulta, përkatësisht në 38 për qind dhe 49 për qind. Gjithashtu, vlerat e GAP-eve të likuiditetit janë brenda kufijve të kontrollueshëm. Ndërsa aktivet afatshkurtra mbulojnë pjesën më të madhe të pasiveve afatshkurtra dhe burimet e qëndrueshme në sistem kanë prirje rritjeje.

Në kushtet e një tregu paraje jo shumë aktiv dhe pothuajse mungesës së tregut të kapitaleve, depozitat nga klientët vazhdojnë të mbeten burimi parësor i gjenerimit të fondeve në sistem. Në fund të vitit 2007, pesha e tyre ndaj totalit të detyrimeve të sistemit është rreth 93 për qind ose 2 pikë përqindje më e lartë se në fund të vitit 2006.

4.4. INSPEKTIMET NË VEND

Puna e kryer gjatë vitit 2007 nga mbikëqyrja në vend është ushtruar në funksion të përmbushjes së të drejtave që siguron kuadri ligjor e rregullativ.

Gjatë vitit 2006 janë kryer këto inspektime:

Banka:	14 inspektime të plota
	33 inspektime tematike*
	17 inspektime për regjistrin e kredive
Institucione financiare jobanka:	5 inspektime të plota
Shoqëri të kursim-kreditit:	1 inspektim i plotë
Zyra të këmbimit valutor:	50 inspektime

* këtu përfshihen inspektime për qëllime të mbikëqyrjes si dhe ato në bashkëpunim me autoritete të tjera.

Në përgjithësi, gjendja e sistemit bankar, e vlerësuar nga inspektimet në vend paraqitet e mirë. Disa nga gjetjet e procesit të inspektimit në vend, gjatë vitit 2007 janë:

- Veprimtaria bankare ka vazhduar rritjen e saj edhe gjatë vitit 2007. Kjo rritje është shoqëruar me thellimin e ndërmjetësimit financiar, me zgjerimin e produkteve të ofruara, me zgjerimin e shërbimeve gjeografikisht duke mbuluar pjesë gjithnjë e më të mëdha të territorit të vendit si dhe me zgjerimin e bazës së klientelës, si në vendndodhjet ekzistuese ashtu edhe në zonat e reja. Konstatohet një përpjekje e vazhdueshme e operatorëve bankarë për sigurimin e një baze të gjerë klientele, duke rritur konkurrencën në të gjitha produktet bankare të ofruara. Nuk evidentohen banka me objekt të veçantë të veprimtarisë duke u ruajtur e njëjta specifike aktiviteti.
- Edhe këtë vit tërheq vëmendjen në mënyrë të veçantë aktiviteti kreditues, i cili vazhdon të rritet ndjeshëm në vlerë absolute, ndërkohë që ka pësuar rënie ritmi i rritjes në terma relativë. Aktiviteti kreditues ka vazhduar të mbështesë ekonominë duke rritur peshën e saj specifike ndaj burimeve, totalit të aktiveve si dhe produktit të brendshëm bruto. Ky aktivitet përbën një nga veprimtaritë më të rëndësishme të bankave dhe në mënyrë të vazhdueshme i është kushtuar vëmendje gjatë mbikëqyrjes në vend.
- Zgjerimi i aktivitetit dhe i llojit të produkteve ka sjellë nevojë të brendshme për ndryshim në disa aspekte: në strukturë, në shpërndarje detyrash, në mbështetjen e zhvillimeve me politika e manuale, në mbulimin me personel. Zhvillimi i mëtejshëm i aktivitetit kreditues ka ndikuar edhe në struktura dhe operacione të tjera. Përdorimi në rritje i burimit të fondeve në kredidhënie ka paraqitur nevojën për rishikimin tërësor të natyrës së investimit. Ky fenomen ka patur zhvillime dinamike duke i vënë bankat në pozicion aktiv, me qëllim administrimin e situatave të likuiditetit dhe realizimet e pritshmërisë së aktivitetit.
- Presionet e aksionerëve për maksimizimin e fitimit kanë nxitur bankat për të marrë përsipër më shumë rrezik. Kështu që, përveç kreditimit, janë përdorur gjerësisht shfrytëzimi i mundësisë për fitim nga këmbimet valutore apo edhe nëpërmjet diversifikimit të investimeve në letra me vlerë, krahasuar me zgjedhjet tradicionale për investime në vendosje me kthyeshmëri të ulët.
- Ardhja e bankave të mëdha me prani të zgjeruar ndërkombëtare ka sjellë zhvillime të reja në drejtim të natyrës së administrimit. Marrëdhëniet

me bankat mëmë janë zgjeruar si nga pikëpamja financiare ashtu edhe nga orientimi i operacioneve të bankës. Bankat vendore kanë marrë mbështetje të vazhdueshme në drejtim të respektimit të standardeve më të zhvilluara të veprimtarisë bankare, nëpërmjet trajnimeve si dhe vënies në përdorim të praktikave të ngritura në vendet e origjinës.

Përveç kontrolleve të plota, janë zhvilluar dhe 50 kontrolle të pjeshme. Kontrollat e pjeshme kanë patur si qëllim vlerësimin e shkallës së transparencës së bankave në marrëdhëniet me klientët, përmbushjen e detyrimeve lidhur me luftën kundër financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave, saktësinë e hedhjes së të dhënave në Regjistrin e Kredive dhe marrëdhëniet që kanë bankat me shoqëritë e sigurimit në Shqipëri.

4.5. STABILITETI FINANCIAR

Sistemi financiar në Shqipëri, ka vijuar rritjen e tij të qëndrueshme gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2007. Rezultati mjaft i mirë financiar, si në sektorin bankar ashtu edhe në atë financiar jobankar, ka ardhur si rrjedhojë e përdorimit më të mirë të burimeve financiare dhe vazhdimit të zgjerimit, relativisht të shpejtë të veprimtarive me kthim të lartë nga investimi. Prirja afatgjatë për rënien graduale të treguesit të kapitalizimit të sektorit financiar, veçanërisht të atij bankar, ka vazhduar ndonëse ritmi i rënies është ngadalësuar. Kjo ecuri është përcaktuar nga sjellja më aktive e bankave dhe e institucioneve financiare, treguesit e kapitalizimit të veprimtarisë të cilave gjenden pranë niveleve minimale të kërkuara nga kuadri ligjor dhe rregullativ. Gjatë periudhës, ka vijuar hyrja e kapitalit të huaj në institucionet financiare dhe janë konstatuar veprime të bashkimit institucional, të cilat mbështesin konsolidimin e tregut financiar. Në bazë të analizës së autoriteteve rregullative, nuk evidentohet ndonjë rrezik, i përcjellë nga zhvillimet rajonale e globale ose i brendshëm, i cili ka mundësi të lartë materializimi dhe që mund të dëmtojë në mënyrë të menjëhershme dhe të rëndë veprimtarinë e sistemit financiar. Në këtë kuadër, vlerësohet që spektri i rreziqeve në sistemin financiar po zgjerohet dhe kërkon monitorim të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm të sistemit, të mbështetur me masa rregullative korrektuese në kohën e duhur.

Në tërësi, aktivitetet e sektorit financiar kanë njohur rritje të qëndrueshme. Megjithatë, pjesa e sektorit financiar jobankar nuk ka arritur të rrisë peshën e saj në tregun financiar. Totali i aktiveve të sistemit financiar në fund të vitit 2007, vlerësohet pranë nivelit 78.5 për qind të PBB-së. Sektori bankar përbën rreth 76 për qind të PBB-së, kundrejt 69.4 për qind një vit më parë. Segmenti kryesor i sektorit financiar jobankar përbëhet nga shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit. Sipas vlerësimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në muajin shtator 2007, totali i aktiveve të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit rezultonte në nivelin 12.98 miliardë lekë ose rreth 12 për qind më i lartë në terma vjetorë.

Sektori bankar ka zgjeruar investimet në kredi dhe letra me vlerë, duke ruajtur nivele të kënaqshme të kthyeshmërisë nga veprimtaria, por duke

evidentuar rënie të lehtë të treguesve të kapitalizimit dhe të likuiditetit. Në fund të vitit 2007, portofoli i kredive të sektorit bankar arriti në rreth 40 për qind të totalit të aktiveve të sektorit.

Analiza e rreziqeve të veprimtarisë financiare evidenton rritjen e nivelit të përgjithshëm të rrezikut dhe paraqet nevojën për një monitorim të vazhdueshëm nga vetë institucionet financiare, autoritetet rregullative dhe nga publiku. Banka e Shqipërisë vlerëson që situata e vështirë që po kalojnë tregjet ndërkombëtare financiare, përfaqëson një element të ri rreziku për sistemin financiar shqiptar. Megjithatë, për aq kohë sa ajo nuk shndërrohet në një krizë financiare globale me pasoja në ekonominë reale botërore dhe veçanërisht atë evropiane, do të jetë relativisht e pandjeshme për tregun e brendshëm. Ka disa faktorë që e përcaktojnë një vlerësim të tillë, ku përmendim:

- a) zhvillimin relativisht të ulët të tregut të brendshëm financiar dhe mungesën e produkteve të ngjashme e të sofistikuar, vlera e të cilave u trondit së fundi në tregjet ndërkombëtare financiare. Theksojmë gjithashtu, që kuadri rregullativ mbikëqyrës i veprimtarisë bankare në vendin tonë, nuk parashikon në asnjë rast trajtimin e diferencuar të huamarrësve (dhe të kredive që ata marrin) për shkak të perceptimit si “të mirë” dhe “më pak të mirë”, duke përfshirë ata që kërkojnë ose përfitojnë një hua për blerjen apo zhvillimin e pasurive të paluajtshme. Përkundrazi, kuadri rregullativ mbikëqyrës orienton bankat drejt analizës financiare të huamarrësit, pavarësisht karakteristikave të tij dhe objektit të huasë, duke vendosur disa kërkesa bazë dhe unike, të cilat bankat duhet t’i zbatojnë në çdo rast;
- b) nivelet mjaft të ulëta të nevojës për financim në tregjet financiare ndërkombëtare nga ana e institucioneve financiare shqiptare dhe posaçërisht nga sektori bankar, në kushtet kur ka mjaft hapësirë për të siguruar financimin e zhvillimit të veprimtarisë nga burimet e brendshme. Përsa më e ulët e kredisë ndaj depozitave të sektorit bankar si edhe ndaj PPB-së, në krahasim me vendet e zhvilluara evropiane dhe disa prej vendeve të rajonit, dëshmojnë këtë fakt;
- c) mungesën e një ekspozimi të drejtpërdrejtë të institucioneve financiare shqiptare, dhe posaçërisht të bankave, në institucione të tjera dhe në produkte financiare, vlera e të cilave është ndikuar negativisht nga vështirësitë e likuiditetit në tregjet financiare ndërkombëtare. Nëse një ekspozim i tillë mund të rezultojë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga një kategori e caktuar e portofolit të letrave me vlerë të borxhit në valutë, ndikimi i tij bëhet i parëndësishëm për shkak të peshës së ulët të këtyre investimeve për secilën bankë dhe sektorin bankar në përgjithësi, si edhe gjendjes mjaft të mirë financiare të sektorit bankar;
- d) ekspozimin e kufizuar dhe financiarisht të përballueshëm të grupeve bankare evropiane që veprojnë në Shqipëri, ndaj skemës dhe produkteve të financimit të huave “sub-prime” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të dhënat financiare që janë publikuar nga vetë këto institucione, nga analistë të ndryshëm të tregut, si edhe nga autoritetet mbikëqyrëse të vendit të origjinës, konfirmojnë këtë vlerësim;
- e) performancën e mirë financiare të viteve të fundit të institucioneve

financiare dhe të grupeve bankare evropiane, e cila ka krijuar një mbrojtje të mirë financiare nëpërmjet krijimit të rezervave të nevojshme dhe kapitalizimit të bollshëm të veprimtarisë, për të absorbuar goditje të tilla.

Pavarësisht vlerësimit të mësipërm, ekzistojnë disa elemente, të cilat duhen mbajtur në konsideratë në një analizë më të gjerë të këtij fenomeni, në kushtet e vendit tonë.

Së pari, karakteristikat e rrezikut që mbart në vetvete huadhënia e shpejtë dhe posaçërisht ajo në valutë, e cila mbizotëron financimin nga sektori bankar, ka të ngjarë të ashpërsohen në këtë situatë të paqëndrueshme të tregut financiar ndërkombëtar.

Së dyti, ndjeshmëria dhe sjellja e institucioneve financiare dhe e sektorit bankar ndaj situatave të tilla, do të varet nga ekspozimi i tij i momentit ndaj sektorëve, që ndikohen negativisht nga vështirësitë financiare.

Së treti, duhet mbajtur në konsideratë fakti që vështirësitë që po kalojnë në këtë periudhë tregjet financiare ndërkombëtare, po zhvillohen paralelisht me vështirësitë që dikton dinamika e çmimeve të burimeve energjitike dhe e lëndëve të para të produkteve ushqimore në shkallë botërore.

Së katërti, është e nevojshme që disa vendime të autoriteteve vendimmarrëse publike, me rëndësi për mbarëvajtjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik si edhe për stabilitetin financiar të vendit e të institucioneve financiare, të paraprihen nga një proces i plotë i analizës kosto/përfitim, duke e zbritur analizën në një nivel mikroekonomik dhe sektorial.

Pavarësisht nga sfidat që gjenden përballë autoriteteve publike dhe agjentëve të ndryshëm ekonomikë, Banka e Shqipërisë beson se realizimi i politikave të miratuara si edhe fleksibiliteti i ekonomisë, do të ndikojnë në realizimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme gjatë vitit 2008. Sistemi financiar dhe posaçërisht sektori bankar, do të luajnë një rol aktiv në ndërmjetësimin financiar dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit, duke ruajtur qëndrueshmërinë dhe performancën e mirë financiare.

4.6. KRIJIMI DHE FUNKSIONIMI I REGJISTRIT TË KREDIVE

Gjatë vitit 2007, Banka e Shqipërisë mundësoi realizimin e funksionimit të Regjistrit të Kredive brenda objektivit kohor të përcaktuar, 31 dhjetorit 2007.

Funksionimi i Regjistrit të Kredive përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm të infrastrukturës financiare në Shqipëri. Regjistri i Kredive përbën bazën elektronike të të dhënave për kredimarrësit e sistemit bankar shqiptar. Ai ka për qëllim trajtimin e përqendruar të informacionit dhe të të dhënave, në lidhje me ekspozimin kreditor të çdo kredimarrësi dhe të personave të lidhur me ta. Funksionimi i këtij Regjistri synon rritjen e mundësive për kryerjen e

transaksioneve të shëndosha kredituese, nëpërmjet vënies në dispozicion të informacionit mbi kredimarrësit, duke nxitur eficiencën dhe sigurinë e procesit të kredihënies. Konkretisht, Regjistri i Kredive vë në dispozicion të bankave tregtare, informacionin e nevojshëm për të gjykuar drejt dhe shpejt mbi aftësitë për të shlyer detyrimet financiare dhe mbi besueshmërinë e aplikuesit për kredi. Kështu, zvogëlon kohën e nevojshme të vendimmarrjes për dhënie të kredisë, ndikon në rritjen e cilësisë dhe në uljen e kostove të kredisë.

Zyra e Regjistrimit të Kredive është ngritur brenda Departamentit të Mbikëqyrjes dhe raporton drejtpërdrejt tek Drejtori i Departamentit. Funksionimi i Zyrës së Regjistrimit të Kredive brenda strukturës organizative të Departamentit të Mbikëqyrjes është në mbështetje të realizimit të funksionit mbikëqyrës dhe rregullator të këtij departamenti. Në këtë kontekst, Regjistri i Kredive ofron një instrument shtesë dhe mjaft të dobishëm për të thelluar analizën, jo vetëm në drejtim të vlerësimit të cilësisë së përgjithshme të portofolit të kredisë, por edhe në drejtim të: evidentimit të përqendrimeve të kredisë sipas bankave dhe subjekteve kredimarrëse; vlerësimit të detajuar të ekspozimit të bankave dhe të subjekteve kredimarrëse ndaj financimit sipas monedhave; vlerësimit të detajuar të llojit të kolateraleve dhe të garancive të përdorura; evidentimit të lidhjeve që ekzistojnë midis subjekteve të ndryshme kredimarrëse; evidentimit të personave të lidhur etj..

SHËNIME

¹ Është bërë saktësimi i numrit të degëve dhe agjencive të bankës mbi bazën e informacionit të dërguar nga Banka, në muajin shkurt 2007.

² Pesha e huave në totalin e aktiveve të sistemit u rrit nga 31.5 për qind në fund të vitit 2006, në 39.1 për qind në fund të vitit 2007.

³ Pesha e huave afatgjata u rrit në nivelin 43.6 për qind ndaj 38.4 për qind një vit më parë, ndërkohë që pesha e huave afatshkurtra ka qëndruar pothuaj e pandryshuar. Theksojmë se interesi mesatar i ponderuar për huatë afatgjata përlllogaritet përgjithësisht më i lartë sesa për huatë afatshkurtra.

⁴ Portofoli i kredive pesha e të cilit është rritur nga 31.9 për qind, në 39.1 për qind.

⁵ Pesha e depozitave në valutë është ritur nga 38.7 për qind, në 42.8 për qind.

⁶ Shpenzimet operacionale konsistojnë tek shpenzimet e veprimtarisë, ndërsa të ardhurat operacionale jepen si rezultante e të ardhurave neto nga interesat dhe e të ardhurave neto nga veprimtaritë e tjera.

⁷ Në rritjen e aktiveve të këtij grupi, u përjashtua efekti i kalimit të Bankës Emporiki nga grupi i bankave të vogla (G1) në grupin e bankave të mesme (G2).

KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

5.1. ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

Një sistem pagesash i sigurt dhe eficient është një faktor i rëndësishëm në zbatimin me sukses të politikës monetare, në shlyerjen e transaksioneve në tregjet financiare si dhe në stabilitetin financiar të një vendi.

Banka e Shqipërisë është pronare dhe administratore e dy sistemeve të pagesave në lekë: "Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS" dhe "Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH", tashmë me një historik gati katërvjeçar të operimit të tyre, duke dëshmuar çdo vit e më shumë hapa drejt modernizimit dhe eficiencës së sistemeve.

5.1.1. ECURIA E SISTEMEVE AIPS DHE AECH GJATË VITIT 2007

Numri i transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS, gjatë vitit 2007 është rritur me 17 për qind krahasuar me vitin 2006. Ndërkohë që pagesat e procesuara në sistemin AECH gjatë vitit 2007 pothuajse janë dyfishuar, me një rritje prej 47 për qind krahasuar me vitin 2006. Ky është një tregues i rritjes së besueshmërisë së publikut në përdorimin e sistemit bankar për shlyerjen e detyrimeve të tij financiare. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AIPS janë procesuar rreth 183 transaksione, me një vlerë totale prej 15.1 miliardë lekësh. Ndërsa, në sistemin AECH rreth 290 transaksione, me një vlerë totale ditore prej 48 milionë lekësh. Tabelat në vijim pasqyrojnë numrin dhe vlerën totale të pagesave të procesuara, përkatësisht në sistemet AIPS dhe AECH, gjatë vitit 2007, krahasuar me vitin 2006:

Sistemi AIPS	2006	2007
Numri i transaksioneve	38,793	45,480
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3,376	3,745
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	87.01	82.34
Sistemi AECH	2006	2007
Numri i transaksioneve	48,889	71,857
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	7.77	11.99
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	0.16	0.17

Tabelë 1. Transaksionet sipas sistemeve.

Përveç numrit të transaksioneve të procesuara në sisteme, rritje të rëndësishme ka patur edhe vlera e tyre. Gjatë vitit 2007, rritja në vlerën e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS dhe AECH rezulton të jetë përkatësisht me 11 dhe 56 për qind, krahasuar me vitin 2006. Vlera totale e likuiditeteve të shlyera në sistemet e pagesave gjatë vitit 2007, rezulton të jetë pothuaj sa 4 herë vlera e produktit të brendshëm bruto (PBB) për vitin¹.

Në mënyrë më të detajuar, llojet e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS gjatë vitit 2007 dhe pesha e tyre relative, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 2. Llojet e pagesave.

Lloji i pagesës	Vëllimi		Vlerë (në miliardë lekë)	
	Vlerë absolute	Peshë relative	Vlerë absolute	Peshë relative
Transaksione të BSH	7,467	16.4%	2,166.55	57.9%
Transferim fondesh cash	8,455	18.6%	221.43	5.9%
Pagesa ndërbankare	7,831	17.2%	664.49	17.7%
Pagesa për klientët	16,506	36.3%	134.93	3.6%
Shlyerje në bazë neto	3,224	7.1%	8.99	0.2%
Shlyerje letra me vlerë të qeverisë	1,997	4.4%	548.46	14.6%
Totali	45,480	100%	3,744.85	100%

Krahasuar me të njëjtët zëra të vitit të kaluar, vërejmë se një peshë të konsiderueshme në rritjen e numrit të transaksioneve, zë numri i pagesave për klientët. Përsa i përket vlerës së transaksioneve, rritje e konsiderueshme reflektohet në zërin e transaksioneve të iniciuara nga Banka e Shqipërisë, si edhe në transaksionet ndërbankare. Në ndryshim nga prirja e përgjithshme e pagesave, gjatë vitit 2007 vihet re një rënie, si në numër ashtu edhe në vlerë, e pagesave për shlyerjen e letrave me vlerë të qeverisë.

Vërehet se për periudhën njëvjeçare, në seancën e parë janë kleruar pagesa me një vlerë mesatare më të madhe se në seancën e dytë, ndërkohë që vëllimi më i madh i pagesave është kleruar në seancën e dytë. Nga pikëpamja e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të stabilitetit të sistemeve të pagesave, vlerësohet edhe shkalla e përqendrimit të pagesave në nyje të veçanta të rrjetit. Tregues të përqendrimit për të dy sistemet AIPS dhe AECH, paraqiten si më poshtë:

Tabelë 3. Përqendrimi i pagesave (AIPS).

	Vëllim transaksionesh	Vlerë transaksionesh (miliardë lekë)
Sistemi AIPS	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka ²	33%	30%
5 banka	45%	39%
Totali (vlerë absolute)	45,480	3,745

Tabelë 4. Përqendrimi i pagesave (AECH).

	Vëllim transaksionesh	Vlerë transaksionesh (miliardë lekë)
Sistemi AECH	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka ³	50%	53%
5 banka	66%	65%
Totali (vlerë absolute)	71,587	11,997

Jo pak i rëndësishëm është edhe treguesi i përdorimit të kredive brenda ditës (ILF), gjatë vitit 2007. Theksojmë se kredia brenda ditës, është një kredi e kolateralizuar, me interes zero, që Banka e Shqipërisë i ofron bankave për administrimin e likuiditetit brenda ditës. Procedurat për akordimin e kredive brenda ditës, janë mjaft të thjeshta dhe lëvrimi i fondeve bëhet brenda orës 10.00, në vijim të kërkesës së vetë bankës. Krahasuar me vitin 2006, numri dhe vlera e ILF-ve të lëvruara gjatë vitit 2007 janë rritur përkatësisht me 52 dhe 47 për qind.

	2006	2007
Numri i transaksioneve	444	675
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	146.32	217.51
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	329.55	322.24

Tabelë 5. Kredi brenda ditës (ILF).

Gjatë vitit 2007, vërehet se nga 17 banka pjesëmarrëse në sistemin AIPS, 11 banka kanë përdorur kredinë brenda ditës (3 banka më shumë se gjatë vitit 2006). Nga analiza e përqendrimit të transaksioneve sipas bankave, mund të themi se përsa i përket shpeshhtësisë së lëvrimin të kredive, vetëm 5 banka kanë qenë aktive në përdorimin e këtij instrumenti, për administrimin e likuiditetit brenda ditës. Nga ana tjetër, vlera më e madhe e kredive brenda ditës të akorduara për bankat, rreth 85 për qind e totalit të vlerës, është e përqendruar vetëm në dy banka. Në tërësinë e sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë ofron edhe shërbimin e klerimit dhe shlyerjes në bazë neto, të vlerës së çqeve të procesuara nga bankat. Përdorimi i çekut si instrument pagese në formë letër, ka vazhduar të jetë në rënie edhe gjatë vitit 2007. Rezultatet flasin për 45 për qind më pak çeqe të shlyera dhe 65 për qind më pak vlerë monetare e shlyer, krahasuar me vitin 2006. Arsyeja kryesore pas kësaj është përdorimi gjithnjë e më pak i çekut bankar.

	2006	2007
Numri i çqeve të shlyera	994	544
Vlera e çqeve (miliardë lekë)	3.76	1.33

Tabelë 6. Shlyerja e çqeve në AIPS.

5.1.2. INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE

Instrumentet e pagesave elektronike dhe numri i transaksioneve që kryhen me to, po rriten gjithnjë e më shumë. Grafikisht, në vijim paraqitet ecuria e numrit të kartave në përdorim dhe terminaleve ATM dhe POS, që mundësojnë mbajtësin e kartës të realizojë transaksione me to. Gjatë vitit 2007, vërehet një rritje e konsiderueshme, prej 74 për qind e numrit të kartave në përdorim, kryesisht karta me funksion debiti/cash-i, krahasuar me vitin 2006. Janë shtuar gjithashtu, терминаlet për përdorimin e kartave, kryesisht терминаlet POS (të cilat mundësojnë pagesat e mallrave dhe shërbimeve në pikat e shitjes me pakicë), me një rritje prej 47 për qind krahasuar me numrin e tyre në fund të vitit 2006. Përsa i përket shpërndarjes gjeografike të terminaleve ATM dhe POS të ofruara nga bankat, mund të themi se përqendrimi më i madh i tyre është në rajonin e Tiranës, përkatësisht rreth 78 dhe 59 për qind kundrejt totalit të tyre. Gjithsesi, vlen të përmendet një prirje në rritje e shtrirjes së tyre edhe në qytet e tjera të Shqipërisë.

	2006	2007
Numri i transaksioneve (mijë)	8,053	9,249
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	47.81	59.04
Vlera mesatare e transaksionit (lekë)	5,940	6,390

Tabelë 7. Karta debiti.

Tabelë 8. Karta krediti.

	2006	2007
Numri i transaksioneve (mijë)	176	363
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3.2	5.3
Vlera mesatare e transaksionit (lekë)	18,207	14,635

Nisur nga të dhënat statistikore të raportuara nga vetë bankat, vërehet një rritje në numrin dhe në vlerën e transaksioneve që kryhen me karta bankare, respektivisht prej 17 dhe 26 për qind. Por, kjo rritje nuk rezulton të jetë në të njëjtin ritëm si numri i kartave apo i terminaleve për përdorimin e tyre. Kjo shpjegohet nga fakti se pavarësisht që numri i kartave në përdorim është rritur, kartëmbajtësit nuk kanë besimin e duhur dhe/apo mundësitë për ta përdorur kartën si mjet pagese. Thënë ndryshe, në përpjesëtim me numrin e popullsisë⁴, mesatarisht, një në pesë persona është mbajtës i një karte dhe çdo kartëmbajtës kryen jo më shumë se 16 transaksione në vit. Pra, sistemi bankar është akoma në hapat e parë të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, krahasuar me statistikat e raportuara nga vendet e rajonit.

Prirja pozitive vërehet edhe në lidhje me përdorimin e “Home Banking”, si instrument pagese elektronik. Aktualisht, në Shqipëri janë tre banka që ofrojnë shërbime me këtë instrument pagese. Home Banking” gjatë vitit 2007, krahasuar me vitin 2006 është rritur përkatësisht me 122 për qind në numrin e transaksioneve dhe 188 për qind, në vlerën e transaksioneve të procesuara. Kjo rritje kryesisht është pasojë e shtimit të 2 bankave në ofrimin e këtij shërbimi, gjatë vitit 2007. Në vijim të marrëveshjes me kompaninë VISA, për shlyerjen e transaksioneve të kryera në lekë me karta VISA, Banka e Shqipërisë mundësoi shlyerjen në sistemin AIPS të këtij aktiviteti. Gjatë këtij viti, numri i bankave pjesëmarrëse në shlyerje arriti në 8, nga 5 banka në vitin e kaluar. Kompania VISA, në rolin e shtëpisë së klerimit, përgatit pozicionet neto për secilën bankë dhe i dërgon ato pranë Bankës së Shqipërisë, për shlyerje neto në sistemin AIPS. Në mënyrë tabelare, aktiviteti i shlyerjes neto paraqitet si më poshtë:

Tabelë 9. Shlyerjet VISA.

	2006	2007
Numri i transaksioneve të shlyerjes neto	1,487	2,481
Vlera e transaksioneve (milionë lekë)	299	518

5.2. ZHVILLIME NË FUNKSIONIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Inspektorët e kontrollit, në mbështetje të nenit 54, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të rregullores së Departamentit të Kontrollit, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 04.07.2001 dhe duke u orientuar kah standardet ndërkombëtare të auditit dhe të auditit të brendshëm, kanë audituar administrimin dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë, llogaritë dhe regjistrat, procedurat buxhetore, kontabël dhe kontrollet.

Duke marrë për bazë gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet e dhëna në auditimet e kryera për vitin 2007, japim opinionin tonë se llogaritë dhe regjistrat pasqyrojnë drejt gjendjen financiare dhe janë në përputhje me Manualin Kontabël të Bankës së Shqipërisë, me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”. Pasqyrat financiare janë përgatitur në formën e duhur, nuk përmbajnë mangësi materiale dhe japin një pamje të vërtetë dhe të rregullt të pozicionit financiar të Bankës së Shqipërisë.

Në vitin 2007 u realizua kalimi nga auditimi i njësisë në Bankën e Shqipërisë, në auditimin e funksioneve që ajo kryen dhe të proceseve përbërëse të tyre. Kjo zhvendosje e objektit të auditit ndihmon në vlerësimin më të plotë të rreziqeve dhe kontrolleve të brendshme, të vendosura për reduktimin e tyre në të gjithë rrjedhën e funksionit, pa u kufizuar në auditin vetëm të pjesëve të caktuara të funksionit, që kryhen nga njësi të veçanta.

5.3. ÇËSHTJE TË INTEGRIMIT EVROPIAN DHE BANKA E SHQIPËRISË

Gjatë vitit 2007, vazhdoi procesi i ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) nga vendet anëtare të BE. Në të njëjtën kohë, gjatë këtij viti, vazhdoi zbatimi i Marrëveshjes së Ndërmjetme mbi Tregtinë dhe Çështjet e Lidhura me Tregtinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, e cila hyri në fuqi më 1 dhjetor 2006. Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Bankën e Shqipërisë lidhen me:

- përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE,
- garantimin e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare për bankat dhe institucionet e tjera financiare komunitare,
- liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së si dhe,
- përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (*acquis communautaire*) në këto fusha.

Në linjë me këto angazhime, më 1 qershor 2007, hyri në fuqi ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar në muajin dhjetor 2006. Ky ligj mbështetet në detyrimet që rrjedhin nga MSA dhe Parimet e Bazelit, duke adoptuar pjesën më të madhe të dispozitave të Direktivës 2000/12/EC “Mbi fillimin dhe vazhdimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit”.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë është përfshirë në përditësimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007-2012, i miratuar nga Këshilli i Ministrave më 5 shtator 2007. Angazhimet e Bankës së Shqipërisë në këtë kuadër kanë të bëjnë me:

- ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në vend,
- adoptimin dhe zbatimin e duhur të *acquis*-it në lidhje me lirinë e vendosjes dhe ofrimin e shërbimeve bankare,

- lëvizjen e lirë të kapitalit si dhe,
- funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave.

Në përputhje me këto angazhime Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë hapash rregullativë:

- Në muajin shtator, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi rregulloren “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – (ALPS)” si dhe rregulloren “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – (AECH)”, duke synuar përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit vendas me atë komunitar dhe veçanërisht, me Direktivën 98/26/EC “Mbi finalitetin e shlyerjes në sistemet e pagesave”.
- Gjithashtu në muajin tetor, Këshilli Mbikëqyrës miratoi rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja”, qëllimi i së cilës ishte përcaktimi i instrumenteve që sigurojnë ushtrimin në mënyrë të sigurtë dhe të qëndrueshme, të veprimtarisë të degës së bankës së huaj.

Raporti vjetor për Shqipërinë i Komisionit Evropian, i publikuar më 6 nëntor 2007 analizoi progresin e arritur nga Shqipëria për periudhën 1 tetor 2006 - 30 shtator 2007, në drejtim të përmbushjes së kriterëve të Kopenhagenit.

- Raporti evidentoi/vlerësoi ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në vend.
- Gjithashtu, Komisioni Evropian vlerësoi besueshmërinë e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në mbajtjen e inflacionit brenda objektivit.
- Komisioni Evropian nënvizoi zhvillimet pozitive në sistemin bankar në vend, duke theksuar forcimin e mbikëqyrjes së kujdesshme bankare me qëllim ruajtjen e cilësisë së portofolit të kredisë si dhe vlerësoi kuadrin rregullator të mbikëqyrjes bankare.
- Komisioni vlerësoi miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili hoqi dispozitat që kishin të bënin me trajtimin e ndryshëm të degëve të bankave të huaja nga bankat shqiptare. Komisioni, nënvizoi nevojën për një përafrim të mëtejshëm të këtij ligji me *acquis communautaire*.

Komisioni theksoi nevojën për forcimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes së kujdesshme bankare si dhe për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për mbikëqyrjen e sektorëve të ndryshëm financiarë. Gjithashtu, në këtë raport Komisioni theksoi domosdoshmërinë e ndryshimeve në kuadrin ligjor, në lidhje me liberalizimin e lëvizjes së lirë të kapitalit, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga MSA.

5.3.1. MARRËDHËNIET ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR (FMN)

Kuota e Republikës së Shqipërisë në FMN gjatë vitit 2007 mbeti e pandryshuar, në shumën prej 48.7 milionë sdr⁵ ashtu si edhe votat e saj (737

vota ose 0.03 për qind e shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së). Shqipëria ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën, San Marinon dhe Timorin Lindor. Kjo konstituencë ka një total prej 90.968 votash (4.11 për qind e shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së) dhe kryesohet nga përfaqësuesi italian z. Arrigo Sadun, i cili shërben si drejtor ekzekutiv i konstituencës.

Në datat 11 janar dhe 19 qershor 2007, autoritetet shqiptare të përfaqësuara nga Kryeministri, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Ministri i Financave i paraqitën zyrtarisht FMN-së Letrat e Mirëkuptimit dhe Memorandumet e Politikave Ekonomike dhe Financiare.

Mbi bazën e këtyre dokumenteve si dhe të vlerësimeve të misioneve rishikuese të FMN-së, të cilat e vizituan Shqipërinë në muajt tetor-nëntor 2006 dhe prill-maj 2007, Bordi Ekzekutiv i FMN-së, në datat 2 shkurt dhe 9 korrik 2007, kreu përkatësisht rishikimin e dytë dhe të tretë të ecurisë së Shqipërisë lidhur me zbatimin e marrëveshjes trevjeçare PRGF/EFF, të miratuar në datën 27 janar 2006. Këto rishikime mundësuan disbursimin në total të 4.8 milionë sdr-ve për Shqipërinë gjatë vitit 2007, duke e çuar totalin e shumës së lëvruar që nga miratimi i marrëveshjes, në 9.7 milionë sdr.

Në konkluzionet e tij me rastin e përfundimit të këtyre rishikimeve, Bordi Ekzekutiv u shpreh se performanca makroekonomike e Shqipërisë ka mbetur e fortë, duke pasqyruar angazhimin e fuqishëm të autoriteteve shqiptare në ndjekjen e politikave të drejta makroekonomike. Njëkohësisht, Bordi vuri theksin në sigurimin e zgjidhjeve afatgjata të problemeve në sektorin e energjisë si dhe në përmbushjen e reformave strukturore, me synim ruajtjen e këtyre arritjeve si dhe sigurimin e përafrimit më të shpejtë drejt niveleve të të ardhurave të vendeve në zhvillim.

Gjatë vitit 2007, në kuadër të konsultimeve për vlerësimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja trevjeçare PRGF/EFF, në muajt prill – maj dhe tetor – nëntor, Shqipërinë e kanë vizituar përkatësisht misioni i tretë dhe ai i katërt rishikues të FMN-së.

Shqipëria gjithashtu, i ka paguar FMN-së gjatë vitit 2007 rreth 9.8 milionë sdr në kuadër të shlyerjeve të detyrimeve (pagesa principali, interesa, shpenzime periodike etj.), të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e kaluara PRGF si dhe ajo ekzistuese PRGF/EFF.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka përfaqësuar rregullisht Republikën e Shqipërisë në vendimmarrjen e Bordit të Guvernatorëve, i cili është organi më i lartë i FMN-së. Një vend të rëndësishëm në marrëdhëniet me FMN-në gjatë këtij viti, kanë zënë dhe mbledhjet e pranverës dhe ato vjetore të FMN-së dhe të Bankës Botërore, të organizuara përkatësisht në muajt prill dhe tetor. Në të, delegacioni i Bankës së Shqipërisë, i kryesuar nga Guvernatori, ka zhvilluar takime me përfaqësues të lartë FMN-së, të cilat janë përqendruar në zhvillimet më të fundit makroekonomike si dhe në çështjet që lidhen me stabilitetin monetar dhe atë financiar. Gjatë takimeve janë evidentuar marrëdhëniet shumë

të mira ndërmjet FMN-së dhe autoriteteve shqiptare si dhe është vlerësuar puna e bërë nga Banka e Shqipërisë, në drejtim të kontrollit të inflacionit dhe rritjes së besueshmërisë në publik. Përfaqësuesit e lartë të FMN-së kanë shprehur mirëkuptimin për të vazhduar projektet e ndihmës teknike për Bankën e Shqipërisë, me qëllim përsheptimin e reformave strukturore, përmirësimin e procedurave për administrimin e borxhit të brendshëm si dhe rritjen e eficiencës së tregut financiar dhe atij bankar.

Vizita në Tiranë e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të FMN-së, z. Murilo Portugal në muajin maj, shënoi një zhvillim të rëndësishëm në marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me këtë institucion. Në përfundim të takimit me Guvernatorin, z. Portugal vlerësoi rolin e Bankës së Shqipërisë në drejtim të arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve si dhe mbikëqyrjes së sistemit bankar, ndërsa vlerësoi projektet dhe planet e Bankës së Shqipërisë për përmirësimin e ekspertizës teknike dhe rritjen e transparencës.

Gjatë vitit 2007, Bankën e Shqipërisë e ka vizituar edhe një mision i FMN-së, i cili vlerësoi procedurat e auditimit të brendshëm dhe doli me rekomandime për përmirësimin e këtij funksioni si dhe misioni konsultues për hartimin e buxhetit të vitit 2008.

Banka e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2007 ka vazhduar të përfitojë nga asistenca teknike e FMN-së, në lidhje me trajnimin e personelit të saj. FMN-ja ka ofruar konsulencë rreth përmirësimit të procesit të hartimit të politikës monetare, modelimit dhe parashikimeve ekonomike si dhe rreth ngritjes së Regjistrimit të Kredive.

5.3.2. MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE

Shqipëria u anëtarësua në Grupin e Bankës Botërore në muajin tetor të vitit 1991 dhe ka përfituar nga ky institucion një total fondesh, që arrin deri në rreth 925 milionë dollarë për 64 projekte.

Edhe gjatë vitit 2007, bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Grupin e Bankës Botërore vazhdoi në kuadrin e marrëveshjes "Për Administrim dhe Konsulencë të Investimit të Rezervës Valutore", të nënshkruar në muajin shtator 2005. Kështu, Grupi i Bankës Botërore i ka ofruar asistencë teknike Bankës së Shqipërisë nëpërmjet programit RAMP (Programi Këshillues për Administrimin e Rezervës Valutore) në kuadër të Partneriteteve për Investimet Sovrane (SPI). Kjo konsulencë dhe asistencë teknike është konkretizuar nëpërmjet vizitave në vend të ekspertëve të Thesarit të Bankës Botërore si dhe pjesëmarrjes së punonjësve të Bankës së Shqipërisë në seminare të organizuara nga Banka Botërore jashtë vendit. Bashkëpunimi teknik në kuadër të programit RAMP është përqendruar në hartimin e një baze të re rregullatore si dhe në adresimin e disa çështjeve teknike në lidhje me administrimin e rezervës valutore.

Në kuadër të këtij projekti, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, Banka Botërore organizoi në Tiranë, në muajin tetor, forumin rajonal me temë

“Tendencat e menaxhimit të rezervës valutore”. Në të morë pjesë titullarë dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga bankat qendrore të rajonit. Prezantimet dhe diskutimet gjatë forumit u përqendruan në mënyrën e administrimit të rezervës valutore nga bankat qendrore, në prirjet e fundit si dhe në ndikimin e rritjes së rezervave në procesin e shpërndarjes së mjeteve strategjike.

Në takimet e zhvilluara nga ana e delegacionit të Bankës së Shqipërisë me përfaqësuesit e lartë të Grupit të Bankës Botërore, në kuadër mbledhjeve të pranverës dhe vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore janë prezantuar zhvillimet makroekonomike në Shqipëri si dhe masat e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik nga trysnitë inflacioniste. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Bankës Botërore, kanë shprehur mbështetjen për hapat e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë si dhe kanë ofruar asistencë në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës financiare, me theks të veçantë në zhvillimin e institucioneve të mikrofinancës dhe shoqërive të kursim-kreditit.

Më 29 mars 2007, Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore miratoi huanë prej 10 milionë usd për politikën e zhvillimit. Kjo është huaja e parë në serinë e tre politikave të zhvillimit, të hartuara për të mbështetur Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritit të hartuar nga Qeveria Shqiptare. Kjo synon shtimin e normës së rritjes ekonomike, përmirësimin e shërbimeve publike në sektorët socialë si dhe përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e llogaridhënies.

5.3.3. MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2007 ka vijuar të mbajë kontakte të vazhdueshme me BERZH-in, kryesisht në drejtim të ofrimit të informacionit dhe statistikave për zhvillimet në ekonominë shqiptare në përgjithësi, dhe për sektorin financiar në veçanti. Në Raportin e Tranzicionit 2007, BERZH-i vlerësoi pozitivisht kuadrin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në lidhje me mbajtjen e inflacionit brenda objektivave si dhe forcimin e mbikëqyrjes bankare nëpërmjet miratimit të ligjit të ri “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe marrjes së masave për reduktimin e rritjes së shpejtë të kredidhënies.

Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë ka vazhduar mbajtjen e marrëdhënieve të ngushta me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS), gjatë vitit 2007. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka marrë pjesë në Mbledhjen e 77-të Vjetore të BIS-it, të zhvilluar në muajin qershor në Bazel të Zvicrës. Në takimet e zhvilluara me përfaqësues të këtij institucioni dhe të bankave të tjera anëtare, ka theksuar rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit teknik ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave të tjera qendrore në fushat e interesit të përbashkët. BIS-i ka qenë veçanërisht aktiv në ofrimin e asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga Instituti i Stabilitetit Financiar. Ky institut, promovon stabilitetin financiar ndërkombëtar përmes shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes së sistemit financiar.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë është përfaqësuar gjatë vitit 2007 në takimin e koordinatorëve të bashkëpunimit teknik dhe trajnimit të vendeve të G10, Austrisë, FMN-së, Bankës Qendrore Evropiane, vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe vendeve të Bashkësisë së Shteteve të Pavarura, të organizuar nga ana e BIS-it. Në këtë takim, janë diskutuar çështje të ndryshme lidhur fushat e bashkëpunimit si dhe rreth mundësisë së rritjes së përfitimit të Bankës së Shqipërisë nga asistenca teknike, e ofruar nga bankat qendrore pjesëmarrëse.

5.3.4. MARRËDHËNIET ME BANKAT QENDRORE DHE BASHKËPUNIMI TEKNIK

Në vijim të intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe me bankat e tjera qendrore, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka zhvilluar gjatë vitit 2007 vizita zyrtare pranë Bankës së Francës, Bankës Kombëtare të Belgjikës, Bankës Qendrore të Luksemburgut, Bankës së Anglisë dhe Bankës Popullore të Kinës ku është takuar me homologët e tij. Ndërsa, gjatë vizitës zyrtare në Bankën Kombëtare të Kroacisë, Guvernatori është takuar me Zëvendësguvernatorin e këtij institucioni. Në të njëjtën kohë, në muajin maj, Bankën e Shqipërisë e kanë vizituar Guvernatori i Bankës Kombëtare të Bullgarisë dhe Zëvendësguvernatori i Bankës së Suedisë. Të gjitha këto vizita kanë shërbyer për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit teknik gjithnjë e në rritje ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe këtyre institucioneve.

Në planin rajonal, vlen të theksohet pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë në takimin XVII dhe XVIII të Klubit të Guvernatorëve të Detit të Zi, Azisë Qendrore dhe Ballkanit të zhvilluar në Serbi dhe Malin e Zi, përkatësisht në muajt maj dhe shtator. Gjatë vitit 2007, Guvernatori ishte Zëvendëskryetar i Klubit, funksion të cilin do ta kryejë edhe gjatë vitit 2008. Në maj të këtij viti do të organizohet në Tirane mbledhja e radhës së këtij Klubi.

Gjithashtu në muajin korrik, me nismën e Bankës së Greqisë, guvernatorët dhe kryetarët e autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve të rajonit zhvilluan një takim në Athinë, me qëllim miratimin e një kuadri të ri të bashkëpunimit rajonal në fushën e mbikëqyrjes bankare. Gjithashtu, u nënshkrua edhe një memorandum bashkëpunimi shumëpalësh, i cili përcakton fushat dhe termat e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrjes bankare në Evropën Juglindore, në pajtim edhe me regjimet ekzistuese mbikëqyrëse dhe rregullatore në çdo vend.

Në muajin nëntor, Banka e Shqipërisë organizoi takimin rajonal rreth kërkimeve ekonomike, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave qendrore të rajonit. Aktiviteti kishte për qëllim inkurajimin e bashkëpunimit dhe të dialogut ndërmjet studiuesve dhe specialistëve të fushës kërkimore ekonomike të departamenteve përkatëse të bankave qendrore të Evropës Juglindore; nxitjen e frymës së debatit rreth çështjeve ekonomike të rëndësishme që ndikojnë në procesin e vendimmarrjes në këto vende; shkëmbimin e përvojave në fushën e studimeve empirike si dhe forcimin e etikës dhe të standardeve në fushën e kërkimeve.

Në të njëjtën kohë, titullarë dhe ekspertë nga Banka Qendrore Evropiane, disa banka qendrore anëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, Komisioni Evropian, BERZH, BIS si dhe nga bankat qendrore të rajonit morën pjesë në Konferencën VII Vjetore të Bankës së Shqipërisë me temë “Strategjitë e Politikës Monetare për Ekonomitë e Vogla”, e zhvilluar në muajin dhjetor. Në të u prezantuan çështje që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e politikës monetare si dhe u vlerësua progresi i bërë nga ana e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2007, në lidhje me përgatitjet për adoptimin e regjimit të ri të politikës monetare në të ardhmen.

Gjatë vitit 2007, Banka e Francës, Banka Kombëtare e Austrisë dhe Banka e Italisë kanë qenë ofrueset më të mëdha të asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë, kryesisht nëpërmjet organizimit të kurseve e seminareve si dhe të vizitave studimore afatshkurtra në fusha të specializuara. Ndërkohë që Banka e Shqipërisë ka përfituar asistencë teknike edhe nga bankat qendrore të Gjermanisë, Anglisë, SHBA-së, Greqisë, Turqisë si dhe nga Banka Qendrore Evropiane. Janë intensifikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit teknik edhe me bankat qendrore të Polonisë, Republikës Çeke, Bullgarisë dhe Rumanisë, si vende të anëtarësuar vitet e fundit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore. Fillimi i bashkëpunimit teknik afatgjatë me Bankën e Suedisë, në fushat e hartimit dhe të zbatimit të politikës monetare, operacioneve monetare dhe stabilitetit financiar, përbën një tjetër zhvillim të rëndësishëm të vitit 2007.

Një zhvillim i ri gjatë vitit 2007, në lidhje me bashkëpunimin teknik është ofrimi i ekspertizës teknike për Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës (AQBK) nga ana e Bankës së Shqipërisë. Kështu, në gjysmën e dytë të vitit 2007, janë realizuar disa vizita pune të delegacioneve të AQBK-së pranë Bankës së Shqipërisë, të përqendruara në fusha si kontrolli i brendshëm, standardet e kontabilitetit, operacionet monetare dhe veprimet e Zyrës Back-Office, sistemet e pagesave, politikat e burimeve njerëzore dhe shërbimi ligjor.

Korpusi i Vullnetarëve të Shërbimeve Financiare (FSVC) ka vijuar të ofrojë asistencë teknike për Bankën e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2007, me një theks në prezantimin e instrumenteve derivative, likuidimin e bankave si dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

5.4. EDUKIMI EKONOMIK DHE FINANCIAR I PUBLIKUT

5.4.1. BANKA E SHQIPËRISË DHE EDUKIMI

Bankat qendrore moderne në të gjithë botën i kushtojnë një rëndësi të veçantë dhe burime të konsiderueshme njerëzore dhe financiare edukimit ekonomik dhe kulturës financiare të publikut të gjerë. Kjo, sepse njohuritë ekonomike dhe financiare po bëhen përditë e më të rëndësishme. Një kulturë e tillë ndihmon konsumatorët, prodhuesit dhe investuesit të marrin vendime të goditura financiare dhe Bankën Qendrore të arrijë më lehtë objektivin e saj.

Edukimi i publikut është parë nga Banka e Shqipërisë si një mundësi më shumë për të siguruar një ambient të përshtatshëm të zhvillimit të veprimtarisë së saj; si një domosdoshmëri për krijimin e bazës për zhvillimin e një komunikimi interaktiv me të; si një mjet i pazëvendësueshëm në funksion të rritjes së reputacionit dhe besueshmërisë së saj nga publiku dhe si një mënyrë efikase e rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë, që ajo synon të transmetojë në publik.

Për arsye të shumta, që lidhen kryesisht me të kaluarën e vendit, publiku i gjerë është pak i ambientuar me çështjet e natyrës ekonomike dhe financiare. Por, nëse dhënia e informacionit ekonomik shoqërohet edhe me instrumentet e nevojshme për ta deshifruar atë dhe gjuha e tij është e thjeshtë dhe e kuptueshme, gjykimi mbi politikat dhe vendimet ekonomike do të bëhet më racional, duke disiplinuar sjelljen ekonomike të publikut dhe duke e orientuar drejt atë.

Në fund të fundit, kjo i shërben edhe Bankës së Shqipërisë për të ndërtuar dhe vënë në funksionim efikas mekanizmat e përcimit në ekonomi të vendimeve të saj. Nëse askush nuk kupton pse merret një vendim i politikës monetare, asnjë vendim nuk e ka të sigurt suksesin e tij dhe sinjalet që merr banka qendrore nga mjedisi ekonomik shtrembërohen, duke vështirësuar marrjen e vendimeve të tjera.

Këto janë disa nga arsyet kryesore që e kanë shtyrë Bankën e Shqipërisë t'i përkushtohet çështjeve të edukimit të publikut dhe të ndërmarrë disa nisma konkrete, në këtë drejtim.

Në datën 13 dhjetor 2007, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në fushën e edukimit të publikut mbi çështje të ekonomisë në përgjithësi dhe të Bankës Qendrore, në veçanti. Objekti i këtij memorandumi është përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit midis dy institucioneve, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit reciprok në fushën e edukimit të nxënësve dhe studentëve në fushat e ekonomisë, financës dhe bankës.

5.4.2. PROGRAME EDUKIMI

Në muajin tetor 2007, Banka e Shqipërisë lançoi programin e edukimit ekonomik – financiar “Banka qendrore në jetën e përditshme” si një program gjithëpërfshirës. Dedicuar fillimisht nxënësve dhe mësuesve të shkollave të mesme, ky program është zhvilluar më tej duke synuar të prekë edhe studentët e universiteteve të vendit.

Qëllimi i parë i tij është ta prezantojë grupin e përzgjedhur me Bankën e Shqipërisë, si një institucion unik në jetën ekonomike të vendit. Megjithatë, për t'i dhënë përmasa më të mëdha dhe për t'iu përshtatur më mirë interesave të tyre, ai synon të pasurojë dhe përmirësojë më tej kulturën dhe njohuritë e përgjithshme të kësaj audience në fushat e ekonomisë, financës dhe bankingut.

Në kuadër të zbatimit të këtij programi, gjatë vitit 2007, janë organizuar aktivitete të shumta dhe të shumëllojshme, në varësi dhe të grupmoshave të cilave u drejtohen. Këto aktivitete kanë konsistuar në seminare trajnuese, takime e leksione si dhe në broshura edukative të shkruara enkas për grupmoshat e ndryshme.

Për nxënësit dhe mësuesit e shkollave të mesme, programi “Banka qendrore në jetën e përditshme” është ideuar mbi tre aktivitete të shtrira gjatë gjithë harkut të vitit mësimor:

1. katër seminare trajnimi dyditore për mësuesit e lëndës së ekonomisë së zbatuar;
2. një konkurs mbi njohuritë e nxënësve të shkollave të mesme mbi bankën qendrore edhe politikën e saj monetare, të emërtuar “Vlera e vërtetë e parasë”;
3. si edhe përgatitje e shpërndarje e broshurave edukative për nxënësit e shkollave të mesme në vazhdimësi, shoqëruar me biseda të drejtpërdrejta me nxënësit në ambientet e shkollave.

Programi “Banka qendrore në jetën e përditshme” u parapri nga një program pilot, i zhvilluar në muajt maj – qershor 2007. Gjatë kësaj faze, u organizua një seminar njëjavor për mësuesit e lëndës së ekonomisë; takime dhe biseda me nxënësit e tre shkollave të mesme të kryeqytetit; si dhe një shpërndarje masive e broshurave edukative të Bankës së Shqipërisë në të gjitha shkollat publike dhe private të Tiranës. Nga përgjigjet e përfuara prej pyetësorëve të shpërndarë për pjesëmarrësit në këto aktivitete, u vu re se nxënësit dhe mësuesit e vlerësuan si të dobishme këtë nismë të Bankës së Shqipërisë, si edhe u morën komente të rëndësishme për përshtatjen e programit të ardhshëm me nevojën dhe interesat e tyre.

Gjatë vitit 2007, në kuadër të programit “Banka qendrore në jetën e përditshme”, Banka e Shqipërisë ka vizituar 12 shkolla të mesme të Tiranës ku ka diskutuar me nxënësit e viteve të treta mbi argumente që lidhen me bankën qendrore, rolin e saj në sistemin bankar dhe në ekonomi, produktet bankare kryesore, si dhe mbi buxhetin personal dhe administrimin e financave personale. Gjithashtu, për këta nxënës janë shpërndarë edhe mbi 17.000 broshura me karakter edukativ me tema nga më të ndryshmet.

5.4.3. SEMINARE DHE TRAJNIME

5.4.3.1. Programi i seminareve për gazetarët

Duke qenë të vetëdijshëm se në kohët e sotme, mënyra se si përçohet informacioni është po aq e rëndësishme sa dhe vetë përmbajtja e tij, edhe cikli i seminareve për vitin 2007 kishte për qëllim të ndihmonte në përçimin e drejtë të informacionit, nga Banka e Shqipërisë te publiku, nëpërmjet mediave.

Cikli i katërt i seminareve të konceptuar nga Banka e Shqipërisë për gazetarët ekonomikë të medias së shkruar dhe asaj elektronike, që u zhvillua nga muaji shtator deri në muajin dhjetor të vitit 2007, trajtoi kryesisht tematika të lidhura me aktivitetin e brendshëm të bankës qendrore dhe me sistemin bankar në Shqipëri, si dhe ftoi gazetarët të luanin një rol aktiv, me pyetje dhe komente mbi temat e trajtuara apo dhe çështjet e momentit.

5.4.3.2. Programi i seminareve për mësuesit e lëndës së ekonomisë

Në datat 25-29 qershor 2007, u organizua për herë të parë për mësuesit e lëndës së ekonomisë së zbatuar, seminari me temë “Roli i Bankës së Shqipërisë në ekonomi”. Seminari u ndoq me interes nga rreth 40 mësues të shkollave të mesme të kryeqytetit dhe trajtoi tematika të ndryshme nga fushat e financës, ekonomisë dhe bankingut.

Duke u nisur nga formati i seminarit të parë dhe mbështetur edhe në sugjerimet e mbledhura me anë të pyetësorëve të shpërndarë për mësuesit e pranishëm në të, u ndërtua cikli i seminareve për vitin shkollor 2007-2008. Ky aktivitet, pjesë e programit edukativ “Banka qendrore në jetën e përditshme”, është menduar të zhvillohet katër herë në vit me seanca dyditore. Në këtë kuadër, në datat 30-31 tetor dhe 13-14 dhjetor 2007, janë zhvilluar dy seminare trajnuese për mësuesit e lëndës së ekonomisë së zbatuar në shkollat e mesme.

Nëpërmjet diskutimeve mbi aktivitetin dhe rolin e Bankës së Shqipërisë në sistemin bankar dhe në ekonomi, ky cikël seminaresh synon të ndihmojë mësuesit të kuptojnë më mirë dinamikat e ekonomisë së tregut, sistemin bankar si dhe t’i qartësojë ata lidhur me pyetje apo çështje të ndryshme që mund të kenë hasur gjatë mësimit. Këto seminare përbëjnë një mundësi shumë të mirë, jo vetëm për formimin e tyre profesional, por edhe për edukimin ekonomik – financiar të brezit të ri.

5.5. NDRYSHIME TË BËRA NË LEGJISLACIONIN BANKAR GJATË VITIT 2007

5.5.1. NDRYSHIMI I KUADRIT RREGULLATIV ME HYRJEN NË FUQI TË LIGJIT “PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në 1 qershor 2007 hyri në fuqi ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili paraqet fazën e parë të përfarimit të legjislacionit shqiptar me *Acquis Communautaire* në përputhje me angazhimet e ndërmarra në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Ligji parashikon parime dhe rregulla më të qarta për administrimin e rreziqeve me të cilat mund të përballen bankat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duke synuar mbrojtjen e depozituesve, të investitorëve si dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar. Detajet teknike për administrimin e këtyre

rreziqeve në ligj, parashikohet të përcaktohen me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2007, Banka e Shqipërisë nisi procesin e rishikimit të kuadrit rregullator (akteve nënligjore) ekzistues në fushën e mbikëqyrjes, me qëllim përshtatjen e tij me kërkesat e ligjit të ri. Rishikimi i këtyre akteve nënligjore synon edhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit bankar me *Acquis Communautaire* në këtë fushë, në lidhje me adoptimin e instrumenteve teknike për një mbikëqyrje të kujdesshme të veprimtarive bankare dhe financiare, të subjekteve bankare dhe jobankare, të cilat kryejnë këto veprimtari.

Gjithashtu, në zbatim të këtij ligji për sa i përket ndalimit dhe penalizimit të ushtrimit të veprimtarisë financiare të këmbimit valutor në mënyrë të paligjshme, në bashkërendim me masat e ndërmarra për reduktimin e informalitetit në ekonomi, Banka e Shqipërisë rishikoi aktet nënligjore në lidhje me krijimin, licencimin e zyrave të këmbimit valutor dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre.

Ndryshimet konsistuan në vendosjen e kërkesave më lehtësuese për krijimin dhe licencimin e këtyre zyrave, çfarë ka rezultuar me rritjen në nivele të larta të kërkesave për licencim të zyrave të këmbimit valutor. Kjo masë, mundëson edhe mbikëqyrjen më efikase të veprimtarisë së këmbimit valutor si dhe zbatimin e politikës së këmbimit valutor nga Banka e Shqipërisë, mbi bazën e të dhënave më të plota të tregut, të marra nëpërmjet raportimeve periodike të zyrave të këmbimit valutor.

5.6. PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATIV

Në kuadrin e masave për reduktimin e parasë fizike në ekonominë shqiptare, Banka e Shqipërisë në përpjekjen për arritjen e objektivave të saj që lidhen me nxitjen dhe zhvillimin e sistemit të pagesave, ka ndërmarrë disa masa rregullative, me qëllim modernizimin e sistemeve të pagesave dhe të instrumenteve të pagesave në Republikën e Shqipërisë.

5.6.1. SISTEMET ELEKTRONIKE TË PAGESAVE

Hyrja në fuqi e ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili sanksionon në përputhje me *Acquis Communautaire* edhe parime dhe rregulla të funksionimit të sistemeve elektronike të pagesave, solli disa standarde të përmirësuara në këtë fushë.

Për implementimin në praktikë të këtyre standardeve, gjatë vitit 2007 u rishikua i gjithë kuadri rregullativ i organizimit dhe funksionimit të sistemeve elektronike për shlyerjen dhe klerimin e pagesave, duke harmonizuar këtë pjesë të legjislacionit shqiptar me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian. Ky harmonizim, siguron një kuadër rregullativ të përshtatshëm për funksionimin

normal të këtyre sistemeve si dhe forcon masat mbrojtëse të interesave të pjesëmarrësve në këto sisteme.

5.6.2. INSTRUMENTET E PAGESAVE ME AKSES NË DISTANCË DHE PARAJA ELEKTRONIKE

Në bashkërendim me masat e vendosura për kanalizimin e pagesave dhe shlyerjes së detyrimeve nëpërmjet sistemit bankar, Banka e Shqipërisë gjatë këtij viti rishikoi në bashkëpunim me aktorët e këtij sistemi edhe kuadrin rregullativ, në lidhje me ofrimin nga subjektet bankare të shërbimeve të pagesave elektronike.


Rregullat e rinj të vendosur në këtë fushë sjellin një shkallë më të lartë të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *Acquis Communautaire*. Ata synojnë modernizimin e pagesave elektronike me akses në distancë, duke përcaktuar qartë llojet e instrumenteve ekzistuese të pagesave në distancë si dhe duke sjellë si risi përcaktimin e llojeve, kushteve dhe rregullave të përdorimit të instrumenteve të parasë elektronike.

Duke marrë në konsideratë vetë specifikën dhe kompleksitetin e këtyre shërbimeve, ndryshimet e këtyre rregullave u fokusuan në vendosjen e kushteve dhe kritereve të domosdoshme për transparencën ndaj klientit - përdorues të këtyre instrumenteve në lidhje me mënyrën e përdorimit, detyrimet e të drejtat e tyre si dhe për mbrojtjen e interesave të tyre.

5.7. EMISIONI I PARASË

Monedha në qarkullim në fund të vitit 2007 arriti vlerën 161.161.883 mijë lekë, kundrejt 168.234.883 mijë lekë në fund të vitit 2006. Struktura e kartëmonedhës në qarkullim u karakterizua nga një rritje e peshës së prerjeve të mëdha 1.000 dhe 5.000 Lekë. Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga kërkesat e bankave të nivelit të dytë për përdorim në bankomate. Gjithashtu, struktura e monedhës metalike u karakterizua nga një rritje e peshës së prerjeve të mëdha 50 dhe 100 Lekë. Një nga faktorët kryesorë që ndikoi në këtë rritje ishte përdorimi i këtyre monedhave në zëvendësimin gradual të kartëmonedhës 100 Lekë.

Në fund të vitit 2007, raporti i vlerës së kartëmonedhave ndaj vlerës së monedhave metalike rezultoi në rritje. Koeficienti i kthimit të parasë në Bankën e Shqipërisë në vitin 2007, rezultoi 0.75 kundrejt 0.70, në vitin 2006. Kështu, nevoja për para në qarkullim është pakësuar. Vlera e monedhës së dalë nga Banka e Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë ishte rreth 22 për qind më pak se në vitin 2006. Ndërsa vlera e monedhës së kthyer nga bankat e nivelit të dytë rezulton afërsisht në të njëjtin nivel, kundrejt një viti më parë.



5.7.1. PËRPUNIMI I MONEDHËS DHE CILËSIA E SAJ

Numri i kartëmonedhave dhe monedhave metalike të përpunuara nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2007 ishte rreth 1.5 për qind më i lartë se një vit më parë. Në zbatim të standardeve aktuale dhe si pasojë e shtimit të shpejtë të numrit të bankomateve të bankave të nivelit të dytë, gjatë vitit 2007, Banka e Shqipërisë tërhoqi nga qarkullimi rreth 25.8 milionë copë kartëmonedha të papërshtatshme për përdorim, duke i zëvendësuar ato me kartëmonedha të tjera. Kjo ka mundësuar përmirësimin e cilësisë së kartëmonedhës në qarkullim. Gjithashtu, zbatimi i projektit të shtypjes së kartëmonedhës së re me vlerë 2.000 Lekë dhe të rishtypjes së kartëmonedhave 5.000 Lekë, 1.000 Lekë, 500 Lekë dhe 200 Lekë të serisë aktuale në qarkullim, pritet të përmirësojë cilësinë e parasë në qarkullim.

SHËNIME

¹ Burimi: Country Report IMF – Shkurt 2008.

² Bankat që kanë peshën më të madhe të pagesave në numër dhe vlerë, nga 17 bankat pjesëmarrëse në sistemin AIPS.

³ Bankat që kanë peshën më të madhe të pagesave në numër dhe vlerë, nga 15 bankat pjesëmarrëse në sistemin AECH.

⁴ Instat – Numri i popullsisë, Janar 2005.

⁵ Në datën 31 dhjetor 2007 (referuar faqes zyrtare të FMN-së), kursi zyrtar i sdr-ve me dollarin amerikan dhe euron ishte: 1 sdr = 1.580250 usd, 1 sdr = 1.073460 euro.

KAPITULLI VI. RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2007



Deloitte Albania sh.p.k
Rr. Murat Toptani
Eurocol Center, Kati i 8-të
Tirana, Albania
Tel: +355 (0) 4 277 920
Fax: +355 (0) 4 277 990
www.deloitte.com/al

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Bankës së Shqipërisë ("Banka"), që përfshijnë bilancin në 31 dhjetor 2007, si dhe pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, të ndryshimeve në kapitalin e vet dhe të rezervave dhe të rrjedhjes së parasë për vitin ushtrimor të mbyllur, dhe një përmbledhje të politikave kontabël kryesore, dhe shënime të tjera shpjeguese.

PËRGJEGJËSIA E DREJTIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi i Bankës është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, të paraqitura në Shënimin 2 të pasqyrave financiare. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme me rrethanat.

PËRGJEGJËSIA E AUDITORËVE

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin procedura për të marrë prova auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësi. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e

shprehjes së një opinioni mbi efektetivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

OPINIONI

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkëngjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2007, dhe rezultatin e aktivitetit të saj, ndryshimeve në kapital dhe rrjedhjes së parasë për fundin e vitit, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, të paraqitura në Shënimin 2, të pasqyrave financiare.

THEKSIM I ÇËSHTJES

1. Siç paraqitet në pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit dhe në shënimet 10, 19 dhe 37/1 të pasqyrave financiare në 31 dhjetor 2007, totali i kapitalit të paguar dhe detyrimeve të Bankës tejkalon vlerën e mjeteve në një shumë prej 1,210 milionë lekë, (2006: 740 milionë lekë) dhe Banka ka derdhur në buxhetin e shtetit gjatë vitit që mbyllet më 31 dhjetor 2007 një shumë prej 5,010 milionë lekë, (2006: 4,664 milionë), bazuar në një marrëveshje të nënshkruar në datë 26 mars 2003 me Ministrinë e Financave. Referuar ligjit nr. 8269, neni 11 asnjë transferim, shlyerje ose pagesë sipas neneve 8, 9 e 10 të këtij ligji, nuk duhet të kryhet në qoftë se mjetet e Bankës do të jenë më pak se shuma e detyrimeve të saj dhe e kapitalit të paguar. Në këto kushte, referuar ligjit 8269, neni 7, Ministria e Financave do të duhet t'i transferojë Bankës, letra me vlerë shtetërore të tregtueshme, duke zbatuar përqindjet e interesit të tregut, në atë vlerë, të mjaftueshme për të kompensuar këtë pamjaftueshmëri mjeteve.

2. Në vitet e kaluara Republika e Shqipërisë është anëtarësuar me kuotizacione në një sërë institucionesh financiare ndërkombëtare, përfshirë këtu Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit, Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe, Korporata Ndërkombëtare Financiare, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Islamike e Zhvillimit. Shuma e kuotizacioneve të paguara të Republikës së Shqipërisë ka një vlerë prej Lekë 991 milionë dhe kuotizacione të kërkueshme në shumën prej Lekë 8,001 milion, pjesë e të cilave siç detajohet në Shënimin 7 "Aktive të tjera në monedhë të huaj", janë paguar nga Banka në shumën prej 498 milion Lekë (2006: 522 Lekë) me qëllim që të mbështesë Republikën e Shqipërisë, por nuk ka njohur detyrime shtesë për pjesën e kuotizacioneve të kërkueshme.

Banka e Shqipërisë dhe Republika e Shqipërisë janë në proces të negocimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit për ndarjen e kontributit origjinal dhe pronësinë e kuotizacioneve tek Institucionet Financiare Ndërkombëtare mes palëve. Ndikimi i marrëveshjes finale mbi pasqyrat financiare të bashkëngjitura, nuk është e mundur të përcaktohet deri në datën e këtij raporti.

Tirana, Shqipëri
7 mars 2008

Zagreb, Kroaci
7 mars 2008

Deloitte Albania sh.p.k.

Deloitte d.o.o.

BANKA E SHQIPËRISË
BILANCI
MË 31 DHJETOR 2007

(të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënim nr.	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
AKTIVET			
Aktive në monedhë të huaj			
Ari dhe metale të çmuara	3	923	797
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	4	7,031	7,867
Depozita në bankat e huaja	5	40,976	38,157
Investime të vlefshme për shitje	6.1	124,096	117,404
Investime të mbajtura për tregtim	6.2	8,747	9,636
Aktive të tjera në monedhë të huaj	7	752	726
Totali i aktiveve në monedhë të huaj		182,525	174,587
Aktive vendase			
Ari dhe metale të çmuara	3	63	53
Kredi tranzite	8.1	95	139
Kredi ndaj bankave vendase	8.2	1,509	8,904
Investime të vlefshme për shitje	9	66,523	67,575
Letra me vlerë të qeverisë për në rezervë	10	5,909	-
Aktive të tjera vendase	11	3,503	4,223
Totali i aktiveve vendase		77,602	80,894
Totali i aktiveve		260,127	255,481
DETYRIMET			
Detyrime në monedhë të huaj			
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	12	13,946	15,256
Detyrime ndaj institucioneve financiare jo vendase	13	1,183	1,246
Detyrime të tjera të huaja		251	186
Totali i detyrimeve në monedhë të huaj		15,380	16,688
Detyrime vendase			
Para në qarkullim	14	161,162	168,234
Detyrime ndaj bankave vendase	15	67,051	53,575
Detyrime ndaj qeverisë	16	14,313	15,944
Të ardhura për t'u shpërndarë	17	3	76
Detyrime të tjera vendase	18	927	954
Totali i detyrimeve vendase		243,456	238,783
KAPITALI I VET DHE REZERVAT			
Fondi i themelimit	19	2,500	750
Rezerva e përgjithshme	20	5,181	3,750
Rezerva e rivlerësimit	21	(22,759)	(15,856)
Rezerva e rivlerësimit të mjeteve fikse	11	1,755	2,660
Rezerva të tjera	22	14,614	8,706
Totali i kapitalit të vet dhe rezervat		1,291	10
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat		260,127	255,481

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 135 deri në faqen 162 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA E SHQIPËRISË
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2007
 (të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënim nr	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2007	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2006
Veprime me jorezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	23	7,151	5,870
Shpenzime interesi dhe komisioni	24	(337)	(494)
Totali neto nga veprimet me jo-rezidentë		6,814	5,376
Veprime me rezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	25	4,633	4,020
Shpenzime interesi dhe komisioni	26	(2,302)	(1,731)
Totali neto nga veprime me rezidentë		2,331	2,289
Të ardhura / (shpenzime) operative të tjera, neto	27	286	(1,367)
Humbje neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit valutor		(8,035)	(3,341)
Totali i të ardhurave operative		1,396	2,957
Shpenzime të tjera administrative			
Shpenzime personeli	28	(660)	(584)
Shpenzime amortizimi	11	(117)	(122)
Shpenzime zhvlerësimi të aktiveve të patrupëzuara	11	(69)	(114)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		(420)	(319)
Totali i shpenzimeve të tjera administrative		(1,266)	(1,139)
Të ardhurat neto nga aktiviteti i Bankës		130	1,818
Transferim në rezervën e rivlerësimit		8,035	3,341
Fitimi neto para shpërndarjes		8,165	5,159
Shpërndarja e fitimit në buxhetin e shtetit		5,010	4,664
Shpërndarja e fitimit në rezerva të tjera		-	495
Shpërndarja e fitimit në kapital themeltar		1,750	-
Shpërndarja e fitimit në rezervën e përgjithshme		1,405	-
Totali		8,165	5,159

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 135 deri në faqen 162 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA E SHQIPËRISË
PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT TË VET DHE REZERVAVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2007
 (të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Fondi i themelimit	Rezerva e përgjithshme	Rezerva e rivlerësimit	Rezerve e rivlerësimit të aktiveve fikse	Rezerva të tjera	Fitim i pashpermdare	Fitimi neto	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2005	750	3,750	(12,452)	983	8,182	-	-	1,213
Fitimi neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	-	1,818	1,818
Transferime nga/për në rezervën e rivlerësimit	-	-	(3,341)	-	-	-	3,341	-
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	(67)	-	-	-	-	(67)
Rritje nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	-	1,706	-	-	-	1,706
Rimarrje e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	-	(29)	-	29	-	-
Të tjera rivlerësime	-	-	4	-	-	-	-	4
Shpërndarja e fitimit	-	-	-	-	524	(29)	(5,159)	(4,664)
Gjendja më 31 dhjetor 2006	750	3,750	(15,856)	2,660	8,706	-	-	10
Fitimi neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	-	130	130
Transferime nga/për në rezervën e rivlerësimit	-	-	(8,035)	-	-	-	8,035	-
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	1,124	-	-	-	-	1,124
Sistemim i rivlerësimit të aktiveve fikse 2006	-	-	-	(1,706)	-	-	-	(1,706)
Rivlerësimi i aktiveve fikse 2007	-	-	-	827	-	-	-	827
Fonde nga qeveria për mbulim humbje të kapitalit	-	-	-	-	5,908	-	-	5,908
Rimarrje e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	-	(26)	-	26	-	-
Të tjera rivlerësime	-	-	8	-	-	-	-	8
Shpërndarja e fitimit	1,750	1,431	-	-	-	(26)	(8,165)	(5,010)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	2,500	5,181	(22,759)	1,755	14,614	-	-	1,291

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 135 deri në faqen 162 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA E SHQIPËRISË
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2007
 (të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënim nr.	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2007	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2006
Fluksi i parasë nga operacionet			
Fitimi neto i vitit		8,165	5,159
Zëra jomonetar në pasqyrimin e operacioneve			
Fitim nga kontratat <i>forward</i>		(41)	-
Provizjone për hua të dyshimta		(2)	5
Zhvlërimi dhe amortizimi		255	237
Amortizimi i skontos së letrave me vlerë të vlefshme për shitje		(4,714)	(3,920)
Të ardhura nga interesat		(6,816)	(5,533)
Shpenzime për interesat		2,384	1,802
Humbje neto nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje		114	1,503
Fitim neto nga shitja e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim		(41)	(72)
Fitime neto të përcaktuara nga letrat me vlerë të mbajtura për tregtim		(215)	(5)
Amortizimi i grantit dhe ndihmës		(73)	(53)
Fluksi i parasë para lëvizjes së kapitalit punues		(984)	(877)
Ndryshime në kapitalin punues			
Ulje në depozita me Fondin Monetar Ndërkombëtar		831	564
Rritje në aktive të tjera në monedhë të huaj		(37)	(171)
Ulje në kreditë tranzite		44	68
Rritje / (ulje) në aktive të tjera vendase		688	(1,865)
Ulje në detyrimet ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar		(1,313)	(892)
Ulje në detyrimet ndaj institucioneve financiare		(62)	(73)
Rritje në detyrime të tjera huaja		65	186
Rritje në detyrimet ndaj bankave vendase		17,657	4,688
(Ulje) / Rritje në detyrimet ndaj qeverisë		(1,631)	9,588
(Ulje) / rritje në detyrime të tjera në monedhë vendase		(27)	193
Blerja e letrave me vlerë në monedhë të huaj të mbajtura për tregtim		(18,185)	(25,726)
Shitja e letrave me vlerë në monedhë të huaj të mbajtura për tregtim		18,155	16,281
Fluksi i parasë i gjeneruar nga operacionet		16,184	2,841
Interesa të marrë		6,857	5,396
Interesa të paguar		(2,364)	(1,788)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitete operacionale		19,693	5,572

BANKA E SHQIPËRISË
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË (VAZHDIM)
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2007
 (të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënim nr.	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2007	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2006
Fluksi nga investimet			
Blerja e aktiveve fikse		(206)	(75)
Blerja e aktiveve fikse të patrupëzuara		(15)	(2)
Blerja e letrave me vlerë në monedhë të huaj të vlefshme për shitje		(242,240)	(289,309)
Blerja e letrave me vlerë në monedhë vendase të vlefshme për shitje		(180,212)	(181,866)
Shitja dhe maturime të letrave me vlerë në monedhë të huaj të vlefshme për shitje		230,159	300,050
Shitja dhe maturime të letrave me vlerë në monedhë vendase të vlefshme për shitje		185,658	184,832
(Rritje) / ulje në marrëveshjet e riblerjes		3,143	(5,156)
Axhustime për efekt kurs këmbimi		(143)	506
Fluksi neto i (përdorur) / gjeneruar nga investimet		(3,856)	8,980
Fluksi i parasë prej financimit			
Pagesa të borxheve të maturuara		-	1,726
Rivlerësimi i godinave të bankës		827	1,706
Sistemim i rivlerësimit të godinës qendrore të vitit 2006		(1,706)	-
Rivlerësimi i rezervave të tjera		8	4
Rritja në rezervën e përgjithshme		1,431	-
Rritja në rezerva të tjera		-	524
Rritja e fondit të themelimit		1,750	-
Rritja (ulja) në emetimin e parasë në qarkullim		(3,500)	9,000
Fitimi i shpërndarë		(8,191)	(5,188)
Fluksi neto i (përdorur) / gjeneruar nga financimet		(9,382)	7,772
Rritja në para gjatë vitit		6,455	22,324
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	29	46,714	24,390
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	29	53,169	46,714

Shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 135 deri në faqen 162 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në 26 mars 2008.

Ardian Fullani

 Guvernator i Bankës së Shqipërisë

Artan Toro

 Drejtor i Departamentit të
 Kontabilitetit dhe Financës

BANKA E SHQIPËRISË
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2007
 (të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Banka e Shqipërisë ("Banka") është Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 8269 datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë". Në zbatim të këtij ligji detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë janë si vijon:

- arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve;
- nxitja dhe mbështetja e zhvillimit të një regjimi të këmbimeve valutore;
- administrimi i parasë në qarkullim;
- administrimi i normave të interesit;
- hartimi, miratimi dhe zbatimi i politikës monetare të Republikës së Shqipërisë;
- mbikëqyrja e aktivitetit të bankave të nivelit të dytë përfshirë dhënien e licencave të të gjitha bankave;
- dhënia e licencave për ushtrimin e aktivitetit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të institucioneve bankare ndërkombëtare.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për Bankën e Shqipërisë".

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

(a) Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin Shqiptar "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe në përputhje me parimet kontabël të përshtatura në Manualin e Kontabilitetit të Bankës së Shqipërisë, miratuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me Vendimin Nr. 50 datë 26.01.2001. Kjo politikë kontabile është gjerësisht në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të aprovuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"). SNRF-të përdoren në përgatitjen e pasqyrave financiare bashkëngjitur, deri në fazën ku nuk bien në kundërshtim me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë".

Parimet kontabile kryesore që janë përdorur nga Banka në pasqyrat financiare janë përshkruar si më poshtë:

Pasqyrat financiare të paraqitura përfshijnë llogaritë e Bankës, përgatitur mbi bazën e kostos historike të kontabilitetit, duke e kombinuar me elemente

të metodave të tjera, të cilat bazohen në koston aktuale, përshtatur për të përfshirë rivlerësimin e portofolit të letrave me vlerë, monedhave të huaja, të arit, të ndërtesave pronë e bankës, si dhe të aktiveve dhe detyrimeve të tjera financiare.

Pasqyrat financiare paraqiten në monedhën vendase të Republikës së Shqipërisë, LEKË Shqiptar ("LEKË").

Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës, një njësi biznesi e cila merret me shtypshkrimin e materialeve të Qeverisë, që përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, si dhe të publikimeve të Bankës së Shqipërisë. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, më datë 1 prill 2003, vendosi që Shtypshkronja të mbetet përkohësisht në varësi administrative të Bankës së Shqipërisë, si pjesë e veçantë e strukturës organizative të saj. Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 598, datë 5 shtator 2007 vendosi mbylljen e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ndërmarrjes shtetërore "Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë", me datën, 31 mars 2008.

Aktiviteti financiar i Shtypshkronjës nuk është konsoliduar në vite për arsye të statusit të saj të pasqaruar me qeverinë, në lidhje me pronësinë. Këtë vit për arsye të mbylljes së veprimtarisë së saj në fund të marsit 2008 nuk është bërë konsolidimi i pasqyrave financiare.

Pozicioni financiar i Shtypshkronjës, më 31 dhjetor 2007 dhe 2006 është i pasqaruar në Shënimin 30 të këtyre pasqyrave financiare.

(b) Mospërputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Mospërputhjet më të rëndësishme me "SNRF" mund të përmbliidhen si më poshtë:

- SNK 19: "Përfitimet e punonjësve" dhe SNK 26 "Kontabiliteti dhe Raportimi i fondit të pensionit"

Pasqyrimi dhe kontabiliteti i Fondit të Pensionit ende nuk është në përputhje me SNK 19 dhe 26. Detyrimi ndaj fondit të pensionit është shprehur si vlerë neto, por përlogaritja e këtij detyrimi nuk i është përmbajtur specifikimeve të standardit. Rregullorja e miratuar gjatë vitit 2007, parashikon funksionimin e këtij fondi si fond me kontribute të përcaktuara, duke mundësuar pasqyrimin dhe kontabilizimin e fondit të pensionit në vitin në vijim, në përputhje me standardet e sipërcituara.

- SNK 27: "Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe kontabiliteti i investimit në filiale".

Në pasqyrat financiare të Bankës nuk është bërë konsolidimi i raporteve financiare në lidhje me aktivitetin e shtypshkronjës, njësi që administrohet nga Banka, siç sqarohet sa më sipër.

- SNK 8: "Politikat kontabël, ndryshime në vlerësimet kontabël dhe gabimet"

Në vitet e mëparshme, banka ka rivlerësuar godinën e saj qendrore duke përdorur metodën e kapitalizimit të të ardhurave nga qiraja dhe të çmimeve të shitjes të qendrave të reja tregtare rreth saj. Gjatë këtij viti banka ka vendosur të rivlerësojë godinën qendrore duke përdorur metodën e Kostos së Zëvendësimit. Veprimi kontabël rregullues i sistemit të rivlerësimit të vitit të mëparshëm është regjistruar në këtë vit dhe kjo nuk është në përputhje me SNK 8.

- SNRF 7: "Instrumentet Financiare: informacioni i pasqyruar"

Banka nuk ka paraqitur të gjithë informacionin në lidhje me politikat dhe procedurat për manaxhimin, matjen dhe kontrollin e rreziqeve që has banka, si dhe paraqitje të tjera të kërkuara nga SNRF 7 "Instrumentat Financiare: informacioni i pasqyruar".

(c) Njohja e interesave dhe komisioneve

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa përfshijnë interesat e fituar nga kuponat si edhe amortizimin e çdo primi apo skontoje apo çdo diference tjetër ndërmjet vlerës fillestare kontabël të instrumentit fitimprurës dhe vlerës së tij në maturim, llogaritur bazuar në metodën lineare.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet lindin nga shërbimet financiare të siguruar nga Banka dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në momentin që shërbimi kryhet. Shpenzime/të ardhura të tjera operative përfshijnë fitimet dhe humbjet që vijnë nga shitjet dhe ndryshimet në vlerën e tregut të mjeteve dhe detyrimeve financiare, të mbajtura për tregtim apo të vlefshme për shitje.

(d) Konvertimi i monedhave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEKË, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen.

Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet fillimisht në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe më pas transferohet në llogarinë "Rezerva të rivlerësimit" në bilanc, siç parashikon ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Kurset zyrtare të këmbimit, të përdorura nga Banka (njësi e monedhës së huaj përkatëse e shprehur në LEKË) për monedhat e huaja më kryesore, më 31 dhjetor 2007 dhe 31 dhjetor 2006 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Dollari amerikan ("USD")	82.89	94.14
Monedha Evropiane ("EURO")	121.78	123.85
Stërlina angleze ("GBP")	166.02	184.65
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("SDR")	130.84	141.51
Jen japonez (JPY)	0.7401	0.7919
Ari ("XAU")	1 onz = 69,337.49	1 onz = 59,844.80

(e) Aktivet financiare

Të gjitha aktivet financiare shprehen fillimisht me kosto, që konsiderohet çmimi i blerjes përfshirë shpenzimet e lidhura me blerjen e aktivitet financiar, dhe në vijim maten me vlerën reale.

Aktivitet financiare klasifikohen si më poshtë:

Hua të krijuara nga Banka

Huatë janë aktive financiare me pagesa fikse ose të paracaktuara, të cilat nuk tregtohen në një treg aktiv por krijohen nga Banka për t'i siguruar fonde huamarrësit. Huatë e krijuara nga Banka përfshijnë huatë për punonjësit.

Në çdo datë raportimi në vijim ato paraqiten me koston e amortizuar, duke zbritur çdo humbje nga rënia e vlerës për të reflektuar shumat që nuk mund të rekuperohen më.

Të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare, të cilat mbartin pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturime fikse, për të cilat Banka ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim.

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim njihen në pasqyrat financiare në datën efektive të shlyerjes dhe fillimisht regjistrohen me kosto. Në çdo datë raportimi në vijim ato paraqiten me vlerën e amortizuar, duke zbritur humbjen nga rënia në vlerë, e cila njihet për të reflektuar shumat e parekuperueshme.

Të vlefshme për shitje

Investime të vlefshme për shitje njihen në pasqyrat financiare në datën efektive të shlyerjes dhe, pas njohjes së parë, ato paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën reale. Ndryshimet në vlerën reale pasqyrohen direkt në kapital në "Rezervën e rivlerësimit të letrave me vlerë", përveç humbjeve nga rënia në vlerë. Kur investimi shitet ose shpreh rënie në vlerën e arkëtueshme, fitimi apo humbja e akumuluar e njohur deri në atë moment në rezervën e rivlerësimit, njihet si e ardhur ose shpenzim për periudhën.

Aktive financiare të mbajtura me vlerë reale përmes fitim humbjes

Kjo kategori përfshin instrumente financiare që Banka i mban për qëllime tregtimi në terma afatshkurtër. Këto investime njihen në pasqyrat financiare në datën e tregtimit, datë kjo kur blerja apo shitja e investimit është e përcaktuar në marrëveshje, termat e së cilës kërkojnë shlyerjen e investimit brenda afatit të përcaktuar nga tregu. Letrat me vlerë të mbajtura për tregtim njihen në pasqyrat financiare me vlerën reale. Çdo fitim/humbje e realizuar nga ndryshimi në vlerën reale njihet direkt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera reale

Për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara, vlera reale përcaktohet duke iu referuar çmimeve të kuotuar në bursë në momentin e mbylljes së aktivitetit të biznesit në datën e bilancit.

Për letrat me vlerë, për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës reale përcaktohet duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një letre tjetër me vlerë, e cila është e përafërt në natyrë.

Rënia në vlerë dhe paarkëtueshmëria e aktiveve financiare

Mjetet financiare, me përjashtim të atyre klasifikuar si "Të mbajtura për tregtim", vlerësohen në çdo datë bilanci nëse kanë pësuar rënie në vlerë apo kanë humbur aftësinë shlyerse. Mjetet financiare pësojnë rënie në vlerë kur ka evidencë objektive që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të mjetit financiar, janë ndikuar rrjedhat e ardhëshme të parave që pritet të merren nga investimi. Në qoftë se një evidencë e tillë ekziston, përcaktohet shuma që vlerësohet të merret nga ai aktiv dhe ndonjë humbje nga rënia në vlerë, duke u bazuar në vlerën neto aktuale të rrjedhjes së ardhshme të parasë që pritet të merret, dhe diferenca midis shumës që vlerësohet të merret dhe vlerës kontabël njihet si më poshtë:

- për huatë e krijuara nga Banka - shuma e rekuperueshme e huasë së krijuar llogaritet bazuar mbi vlerësimin në fund të vitit për huatë, duke përfshirë dhe interesin e akumuluar. Në përcaktimin e shumave të rekuperueshme nga huatë për personelin, drejtuesit duhet të konsiderojnë shumë faktorë, duke përfshirë dhe historinë e pagesave të ish-punonjësve. Provigjone për rënien në vlerë të huave raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim dhe zbritet nga kategoria përkatëse e aktiveve në bilanc. Kur vendoset që një hua nuk mund të rekuperohet më, të gjitha procedurat e nevojshme ligjore janë përfunduar dhe humbja përfundimtare është përcaktuar, huaja hiqet nga librat;
- për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim – vlera e mbartur e aktivitetit ulet deri në shumën që vlerësohet të merret në mënyrë direkte ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie provigjone dhe shuma e humbjes përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- për aktivet financiare të vlefshme për shitje – në qoftë se rënia në vlerën

e tregut e një aktivi të disponueshëm për shitje është kaluar direkt në kapital dhe ka një evidencë objektive që aktivi mund të ketë rënie në vlerë, humbja e akumuluar që është njohur direkt në kapital do të hiqet nga kapitali dhe do të njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve edhe nëse aktivi financiar zotërohet përsëri nga Banka.

(f) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë blerë nën marrëveshje për t'i rishitur (marrëveshje riblerjeje e anasjelltë) dhe letrat me vlerë shitur nën marrëveshje për t'i riblerë (marrëveshjet e riblerjes) janë trajtuar përgjithësisht si hua të kolateralizuara dhe regjistrohen me shumën e parave të dhëna/marra, plus interesin e përllogaritur.

Marrëveshjet e riblerjes regjistrohen në bilanc në zërin "Detyrime ndaj bankave vendase". Bazuar mbi rregulloren e Bankës së Shqipërisë mbi marrëveshjet e riblerjes, Bankës nuk i duhet të krijojë kolateral për këto letra me vlerë.

Interesi i fituar mbi marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe interesi i pësuar mbi marrëveshjet e riblerjes njihen si të ardhura ose shpenzime nga interesi gjatë jetëgjatësisë së çdo marrëveshjeje, duke përdorur normën bazë të interesit të shpallur me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës.

(g) Aktive të qëndrueshme

Aktivitet e qëndrueshme shprehen me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar, me përjashtim të ndërtesave të Bankës, të cilat shprehen të rivlerësuara me metodën e koston së zëvendësimit (Shënimi 11). Çdo rritje që rrjedh nga rivlerësimi i godinave, kreditohet direkt në kapital në zërin rezerva të rivlerësimit të ndërtesave, përveç rastit kur kjo rritje anulon rënien nga vlerësimi i të njëjtit aktiv, të njohur më përpara në fitim/humbje, rast ky specifik ku rritja nga rivlerësimi njihet direkt në fitim/humbje deri në masën e rënies së njohur paraprakisht. Çdo rënie në vlerën e mbetur të ndërtesave, rezultuar nga procesi i rivlerësimit njihet direkt fitim/humbje deri në masën e balancës së njohur në rezervat e rivlerësimit, rezultuar nga rivlerësimi i mëparshëm i godinave.

Në qoftë se vlera e tregut e një aktivi të qëndrueshëm është më e vogël sesa vlera kontabël, për shkak të rrethanave të konsideruara jo të përkohshme, aktivi zvogëlohet deri në vlerën e tregut.

Fitimet ose humbjet nga heqja (shitjet ose nxjerrjet jashtë përdorimit) e aktiveve të qëndrueshme, përcaktohen si diferencë midis vlerës neto të daljes nga bilanci dhe vlerës neto kontabël të mjetit, dhe regjistrohen në llogarinë humbje-fitim të vitit në të cilin aktivi është hequr.

Amortizimi llogaritet mbi të gjitha aktivet fikse bazuar në koston historike ose në shumën e rivlerësuar. Amortizimi vjetor llogaritet me metodën lineare duke përdorur normat specifike të amortizimit për çdo aktiv të amortizueshëm,

bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivitetit. Jetëgjatësia e zbatuar në vitin 2007 është e njëjtë me atë të vitit 2006:

	2007
Ndërtesa–godina qendrore	40 vjet
Ndërtesat–në degë	25 vjet
Mjete transporti	5–10 vjet
Pajisje zyre	3–20 vjet
Programe kompjuteri	2 vjet

(h) Kosto të shtypjes dhe prerjes së parasë

Kostot e printimit të kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave, kapitalizohen si aktive fikse të patrupëzuara dhe amortizohen respektivisht me 2.5 vjet dhe 10 vjet.

(i) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” dhe bazuar në këtë ligj i gjithë fitimi kalon direkt në buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë, të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

(j) Rezerva e Përgjithshme

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka ka krijuar një rezervë të përgjithshme në të cilën transferohet 25 për qind e fitimit neto të çdo viti, derisa shuma e rezervës arrin 500 për qind të fondit të themelimit.

(k) Grantet

Grantet regjistrohen fillimisht në bilanc me shumën e marrë. Grantet që lidhen me zëra shpenzimi kalohen te pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve gjatë periudhës që është bërë shpenzimi. Grantet që lidhen më blerjen e pronave, pajisjeve dhe programeve kompjuterike kalohen te pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve përgjatë jetës së aktivitetit përkatës, në shumën që i përket zhvlerësimit/amortizimit që i zbritet aktivitetit.

(l) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllimin e përgatitjes së pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj ndahen në arka në LEKË dhe në monedha të huaja, si dhe depozita në monedhë të huaj me maturitet të mbetur më pak se tre muaj.

(m) Përdorimi i parashikimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi i Bankës që të bëjë parashikime dhe supozime, që ndikojnë në shumën e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve kontigjente, llogaritur në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe shumën e raportuara të të

ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhave të raportuara. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

(n) Ndryshime në politikat kontabël

Në vitet e mëparshme banka e ka njohur vlerën e godinave të saj, përjashtojë godinën qendrore, me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar. Gjatë vitit që mbyllet më 31 dhjetor 2007 banka ka përfunduar procesin e rivlerësimit për të gjithë kategorinë e ndërtesave dhe ka ndryshuar politikën e njohjes kontabël nga metoda e koston historike në modelin e rivlerësimit.

Amortizimi i akumuluar në datën e rivlerësimit është hequr kundrejt koston historike të ndërtesave dhe vlera neto është shprehur si vlera e rivlerësuar e ndërtesave.

3. ARI DHE METALE TË ÇMUARA

Më 31 dhjetor 2007, vlera e arit të vendosur në depozita, mjete të Bankës ishte 923 milionë lekë (2006 – 797 milionë lekë) e cila përbëhet prej 13,319 onz në shufra prej ari (2006 – 13,319 onz ar).

Ari është vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit. Diferenca prej 126 milionë lekë (2006- 89 milionë lekë), rezulton nga rivlerësimi i arit që është regjistruar në rezervën e rivlerësimit. Më 31 dhjetor 2007, një onz ar u vlerësua me 836.5 usd (2006 –635.7 usd).

Ari dhe metale të tjera të çmuara të përfshira në aktive në monedhë vendase përfshin gjendjet e platinës dhe të argjendit në kasafortë, të vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit, me një shumë totale prej 57 milionë lekësh më 31 dhjetor 2007 (2006 – 48 milionë lekë), si edhe ar jo monetar prej 6 milionë lekësh (2006 – 5 milionë lekë).

4. DEPOZITA TEK FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)	6,868	7,012
E drejta speciale e tërheqjes ("SDR")	160	847
Interes i përlogaritur	3	8
Totali	7,031	7,867

Kuotat tek Fondi Monetar Ndërkombëtar ("FMN") rezultojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë pranë FMN-së, në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë". Këto depozita kanë si kundërparti huatë e dhëna nga FMN për Republikën e Shqipërisë siç paraqitet në shënimin 12.

E drejta speciale e tërheqjes përfaqëson depozitat e vendosura pranë FMN-së. Këto depozita kanë një interes të përcaktuar në bazë javore. Norma e interesit më 31 dhjetor 2007 ishte 3.5 për qind (2006 – 4.07 për qind).

5. DEPOZITA NË BANKAT E HUAJA

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Llogari rrjedhëse	9,472	17,281
Depozita afatshkurtra	31,369	20,803
Interes i përlogaritur	135	73
Totali	40,976	38,157

Depozitat afatshkurtër dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja, kanë norma interesi që bazohen në monedhën e depozitës apo të llogarisë rrjedhëse dhe variojnë nga 0.66 për qind deri në 6.63 për qind (2006 – nga 0.17 për qind deri në 5.29 për qind).

Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja janë në euro, usd, gbp dhe jpy, të cilat sipas çdo monedhe të huaj u përgjigjen gjendjeve të mëposhtme:

	31 dhjetor 2007 (në milionë)	31 dhjetor 2006 (në milionë)
EURO	226	197
USD	100	96
GBP	9	7
JPY	4,897	4,022

6. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (NË MONEDHË TË HUAJ)

6.1. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj, të vlefshme për shitje paraqitur në vlerë tregu është si më poshtë:

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Nota thesari të qeverive të huaja	89,821	87,190
Investime afatmesme të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare	26,448	18,212
Investime me kurs fiks të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (FIX BIS)	6,432	9,711
Bono thesari të Qeverisë Franceze	-	1,818
Nota thesari të agjencive amerikane	1,395	473
Totali	124,096	117,404

Nota thesarit të qeverive të huaja përfshijnë nota thesari të Qeverisë Amerikane të shprehura në usd, të Qeverive Franceze dhe Gjermane të shprehura në euro si dhe të Qeverisë Angleze të shprehura në gdp. Notat e thesarit të qeverive të huaja kanë kurse kuponash që variojnë nga 2.05 për qind në 9 për qind. Interesi paguhet në baza gjashtëmujore (usd) dhe vjetore

(euro dhe gbp) si dhe maturimet variojnë nga prill i vitit 2008 në Tetor të vitit 2016. Norma e brendshme e kthimit varion nga 2.95 për qind në 5.8 për qind (2006 – 2.8 për qind në 5.66 për qind).

Investimet afatmesme të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare përbëhen nga letra me vlerë me kupona fikse, të përcaktuara në usd, euro dhe gbp me kurse që variojnë nga 2.5 për qind në 4.7 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore për investimet në euro dhe gjashtëmujore për investimet në usd dhe në gbp, dhe maturimet variojnë midis mars 2008 dhe mars të vitit 2014. Norma e brendshme e kthimit varion nga 3.30 për qind në 5.95 për qind (2006 – 2.87 për qind në 5.28 për qind).

Investimet me kurs fiks të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (FIX BIS) janë të shprehura në euro dhe jpy me norma të brendshme kthimi që variojnë nga 0.32 për qind në 4.39 për qind (2006 – 3.56 për qind në 5.3 për qind), dhe me kufij maturiteti nga janar 2008 në korrik 2008.

Notat e agjencive amerikane janë të shprehura në usd me kurse kuponi nga 3.25 për qind deri në 7.12 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza gjashtëmujore dhe kufijtë e maturimit janë nga shkurt 2009 deri në nëntor 2011. Normat e brendshme të kthimit variojnë nga 4.24 për qind në 5.20 për qind (2006 – 2.4 për qind).

Portofoli i letrave me vlerë në monedha të huaja, klasifikuar si “të vlefshme për shitje”, paraqitur në vlerë nominale sipas monedhave është si më poshtë:

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
USD		
Nota të Qeverisë Amerikane	382	388
Investime afatmesme të BIS	72	32
Nota të agjencive amerikane	16	5
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	-	2
Totali	470	427
EURO		
Nota të Qeverisë Franceze	87	199
Nota të Qeverisë Gjermane	326	169
Investime afatmesme të BIS	147	112
Bono thesari të Qeverisë Franceze	-	15
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	10	60
Totali	570	555
GBP		
Nota të Qeverisë Angleze	34	27
Investime afatmesme të BIS	15	7
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	-	11
Totali	49	45
JPY		
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	7,000	-
Totali	7,000	-

6.2. LETRA ME VLERË TË MBAJTURA PËR TREGTIM

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj, klasifikuar si “Të mbajtura për tregtim” paraqitet me vlerë tregu në lekë si më poshtë:

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Nota thesari të Qeverisë Amerikane	5,818	6,407
Nota thesari të agjencive amerikane dhe korporatave	2,929	3,229
Totali	8,747	9,636

Notat e Qeverisë Amerikane, të shprehura në USD, kanë kurse kuponi që variojnë ndërmjet 3.37 për qind dhe 6 për qind . Interesi është i pagueshëm çdo gjashtë muaj dhe maturiteti varion ndërmjet dhjetorit 2008 dhe gushtit 2012.

Notat e agjencive amerikane dhe korporatave, të shprehura në usd, kanë kurse kuponi që variojnë ndërmjet 4.12 për qind dhe 5,37 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore ose gjashtëmujore, dhe maturiteti varion ndërmjet tetor 2008 dhe nëntor 2010.

Duke filluar nga data 25 korrik 2006, ky portofol administrohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) në kuadrin e marrëveshjes së Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore “Për administrimin dhe asistencën teknike mbi investimin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë” e lidhur me datë 23 shtator 2005. Ky portofol njihet në pasqyrat financiare në datën e tregtimit.

7. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË TË HUAJ)

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Kuotizacione në institucionet ndërkombëtare		
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)	353	358
Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA)	12	12
Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA)	6	6
Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)	61	69
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)	48	55
Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)	19	22
Totali i kuotizacioneve	498	522
Arka në valutë	4	15
Të drejta ndaj IBRD	250	189
Totali aktive të tjera në monedhë të huaj	752	726

Më 31 dhjetor 2007, aktive të tjera në monedhë të huaj përbëhen nga kuotizacionet për pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare financiare prej 498 milionë lekësh (2006 – 522 milionë lekë), si dhe nga arka në valutë me një vlerë prej 4 milionë lekësh (2006 – 15 milionë lekë).

Kuotizacionet e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) në shumën prej 353 milionë lekësh (usd 3.6 milionë), lidhen me shumën e kuotave të paguara te ky institucion ndërkombëtar. Më 31 dhjetor 2007 shuma e kuotave të papaguara tek IBRD-ja është 8,001 milionë Lekë (usd 96.5 milionë) pronësia e të cilave është akoma duke u diskutuar ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shqipërisë. Të dyja palët janë aktualisht duke negociuar një memorandum për kuptimin e ndarjes të kontributeve origjinale dhe pronësisë së kuotave të zotëruara tek institucionet financiare ndërkombëtare ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shqipërisë.

Të drejta ndaj IBRD përfaqëson shumën për t'u arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë nga aktiviteti i administruar nga IBRD, gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes së transaksionit (shiko Shënimin 6.2).

8. KREDI PËR PALËT E TRETA

8.1. KREDI TRANZITE

Totali prej 95 milionë lekësh (2006 – 139 milionë lekë) përfaqëson kredi për sektorin e shërbimeve, akorduar Bankës Italo-Shqiptare për t'u shpërndarë huamarrësve, me qëllim mbështetjen e programeve qeveritare (shiko Shënimin 13). Për këtë hua nuk është vendosur kolateral.

8.2 KREDI NDAJ BANKAVE VENDASE

Kredia ndaj bankave vendase përfaqëson marrëveshje të anasjellta riblerjeje, të vendosura midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë, në vlerën 1,509 milionë lekë (2006 - 8,904 milionë lekë), me afat maturimi njëjavore. Në 31 dhjetor 2007, norma e interesit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes është 6.25 për qind (2006: 5.6 për qind and 6.51 për qind)

9. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Bono thesari afatshkurtra të Qeverisë Shqiptare	66,523	67,575
Totali	66,523	67,575

Më 31 dhjetor 2007, bonot e thesarit afatshkurtra përfaqësojnë bono thesari të Qeverisë me kupon zero, me afat maturimi afatshkurtër, të cilat maturohen në periudhën janar - shtator 2008. Norma e tyre e kthimit në blerje varion nga 6 për qind deri në 7.94 për qind (2006 –5.4 për qind deri në 7.1 për qind).

10. LETRA ME VLERË TË QEVERISË PËR NË REZERVË

Në datë 31 dhjetor 2007, Ministria e Financave ka emetuar një letër me vlerë me vlerë nominale 6,000 milion lekë, e cila mbart interes norma e të cilës është sa normat e interesit të bonove të thesarit të tremujorit të fundit me datë maturimit 27 mars 2008 dhe me “call option” e kushtëzuar me transferimin e Arit nga Qeveria Shqiptare. Ministria ka të drejtën e tërheqjes së letrës me vlerë pasi të ketë përfunduar transferimi i pronësisë së arit nga Qeveria Shqiptare tek Banka e Shqipërisë, siç shpjegohet në Shënimin 37.1.

Ministria e Financave i ka transferuar Bankës letrat me vlerë të sipërpërmendura pasi më 31 dhjetor totali i kapitalit të paguar dhe detyrimeve të Bankës tejkaloi totalin e mjeteve në shumën 7,118 milionë lekë. Letrat me vlerë janë emetuar në bazë të nenit 7, të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” numër 8269, datë 23 dhjetor 1997, me qëllim mbulimin e deficitit të përmendur më lart.

11. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Aktive fikse, neto	2,263	3,123
Aktive të patrupëzuara, neto	111	166
Kredi punonjësve	1,037	857
Debitorë të tjerë	3	6
Numizmatika	40	39
Inventari	38	25
Të tjera	11	7
Totali	3,503	4,223

Në 31 dhjetor 2007, Banka ka përfshirë një vlerësues të pavarur në procesin e rivlerësimit të të gjitha ndërtesave të Bankës së Shqipërisë, të përfshirë nën kategorinë “Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme”. Metoda e rivlerësimit është ajo e kostos së zëvendësimit, në shumën prej 1,938 milionë lekësh, nga vlera neto kontabël e ndërtesës kryesore prej 1,179 milionë lekësh. Efekti në rritje nga rivlerësimi i ndërtesave të Bankës së Shqipërisë në shumën prej 826 milionë lekësh u kreditua direkt në llogarinë e Rezervës së Rivlerësimit në kapital, ndërsa efekti në rënie nga rivlerësimi i aktivitetit prej 69 milionë lekësh u regjistrua në zërin “Shpenzime të përgjithshme të bankës.

Në vitin e mëparshëm, efektivisht më 26 dhjetor 2006 u krye rivlerësimi i godinës qendrore nga një vlerësues i pavarur, bazuar në kapitalizmin e të ardhurave nga qiratë dhe të çmimeve të shitjes të qendrave të reja të biznesit rreth bankës, e cila krijoi një efekt në rritje të rezervës së rivlerësimit në shumën 1,706 milion lekë. Aktivitetet e qëndrueshme të trupëzuara (ndërtesat), janë rivlerësuar sipas metodikës së vlerësimit të kostos së zëvendësimit, duke respektuar edhe rekomandimin e auditorit të pavarur e kërkesat e SNK 16 “Pasuria, Ndërtesat dhe Pajisjet”. Sistemimi i këtij transaksioni është regjistruar në pasqyrat financiare të Bankës për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2007.

Në 31 dhjetor 2007, kreditë e punonjësve përfshijnë provigjone për çështje gjyqësore që lidhen me to, në masën 10 milionë lekë.

Në 31 dhjetor 2007, vlera e regjistruar e kolateralit për kreditë afatgjata dhënë punonjësve të Bankës, arrin në shumën 1,218 milionë lekë (2006: 990 milionë lekë).

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa konstruksione të përgjithshme	Pajisje të përgjithshme	Mjete transporti	Ndërtime në proces	Totali i aktiveve fikse
Kosto/Vlerësimi					
Gjendja më 1 janar 2007	2,964	710	200	33	3,907
Shtesat	6	121	41	39	207
Pakësime	-	(53)	-	-	(53)
Transferime	24	-	-	(24)	-
Sistemim i rivlerësimit të godinës 2006	(1,706)	-	-	-	(1,706)
Sistemim i eliminimit të rivlerësimit 2006	189	-	-	-	189
Rivlerësimi i ndërtesave të Bankës	758	-	-	-	758
Eliminim në rivlerësim	(293)	-	-	-	(293)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	1,942	778	241	48	3,009
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2007	69	560	155	-	784
Amortizimi i vitit	35	67	15	-	117
Pakësime	-	(51)	-	-	(51)
Sistemim i eliminimit të rivlerësimit 2006	189	-	-	-	189
Eliminim në rivlerësim	(293)	-	-	-	(293)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	-	576	170	-	746
Vlera kontabël neto					
Gjendja më 31 dhjetor 2007	1,942	202	71	48	2,263
Gjendja më 31 dhjetor 2006	2,895	150	45	33	3,123

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse të patrupëzuara për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Kartëmonedha të prera dhe monedha të shtypura	Totali i aktiveve fikse të patrupëzuara
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2007	338	2,454	2,792
Shtesat	15	-	15
Pakësime	-	(1)	(1)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	353	2,453	2,806
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2007	314	2,312	2,626
Amortizimi i vitit	24	45	69
Gjendja më 31 dhjetor 2007	338	2,357	2,695
Vlera kontabël neto:			
Më 31 dhjetor 2007	15	96	111
Më 31 dhjetor 2006	24	142	166

12. DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit (PRGF)	6,821	8,364
Llogaria e letrave me vlerë tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	5,042	4,812
Llogari e FMN-së në lekë	2,077	2,077
Interes i përllogaritur	6	3
Totali	13,946	15,256

Huatë PRGF janë të lidhura me kuotizacionet për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në FMN dhe janë tërhequr në emër të qeverisë për reformat makroekonomike. Këto hua përfshijnë programet e mëposhtme:

“Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 2” u miratua me marrëveshjen e datës 13 maj 1998 në shumën 45,040,000 sdr, duke u disbursuar nga viti 1999 deri në vitin 2001. Gjendja më 31 dhjetor 2007 është 19,660,900 sdr (2006 – 28,668,900 sdr). Kjo është një hua me maturitet e kthyeshme deri në vitin 2011, në 10 këste gjashtëmujore duke filluar nga viti 2004. Norma e interesit është 0.5 për qind dhe është e pagueshme çdo gjashtë muaj.

“Huaja e Uljes së varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 3” u miratua me marrëveshjen e datës 21 qershor 2002 në shumën 28,000,000 sdr dhe është disbursuar deri më 20 qershor 2005. Gjendja në fund të vitit 2007 është 27,600,000 sdr (2006 - 28,000,000 SDR) me një interes prej 0.5 për qind, i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysmë, me 10 këste të barabarta.

“Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit” (PRGF 4) dhe “Huaja-Lehtësia e Financimit Afatmesëm” (EEF) u miratuan me marrëveshjen trevjeçare të datës 27 janar 2006, në shumën 17,045,000 sdr.

Disbursimi i dy transheve të dytë të PRGF 4 prej 2,435,000 sdr u bë në vitin 2007, me një interes prej 0.5 për qind, i pagueshëm çdo gjashtë muaj dhe gjendja më 31 dhjetor 2007 është 4,870,000 sdr. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysmë, në dhjetë këste gjashtëmujore të barabarta.

“Huaja-Lehtësia e Financimit Afatmesëm” EFF e disbursuar prej 4,870,000 sdr gjatë viteve 2006-2007 është vlerësuar 690 milionë lekë. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas katër vjet e gjysmë, brenda 10 vjetëve. Interesi i këtyre kredive është i ndryshueshëm dhe paguhet çdo tre muaj. Më 31 dhjetor 2007 interesi ishte 4.77 për qind.

13. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE JO REZIDENTE

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Detyrime tranzite (Shënimi 8.1)	95	139
Hua e Republikës së Greqisë	1,072	1,090
Detyrime ndaj Bankës Botërore	12	12
Interes i përlogaritur	4	5
Totali	1,183	1,246

Detyrime tranzite prej 95 milionë lekësh përfaqëson huanë e dhënë nga Banka Evropiane e Investimeve dhe përbëhet nga huaja prej 0.8 milionë eurosh (shënimi 8.1). Interesi paguhet nga përfituesit e këtyre kredive tranzite (Bankat dhe kompanitë vendase) drejtpërsëdrejti tek sigurvezit e financimit.

Huaja e Republikës Greke prej 8.8 milionë eurosh është dhënë me qëllim financimin e bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma vjetore e interesit është 1.17 për qind, e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në vitin 2018.

Detyrimi ndaj Bankës Botërore përbëhet nga llogaritë e organizatave ndërkombëtare pranë Bankës së Shqipërisë, si Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA), Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA), Korporata Financiare Nderkombetare (IFC).

14. PARAJA NË QARKULLIM

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës kombëtare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka.

Më 31 dhjetor 2007 dhe 2006 shuma e kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim është si më poshtë:

Vlera Nominale LEKË	31 dhjetor 2007		31 dhjetor 2006	
	Copë (në mijë)	Totali LEKË (milionë)	Copë (në mijë)	Totali LEKË (milionë)
100	5,906	591	9,244	924
200	13,183	2,637	15,799	3,160
500	52,883	26,441	66,541	33,271
1,000	69,202	69,202	72,601	72,601
5,000	12,074	60,368	11,351	56,755
Monedha		1,923		1,523
		161,162		168,234

15. DETYRIME NDAJ BANKAVE VENDASE

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Në monedha të huaja		
Rezerva e detyrueshme	23,848	18,273
Llogari të bankave të nivelit të dytë	1,964	67
	25,812	18,340
Në monedhë vendase		
Rezerva e detyrueshme	32,837	30,122
Llogari të bankave të nivelit të dytë	3,148	453
Marrëveshjet e riblerjes	-	4,199
Depozita njëditore	5,211	436
	41,196	35,210
Interes i përlogaritur	43	25
Totali	67,051	53,575

Interesi mbi llogarinë e rezervave të detyrueshme llogaritet si më poshtë:

- gjendjet në lekë: 70 për qind e *yield*-it të marrëveshjeve riblerjes: 4.375 për qind më 31 dhjetor 2007 (70 për qind e *yield*-it të marrëveshjeve riblerjes: 3.85 për qind më 31 dhjetor 2006);
- gjendjet në usd: 70 për qind e normës së usd libor njëmuajore: 3.40 për qind më 31 dhjetor 2007 (70 për qind e normës së usd libor njëmuajore: 3.75 për qind më 31 dhjetor 2006);
- gjendjet në euro: 70 për qind e normës së euro libor njëmuajore: 3.11 për qind më 31 dhjetor 2007 (70 për qind e normës së euro libor njëmuajore: 2.57 për qind më 31 dhjetor 2006).

Depozitat me afat njëditor kanë normë interesi prej 4.5 për qind (2006 – 3.75 për qind).

16. DETYRIMI NDAJ QEVERISË

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Fitim për t'u shpërndarë qeverisë	-	-
Depozita në emër të qeverisë	14,280	15,922
Të tjera	33	22
Totali	14,313	15,944

Depozita në emër të qeverisë prej 14,280 milionë lekë, përfshin llogarinë kryesore prej 7,622 milionë lekësh, fonde të donatorëve ndërkombëtarë të depozituara në Bankë për transferim të mëtejshëm në projektet e ndihmës në Shqipëri prej 2,790 milionë lekësh, fonde rezervë të qeverisë për Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) prej 1,348 milionë lekësh, si dhe fonde të tjera me destinacion për financime prej 2,520 milionë lekësh.

Zëri “Të tjera” përfaqëson fonde të marra nga Banka për një hua të dhënë qeverisë nga Banka Islamike e Zhvillimit prej 19 milionë lekësh (2006 – 22 milionë lekë) dhe tatimi mbi interesat e bonove të thesarit prej 14 milionë lekësh.

17. TË ARDHURA PËR T’U SHPËRNDARË

	Ndihma nga Banka Botërore	Te tjera	Total
Gjendja më 31 dhjetor, 2006	132	36	168
Pakësime	(64)	(36)	(100)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	68	-	68
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 31 dhjetor, 2006	92	-	92
Amortizimi i vitit	37	-	37
Pakësime	(64)	-	(64)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	65	-	65
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor, 2007	3	-	3
Gjendja më 31 dhjetor, 2006	40	36	76

Ndihma nga Banka Botërore i referohet ndihmave të përfituara nga Banka gjatë viteve 2002-2005, respektivisht për blerjen e programeve kompjuterike dhe pajisjeve për zbatimin e projektit AIPS “Sistemi Shqiptar i Pagesave Ndërbankare” prej 68 milionë lekësh. pakësimi në zërin Ndihma nga Banka Botërore, rezulton nga amortizimi i plotë i ndihmës dhënë nga Banka Botërore për blerjen e projektit AECH “Sistemi i Kryqëzimit të Pagesave me vlerë të vogël” prej 64 milionë lekësh.

“Të tjera”, prej 36 milionë lekësh përfaqëson vlerën e dy godinave dhuratë në qytetet Korçë dhe Berat. Banka në 31 dhjetor 2007, njohu si të ardhur të periudhës të gjithë shumën e mëparshme të granteve.

18. DETYRIME TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Detyrimi ndaj Shtypshkronjës (Shënimi 30)	215	233
Depozita të individëve nga pjesëmarrja në bono thesari	586	636
Detyrimi ndaj fondit të pensionit, neto	6	6
Të tjera	120	79
Totali	927	954

Skema e fondit të pensionit përbëhet nga kontributi i punonjësve në vlerën 2 për qind të pagës së tyre bruto si dhe kontributi i punëdhënësit 15 për

qind mbi totalin e pagave. Në 31 dhjetor 2007, vlera e mjeteve të fondit të pensionit e investuar në letra me vlerë të qeverisë me afat maturimi 12-mujor, është 391 milionë lekë dhe me afat maturimi 5-vjeçar është 69 milionë lekë. Vlera e akumuluar e kontributeve të derdhura nga punonjësit e siguruar në fond deri në 31 dhjetor 2007 është 36 milionë lekë (31 dhjetor 2006 - 24 milionë lekë), ndërkohë që totali i kontributeve të derdhura nga Banka në Fond që nga krijimi i Fondit deri në 31 dhjetor 2007 është në vlerën 298 milionë lekë (31 dhjetor 2006 – 251 milionë lekë).

Në zërin “Të tjera”, përfshihen kryesisht shpenzime të llogaritura prej 54 milionë lekësh (2006 – 29 milionë lekë), të cilat lidhen me mirëmbajtjen e sistemit ATM, shërbime për informacione statistikore, komisione për manaxhimin e rezervës valutore nga IBRD etj.. Në këtë zë është përfshirë edhe provigjoni i pretendimeve për disa çështje ligjore, krijuar në kushte normale biznesi. Në 31 dhjetor 2007, një provigjon prej 20 milionë lekësh është njohur në lidhje me këto pretendime (2006 – 22 milionë lekë). Gjatë vitit 2007 rezultoi një shtesë në provigjone prej 8 milionë lekësh dhe janë rimarrë në të ardhura 6 milionë lekë nga provigjonet e viteve të kaluara (shënimi 27).

19. FONDI I THEMELIMIT

Në bazë të shkresës së Ministrisë së Financave nr. 9852, datë 28 dhjetor 2007 dhe bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4, datë 23 janar 2008, fondi i themelimit u rrit me 1,750 milionë lekë.

20. REZERVA E PËRGJITHSHME

Me rritjen e fondit të themelimit, në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, në fund të çdo viti financiar Banka duhet të shtojë fondin e rezervës së përgjithshme me një shumë prej 25 për qind të fitimit neto të Bankës, deri sa të arrijë 500 për qind të fondit të themelimit të Bankës.

Vendimi për rritjen e kapitalit është marrë në 28 dhjetor 2007, dhe për këtë qëllim banka nuk arriti të transferojë në fondin e rezervës së përgjithshme në masën 25 për qind të fitimit neto, por transferoi vetëm shumën prej 1,431 milionë lekësh.

21. REZERVA E RIVLERËSIMIT

Përbërësit e rezervës së rivlerësimit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit	(23,540)	(15,505)
Rivlerësimi i letrave me vlerë	747	(377)
Rivlerësime të tjera	34	26
Totali	(22,759)	(15,856)

Gjatë vitit 2007, humbja neto nga rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit nga luhatja e kursit të këmbimit është në një vlerë prej 8,035 milionë lekësh (gjatë vitit 2006 – humbja neto 3,341 milionë lekë).

Rivlerësimi i letrave me vlerë me vlerën e tregut, gjatë vitit 2007 ka luhatje pozitive prej 1,124 milionë lekësh.

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” neni 64, pika (a), fitim/humbja neto e rezultuar nga rivlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve në valutë të huaj, transferohet në kapital në një llogari rivlerësimi “Rezerva të rivlerësimit nga kursi i këmbimit”.

Në vijim të po këtij neni, pika (b), gjatë vitit 2007 Ministria e Financave ka rriemtuar letra me vlerë të qeverisë me një total prej 15,505 milionë lekësh për mbulimin e humbjeve neto nga rivlerësimi i monedhave, krijuar deri në fund të vitit 2006. Këto letra me vlerë mbahen në llogari jashtë bilancit, me një maturitet të rinovueshëm prej gjashtë muajsh. Totali prej 15,505 milionë lekësh përfaqëson mbulimin e humbjeve për periudhën 2003 deri në 2006.

22. REZERVA TË TJERA

Përbërësit e rezervave të tjera janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Rezervë speciale për bilancin e pagesave	7,209	7,209
Fonde nga qeveria për mbulimin e përkohshëm të mungesës së kapitalit (shënimi 10)	5,908	-
Fondi i investimit	301	301
Të tjera	1,196	1,196
Totali	14,614	8,706

Rezerva speciale për bilancin e pagesave ka të bëjë me grante të dhëna nga Komuniteti Evropian për Shqipërinë si asistencë financiare për të mbështetur Shqipërinë në procesin e transformimit të ekonomisë në një ekonomi tregu. Këto grante i përkasin periudhës 1992 – 1993, në mbështetje të qëndrueshmërisë së bilancit të pagesave si dhe për të forcuar pozicionin e rezervave. Kjo rezervë ka mbetur e pandryshuar që nga viti 1995.

Fondi i investimit përbëhet nga një fond i krijuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, me qëllim blerjen e një godine të re për Bankën.

“Të tjera” përfshin rezerva të krijuara në vitet respektive me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, nga shpërndarja e fitimit gjatë viteve 2002-2006.

23. TË ARDHURA NGA INTERESAT DHE KOMISIONET (JO-REZIDENTËT)

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2007	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	5,436	4,811
Interesa nga depozitat me afat	1,145	684
Interesa nga depozitat ne sdr me FMN	33	51
Të tjera (skonto)	537	324
Totali	7,151	5,870

24. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (JO-REZIDENTËT)

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2007	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006
Amortizimi i primit të letrave me vlerë	222	406
Shpenzime për interesa nga huatë e institucioneve të huaja	13	13
Shpenzime për interesa nga llogaritë e FMN	69	59
Të tjera	33	16
Totali	337	494

25. TË ARDHURA NGA INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2007	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	4,362	3,902
Interesa nga huatë qeveritare	6	6
Të ardhura nga interesat e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes	227	55
Të tjera	38	57
Totali	4,633	4,020

26. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2007	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006
Shpenzime për interesa mbi rezervën e detyrueshme	1,915	1,440
Shpenzime për interesa mbi marrëveshjet e riblerjes	140	233
Shpenzime për interesa mbi depozitat e qeverisë	184	-
Të tjera	63	58
Totali	2,302	1,731

27. TË ARDHURA / (SHPENZIME) TË TJERA OPERATIVE, NETO

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2007	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006
Humbje neto nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje	(114)	(1,503)
Fitim neto nga shitja e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim	41	72
Amortizimi i grantit dhe ndihma (shënimi 17)	73	53
Provizjone për çështje ligjore dhe të tjera (shënimi 18)	(8)	(25)
Të tjera (shënimi 11 dhe 18)	38	32
Fitim i përcaktuar nga rivlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura për tregtim	215	4
Fitim neto nga kontratat <i>forward</i>	41	-
Totali	286	(1,367)

28. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime të personelit përfshijnë pagat e personelit, kontributet për sigurimet shoqërore, kontributet për planin e pensionit dhe shpenzime të tjera.

Shpenzimet sociale përfaqësojnë kryesisht kontributin e detyrueshëm ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Më 31 dhjetor 2007, Banka ka patur 391 punonjës (2006 – 378 punonjës).

29. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Depozita në bankat e huaja (Shënimi 5)	40,841	38,084
Likuiditete në monedhë vendase	11,338	7,765
Likuiditete në monedhë të huaj (Shënimi 7)	4	15
Ari i mbajtur jashtë vendit (Shënimi 3)	923	797
Ari dhe metalet e tjera të çmuara të mbajtura në vend (Shënimi 3)	63	53
Totali	53,169	46,714

30. SHTYPSHKRONJA

Siç është detajuar në shënimin 2(a), Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës. Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 598, datë 5 shtator 2007, aktiviteti ekonomik dhe financiar i shtypshkronjës do të mbyllet me 31 mars 2008.

Pozicioni financiar i Shtypshkronjës më 31 dhjetor 2007 dhe 2006 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
AKTIVET		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	6	11
Inventari	49	25
Për t'u arkëtuar nga Banka (Shënimi 18)	215	233
Totali i aktiveve	270	269
KAPITALI I VET		
Kapitali themeltar	51	51
Rezerva ligjore	19	19
Rezerva e investimit	24	24
Rezerva të tjera	6	6
Fitimi i mbartur	169	168
Totali i kapitalit të vet	269	268
Detyrime të tjera	1	1
Totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve	270	269

	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2007	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2006
Të ardhura	52	72
Shpenzime	(51)	(65)
Fitimi i vitit	1	7

31. ANGAZHIME DHE GARANCI

Banka mban disa llogari në monedhë të huaj, në lidhje me marrëveshjet e lidhura midis Qeverisë së Shqipërisë dhe qeverive ose organizatave financiare të huaja. Meqë këto llogari nuk përbëjnë as aktiv, as detyrim për Bankën e Shqipërisë, ato nuk janë përfshirë në bilancin e Bankës.

Në 31 dhjetor 2007, letra me vlerë emetuar nga Ministria e Financave për mbulimin e humbjeve neto nga rivlerësimi i monedhave të krijuara në periudhën 2003-2006 rezulton të jetë 15,505 milionë lekë, me terma maturimi të rinovueshëm çdo gjashtë muaj.

32. AKTIVE TË ADMINISTRUARA

Më 31 dhjetor 2007, Banka mbante në kujdestari bono thesari afatshkurtra me vlerë nominale 246 miliardë lekë, obligacione me afat nga 2 vjet deri 7 vjet me vlerë nominale 122 miliardë lekë. Këto instrumente financiare përfaqësojnë letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Më 31 dhjetor 2007, Banka mbante në kujdestari ar dhe metale të tjera të çmuara në emër të Qeverisë me vlerë tregu prej 6,129 milionë lekësh. Në rolin e kujdestarit për këto aktive, Banka nuk mbart asnjë lloj rreziku krediti.

Më 31 dhjetor 2007 dhe 2006 vlera e arit në kujdestari në emër të Qeverisë përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2007 (në milionë LEKË)	31 dhjetor 2006 (në milionë LEKË)
Ar monetar i mbajtur në bankat e huaja	2,584	2,230
Ar jo monetar i mbajtur në bankat e huaja	1,292	1,115
Ar jo monetar i mbajtur brenda vendit	2,041	1,761
Metale të tjera të çmuara	212	202
Totali	6,129	5,308

Interesat e marrë nga depozitimi i rezervave të arit të Qeverisë njihen si të ardhura nga interesat për Qeverinë, duke rritur detyrimin ndaj tyre. Për vitin 2007 interesat e marrë janë rreth 5.5 onz. Diferenca prej 821 milionë lekësh është rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit. (Shënimi 3.)

Këto llogari nuk pasqyrohen në pozicionin financiar të Bankës.

33. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura, në qoftë se njëra palë ka aftësinë të kontrollojë tjetrën apo të ushtrojë një influencë domethënëse mbi palën tjetër, në marrjen e vendimeve financiare apo të tjera.

Duke marrë në konsideratë çdo palë të lidhur të mundshme, vëmendje i kushtohet substancës së marrëdhënies dhe jo formës së mirëfilltë ligjore.

Banka e Shqipërisë nuk ka palë të lidhura përveçse marëdhënies me drejtuesit dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Më 31 dhjetor 2007 dhe 31 dhjetor 2006, transaksionet e realizuara me palët e lidhura përbëhen nga:

	31 dhjetor 2007	31 dhjetor 2006
Kredi për strehim për stafin		
- Personel drejtues	110	84
Totali	110	84

Kreditë kanë norma interesash prej 0.5 për qind dhe janë të pagueshme në 30 vjet, duke filluar pas një periudhe prej dy vitesh, me këste të barabarta mujore. Këto kredi janë të kolateralizuara.

	Viti që përfundon 31 dhjetor 2007	Viti që përfundon 31 dhjetor 2006
Shpenzime administrative		
-Shpenzime telefoni		
- Drejtorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	4	4
-Paga dhe bonuse		
-Drejtorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	90	78
-Kontributi i Bankës në skemën e fondit të pensionit		
-Drejtorët	7	7
Totali i shpenzimeve administrative	101	89

34. ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Rezerva valutore administrohet nga Banka e Shqipërisë dhe investimi i saj realizohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare, i cili bazohet në rregulloren “Mbi politikën e administrimit të rezervës valutore”, që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Rezerva valutore në përputhje me nevojat për likuiditet investohet në instrumente financiare afatshkurtra dhe letra me vlerë me të ardhura konstante.

Rreziku i likuiditetit

Politikat e monitorimit dhe të adresimit ndaj rrezikut të likuiditetit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës monitoron rrezikun e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme duke analizuar treguesit e likuiditetit, boshllëqet dhe skenarët ekonomikë. Banka menaxhon rrezikun e likuiditetit nëpërmjet investimit në depozita afatshkurtra me bankat e huaja.

Politikat e administrimit të likuiditetit vendosen për të siguruar që edhe në kushte të vështira, Banka të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

Rreziku i kreditit

Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës, nën kontrollin e Këshillit Mbikëqyrës, është përgjegjës për përcaktimin e rrezikut të kreditit, që shoqëron operacionet e Bankës. Rreziku i kreditit zbutet nga ana e Bankës duke kryer transaksione të shumta me institucione qeveritare dhe ndërkombëtare. Kreditë për bankat vendase sigurohen nga bonot e thesarit të Qeverisë.

Rreziku i çmimeve

Faktorët kyç të rrezikut të çmimeve që ndikojnë Bankën janë:

- rreziku i monedhave, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare, për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit; dhe

- rreziku i normave të interesit, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare, për shkak të ndryshimeve në normat e interesave të tregut.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Aktivet financiare, të mbajtura në monedhë të huaj janë paraqitur në secilin prej shënimeve korresponduese në pasqyrat financiare.

Rreziku i normave të interesit monitorohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës. Banka e zbut këtë rrezik, duke mbajtur një tepricë të konsiderueshme të aktiveve interesprurëse mbi pasivet që paguajnë interes (siç detajohet në shënimin 35 më poshtë). Banka mban një portofol aktivesh dhe pasivesh financiare me interes, të tillë që e ardhura e gjeneruar nga interesi neto është në mënyrë të ndjeshme më e lartë se kërkesat operative, gjë që minimizon efektet e mundshme negative të ndryshimeve në normat e interesit. Normat e interesit që zbatohen mbi aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten në çdo shënim korrespondues të pasqyrave financiare.

35. NDJESHMËRIA E NORMAVE TË INTERESIT (ANALIZA E MATURITETIT TË MBETUR)

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Jo të ndjeshëm ndaj interesit	Totali
Aktivët								
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	923	923
Depozita tek Fondit Monetar Ndërkombëtar	160	-	-	-	-	-	6,871	7,031
Depozita në banka të huaja	32,961	7,880	-	-	-	-	135	40,976
Investime të vlefshme për shitje	3,705	6,646	9,479	13,679	88,586	2,001	-	124,096
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	-	659	8,088	-	-	8,747
Aktive të tjera në monedhë të huaj	250	-	-	-	-	-	502	752
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	63	63
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	95	95
Kredi ndaj bankave vendase	1,508	-	-	-	-	-	1	1,509
Investime të vlefshme për shitje	26,650	19,328	19,597	948	-	-	-	66,523
Letër me vlerë e qeverisë për mbulim kapitali	-	5,909	-	-	-	-	-	5,909
Aktive të tjera vendase	-	-	-	-	-	1,048	2,455	3,503
Totali i Aktiveve	65,234	39,763	29,076	15,286	96,674	3,049	11,045	260,127
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	218	139	347	555	4,324	1,928	6,435	13,946
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	-	-	-	-	-	1,072	111	1,183
Detyrime të tjera të huaja	251	-	-	-	-	-	-	251
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	161,162	161,162
Detyrime ndaj bankave vendase	61,896	-	-	-	-	-	5,155	67,051
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	14,313	14,313
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-	3	3
Detyrime të tjera vendase	-	-	-	-	-	-	927	927
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	1,291	1,291
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat	62,365	139	347	555	4,324	3,000	189,397	260,127
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2007	2,869	39,624	28,729	14,731	92,350	49	(178,352)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit - 2007	2,869	42,493	71,222	85,953	178,303	178,352	-	-

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Jo të ndjeshëm ndaj interesit	Totali
Aktivet								
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	797	797
Depozita tek Fondit Monetar Ndërkombëtar	-	847	-	-	-	-	7,020	7,867
Depozita në banka të huaja	31,866	6,218	-	-	-	-	73	38,157
Investime të vlefshme për shitje	-	473	664	23,009	90,969	2,289	-	117,404
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	-	1,253	8,383	-	-	9,636
Aktive të tjera në monedhë të huaj	189	-	-	-	-	-	537	726
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	53	53
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	139	139
Kredi ndaj bankave	3,350	5,500	-	-	-	-	54	8,904
Investime të vlefshme për shitje	25,013	23,932	18,630	-	-	-	-	67,575
Aktive të tjera vendase	-	-	-	-	-	857	3,366	4,223
Totali i aktiveve	60,418	36,970	19,294	24,262	99,352	3,146	12,039	255,481
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	235	150	319	627	4,929	2,458	6,538	15,256
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	-	-	-	-	-	1,090	156	1,246
Detyrime të tjera të huaja	186	-	-	-	-	-	-	186
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	168,234	168,234
Detyrime ndaj bankave vendase	53,030	-	-	-	-	-	545	53,575
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	15,944	15,944
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-	76	76
Detyrime të tjera vendase	-	-	-	-	-	-	954	954
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	10	10
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat	53,451	150	319	627	4,929	3,548	192,457	255,481
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2006	6,967	36,820	18,975	23,635	94,423	(402)	(180,418)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit - 2006	6,967	43,787	62,762	86,397	180,820	180,418	-	-

36. POZICIONI NETO I MONEDHËS

	LEKË	USD	EURO	GBP	Te tjera	Totali
Aktivet						
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	923	923
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	6,429	-	-	-	602	7,031
Depozita në bankat e huaja	-	8,286	27,552	1,514	3,624	40,976
Investime të vlefshme për shitje	-	39,969	70,638	8,303	5,186	124,096
Investime të mbajtura për tregtim	-	8,747	-	-	-	8,747
Aktive të tjera në monedhë të huaj	335	415	2	-	-	752
Ari dhe metale të çmuara	63	-	-	-	-	63
Kredi tranzite	-	-	95	-	-	95
Kredi ndaj bankave	1,509	-	-	-	-	1,509
Investime të vlefshme për shitje	66,523	-	-	-	-	66,523
Leter me vlerë e qeverisë për mbulim kapitali	5,909	-	-	-	-	5,909
Aktive të tjera vendase	3,497	2	4	-	-	3,503
Totali i aktiveve	84,265	57,419	98,291	9,817	10,335	260,127
Detyrimet						
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	7,120	-	-	-	6,826	13,946
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	11	-	1,172	-	-	1,183
Detyrime të tjera të huaja	-	251	-	-	-	251
Para në qarkullim	161,162	-	-	-	-	161,162
Detyrime ndaj bankave vendase	41,225	6,274	19,552	-	-	67,051
Detyrime ndaj qeverisë	8,797	310	5,205	1	-	14,313
Të ardhura për t'u shpërndarë	3	-	-	-	-	3
Detyrime të tjera vendase	895	21	11	-	-	927
Totali i detyrimeve	219,213	6,856	25,940	1	6,826	258,836
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2007	(134,948)	50,563	72,351	9,816	3,509	1,291
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2006	(132,642)	52,343	73,612	9,753	(3,056)	10

37. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

1) Kalimi Arit dhe metaleve të çmuara në pronësi të Bankës së Shqipërisë.

Më 11 shkurt 2008 Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekret nr. 5613, datë 11.02.2008 ka dekretuar ligjin nr. 9862, datë 24 janar 2008 "Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi sasinë e arit dhe të metaleve të tjera të çmuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë në Bankën e Shqipërisë". Ligji pas dekretimit është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 10, datë 13.02.08 dhe ka hyrë në fuqi me 27.02.08. Shuma e arit dhe metaleve të çmuara të vlerësuara në lekë është 7,042 milion lekë për 27.02.08.

2) Rivlerësimi i truallit dhe ndërtesave të Shtypshkronjës.

Trualli dhe ndërtesat e Shtypshkronjës janë rivlerësuar me një efekt në rritje si rezultat i rivlerësimit prej 230 milionë lekësh. Regjistrimi në kontabilitet i këtyre aktiveve do të bëhet pas kalimit ligjor të pronësisë së tyre në Bankën e Shqipërisë dhe pas mbylljes së aktivitetit të Shtypshkronjës.

